

Dr. Maxhid Arsan el Kilani

EDUKIMI DHE REFORMIMI

Zhvillimi i efikasitetit te muslimani bashkëkohor

Autor: Dr. Maxhid Arsan el Kilani

Titulli i origjinalit: التربية والتجديد وتنمية الفاعلية عند المسلم المعاصر

Përkthyes: Prof. Dr. Naser Ramadani

Recensimi, Redaktura & Grafika: Prof. Dr. Hajredin Hoxha

Botues: Shtepia Botuese Furkan (SIM) –Shkup-Maqedonia e Veriut - 2023

Fjala e recensentit

Dy fjalë me rëndësi të madhe për këtë libër madhështor

Bismilahir Rahmanir Rahijm

Të gjitha falënderimet i qofshin dhe i takojnë vetëm Allaht xh.sh. i Cili e shpalli Kur'anin famëlartë mbi Muhamedin a.s. për t'i nxjerrë popujt nga terri i paditurisë dhe i prapamebetjes në dritën e dijes dhe të përparimit. Atij i qofshim falë, Atij i lutemi me i na i falë gabimet, Atij i lutemi me na udhëzue e me na ndihmue. Prej Tij ndihmë dhe forcë kërkojmë, Atij i mbështetemi në realizimin e qëllimeve dhe projekteve tona, dhe nga Mëshiruesi ynë kërkojmë me na bë të suksesshëm, të vyeshëm, të singertë, udhërrëfyes dhe frymëzues për të tjerët, amin. Selamet dhe salavatet, si dhe përshëndetjet tona më të përzemërta dhe më të sinçerta ia dërgojmë të dashurit tonë, pejgamberit më të mirë dhe më të dashur, zotëriut të gjithë pejgamberëve, mësuesit dhe liderit të mbarë njerzimit të cilin e dërgoi Allahu xh.sh. me thirje të pastër dhe udhëzim të qartë, përgëzues dhe qortues për tërë njerëzinë.

Lexues të dashur, dashmirë të dijes dhe të dijetarëve, kudo që jeni dhe kushdo që jeni, Allahu ju bekfoftë dhe gradën më të lartë në Xhennet ua dhuroftë.

Pata nderin që ky libër madhështor i shkruar nga pena e nje dijetari, analisti, reformatori dhe edukatori madhështor nga Jordania, prof.Dr.Maxhid Arsan el Kejlani – Allahu e pastë mëshirue -, e i përkthyer dhe i përshtatur nga pena e shokut, profesorit, edukatorit të mirënjohur në trojet shqiptare Prof.Dr.Naser Ramadani – Allahu e begatoftë me të mirat e Tij –

Libri në fjalë është përkthyer nga arabishtja me dorën dhe kokën e një mjeshtri të spikatur dhe me eksperiencë të gjatë e të ngjeshur në fushën e Islamistikës dhe të edukimit, me një stil të sh lirë e të mirë, të lartë e të pasur pa komplikime dhe pa terminologji filozofike që e vështirëson kuptimin e mesazhit të librit, me një gjuhë të ëmbël, të kapshme dhe kuptimdhënëse, mbresëlënëse dhe tërheqëse, të lirshëm që na mundëson me aludue bindshëm kinse profesori Naser është autor i librit, e jo përkthyes. Nga zemra e falënderojmë dhe jetë të gjatë e të lumtur dhe mbarvajtësi në projektet dhe punimet e ardhshme i dëshirojmë.

Lexues të dashur,

Për ta kuptuar esencën, vlerën, rëndësinë, mesazhin madhështor të këtij libri me dimensione edukativo-arsimore, fetare dhe reformatore, psikologjike dhe sociale, e

shkruar me frymën dhe shpirtin Islam, për problemet lokale dhe globale, ne do ti qasemi tregimit të rëndësishë në formatin akademik duke i parashtruar disa pyetje që ta kuptojmë se çfarë perle kemi në dorë.

Them, a dëshironi ta kuptoni problemin esencial të sistemeve edukativo-arsimore në botën arabe dhe islame? A dëshironi t'i kuptoni shkaqet e mos efikasitetit të Muslimanit bashkëkohor? Pse ai është i dobët, jo produktiv, pa vlerë? Ku qëndron problemi? Sa kanë ndikuar negativisht sistemet politike bashkëkohore në mos-zhvillimin e trurit, mendjes dhe zemrës së Muslimanit bashkëkohor? Vallë a dëshironi t'i kuptoni lojërat dhe kurthet e shteteve kolonialiste karshi shteteve dhe popujve arabe dhe islame? A dëshironi të dini për dëmet psikologjike, sociale, politike, personale, familjare, fetare që kanë shkaktuar sistemet edukativo-arsimore laike bashkëkohore? A dëshironi ta kuptoni sekretin e avancimit të shteteve europiane dhe amerikane? A dëshironi të dilni nga kjo situatë e mjerueshme që na ka kapluar? A dëshironi të dini se si bahen reformat dhe ndryshimet akademike, fetare, sociale, politike dhe ekonomike? A dëshironi të dini se cilat janë karakteristikat e reformatorit edukativo-arsimor nga perspektiva Kuranore dhe Profetike? Etj etj etj..nëse dëshironi përgjigje rreth këtyre pyetjeve dhe shumë të tjera, përgjigjen e keni në këtë libër. Këto përgjigje janë lehtësuar në formën e grafikave për lehtësim, kuptim dhe implementim të këtij plani dhe projekti të rëndësishëm për edukatorë. Për ta parë efektin, frytin dhe rezultatin pozitiv të këtij projekti, të këtij libri rekomandoj fuqishëm dhe me këmbëngulje që libri në fjalë të studiohet, mësohet, komentohet në mënyrë sistematike dhe serië nëpër xhamia, shkolla fillore, te mesme dhe fakultete, e në veçanti Medresetë dhe Fakultetet e Studimeve dhe Shkencave Islame në trojet tona shqiptare e që halli i muslimanëve dhe dobësia e efikasitetit të tyre i ngjan hallit të muslimanëve në botën arabe dhe islame. Lus Allahun Fuqiplotë me e shpërblye autorin, përkthyesin dhe recensentin e librit për mundin e tyre të pakursyer në shërbim të Kuranit, Synetit, shoqërisë Islame dhe mbarë njerëzimit, amin.

Në fund ve ma teufikij ila bilahi themë – Mbarëvajtësinë,vetëm nga Allahu dua ta kemë.

Me respekt

Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

Doha-Katar

20.12.2022

www.drhafezi.net

PËRMBAJTJA

Parathënie

Edhe pse muslimanët - përfshirë këtu edhe arabët - posedojnë të gjithë kapacitetet për t'u bërë fuqi botërore, ngase ata kanë besimin, i cili i furnizon me energji të mëdha, që i nxit për punë dhe kreativitet; posedojnë pasuri të shumta dhe të ndryshme; posedojnë pozitën e rëndësishme gjeografike dhe strategjike; posedojnë numër të madh të banorëve që i tejkalon një miliard;¹ posedojnë mundësinë që lindjet në shoqëritë e tyre të jenë në numër shumë të madh..., megjithatë, dobia nga të gjitha këto kapacitete, është tejet e vogël, derisa mund të thuhet se shumica e këtyre energjive dhe kapaciteteve është e humbur.

Muslimanët - përfshirë edhe arabët - janë para një pozite të madhe kontradiktore mes kapaciteteve të mëdha që i posedojnë dhe pamundësisë për shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve. Pra, ata janë para një neglizhence të madhe që umetit i humb shanset e pakufishme për fenë dhe jetën e tyre.

Pyetja që duhet parashtruar këtu është: Pse e gjithë kjo situatë kontradiktore në jetën e muslimanëve? Ku fillon kriza? Prej ku fillon diagnostifikimi?

Pothuajse, të gjithë ekspertët e shkencës së pedagogjisë dhe të sociologjisë janë të një mendjeje se pamundësia e popujve për shfrytëzimin e resurseve njerëzore dhe kapaciteteve materiale fshihet në dobësinë e sistemit të të menduarit dhe vullnetit, të cilat janë të mishëruara në kulturën e individëve dhe raporteve mes shoqërive që formojnë umetin. *Ky është një sinjal për ekzistimin e defektit në sistemin pedagogjik që e furnizon njeriun, respektivisht umetin, me vlera dhe orientime, me informacione dhe eksperiencë, dhe i zhvillon kapacitetet dhe aftësitë.*

Shkaku për këtë fshihet në atë se fazat e sjelljes së njeriut - përfshirë edhe performancën qytetëruese - *fillojnë me fazën e mendimit, më pas faza e vullnetit dhe dëshirës, më pas vjen faza e tretë, faza e zbatimit dhe e arritjeve.* Nëse faza e parë ka defekt, atëherë pasojat e defektit do të kalojnë edhe te dy fazat e tjera dhe kështu do të rritet papunësia, pamundësia dhe prapambetja. Për këtë flet Kur'ani kur thotë: **"Allahu nuk ishte ndryshues i një** ذَٰلِكَ بِأَنَّ اللَّهَ لَمْ يَكُ مُغَيِّرًا نِّعْمَةً أَنْعَمَهَا عَلَىٰ قَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ "

¹ Sot numri i muslimanëve është mbi një miliard e pesëqind milionë (v.p.).

begatie, të cilën ia ka dhuruar një populli, derisa të ndryshojë ai vetë në vetevete (të bëhet përbuzës i së mirës).”² Në lidhje me këtë, Muhamedi s.a.v.s. thotë: “Ngrihet dituria dhe shfaqet injoranca dhe çrregullimet.”³ Për këtë, Muhamedi s.a.v.s., mes të tjerash, lutej edhe me këtë lutje: “O Allah, kërkoj prej Teje mbrojtje nga dituria që nuk sjell dobi.”⁴

Popujt e ngritur, kur ndiejnë ndonjë krizë të caktuar ose çrregullim në performancë dhe mangësi në efikasitet dhe arritje, punë të parë që bëjnë është angazhimi i ekspertëve për diagnostifikimin e vlerave kulturore dominuese dhe sistemeve pedagogjike ekzistuese. Këtë e kishte bërë Anglia kur kishte vërejtur epërsinë e Gjermanisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në kohë kur sistemet mbrojtëse iu kundërviheshin sulmeve gjermane në ajër dhe në det, pedagogët britanikë tuboheshin në strehimore për diagnostifikimin e sistemeve pedagogjike dhe të kulturës shoqërore.

Ngjashëm kishin vepruar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kur vërejtën se Bashkimi Sovjetik po iu paraprinte në arritjen në Hënë. Të njëjtën gjë është duke bërë edhe sot kur vëren epërsinë e japonezve në fushën e prodhimit dhe të tregtisë botërore.⁵

Profesor i Universitetit Osaka të Japonisë, Yasumasa Tomoda, thekson se punë të parë që ka bërë Japonia pas disfatës në Luftën e Dytë Botërore ishte riformulimi i vlerave tradicionale, të cilat insistonin në respektimin vertikal në shoqëri, respektivisht respektimin e të vegjëlve ndaj të rriturve dhe respektimin e pasuesve ndaj udhëheqësve. Kjo çështje çoi në riformulimin e sistemit edukativ në Japoni,⁶ në veçanti edukata politike morale, “S. Sushin”, duke i dhënë kujdesin e mjaftueshëm vlerave demokratike, lirisë, raportve mes udhëheqësve dhe popullatës, qëndrimi ndaj traditave dhe vlerave të trashëguara, qëndrim të një kritiku të ditur, e jo të një pasuesi euforik, duke u kujdesur për udhëheqësi dhe punë kolektive si dhe duke zgjeruar

² El Enfal: 53.

³ Transmeton Buhariu në **Sahih**, Libri i diturisë.

⁴ Transmeton Ibn Maxheh në **Sunen**, Libri i lutjes, nr. 3. Ngjashëm transmetojnë edhe Tirmidhiu, Nisaiu, Ebu Davudi dhe Ahmed.

⁵ James J. Shields, **Japanese Schooling: Patterns of Socialization, Equality and Political Control**, 3rd. Ed. The Pennsylvania State University Press, 1993.; Lois Peal, **Learning to Go to School in Japan**, Berkeley, (Los Angeles: University of California Press, 1991.


⁶ Patëm nderin dhe ishim të privilegjuar me pjesëmarrjen dhe kumtesën tonë në konferencën ndërkombëtare në OSAKA dhe KYOTO–JAPONI, më 2013, ku prezantuam edhe punimin tonë në gjuhën angleze. Po ashtu, e patëm nderin të realizojmë një studim shkencor rreth precizitetit të Japonisë, Amerikës dhe vendeve Arabe në Edukim dhe Arsim. Punimi gjendet ne websajtin tonë: drhazezi.net (v. e recensentit).

konceptin e moralit për të përfshirë fushat politike, administrative, kulturore dhe shkencore.⁷

Korea e Jugut, kur vërejti rrezikun nga komunizmi, insistoi në mbylljen e kushteve dhe ambientit që mundësojnë përhapjen e tij. Këtë e realizoi duke rishikuar në radhë të parë sistemin edukativ, më pas aktivitetin administrativ dhe, në fund, përfundoi duke përhapur vlerat e mëposhtme:

1. *Formimi i një ideologjie të veçantë për vendin;*
2. *Zhvillimi i dashurisë dhe respektit ndaj popullit, në vend të racizmave anësore;*
3. *Zhvillimi i dashurisë ndaj punës dhe përparimit ekonomik;*
4. *Zhvillimi i shpirtit të shëndoshë ushtarak;*
5. *Zhvillimi dhe praktikimi i shanseve të barabarta shoqërore;*
6. *Zhvillimi i demokracisë dhe praktikimi i saj në jetën politike;*
7. *Zhvillimi i udhëheqësisë kolektive në vend të udhëheqësisë individuale.*⁸

Korea e Jugut i përhapri këto vlera:



⁷ Yasumasa Tomoda, **Politics and Moral Education in Japan- in The Revival of Values Education in Asia and West**, edited by William K. Cummings & Others, (Oxford & New York; Pergamon Press, 1988) pp. 75-91.

⁸ Sooyeon C. Suh. "Ideologies in Korea's Moral and social texts: A Content Analysis" in **The Revival of Values in Asia and the West**, pp. 93-107.

Çdo popull që ka pasur sukses për të dalë nga krizat apo për t'u ballafaquar me sfidat e tij në radhë të parë ka filluar me kontrollimin e sistemeve edukative dhe kulturore dominuese. Çdo parti, grup apo organizatë ka pasur sukses vetëm atëherë kur kanë miratuar parimin e rikontrollimit dhe vlerësimit të rregullt ndaj parimeve dhe mendimeve të tyre. Në anën tjetër, çdo parti, grup apo organizatë kanë mbetur të ngurtë, vetëm atëherë kur mendimeve dhe programeve të tyre u kanë dhënë epitetin e pagabueshmërisë.

Hulumtimet e para në sistemet edukativo-arsimore dhe kulturore dominuese në vendet arabe dhe islame tregojnë se ato prodhojnë njerëz të cilët në kohërat e paqes janë të burgosurit e kulturës së heshtjes, zbatimit të urdhrave dhe tërheqjes ndaj ndodhive, vrapimi pas besnikërisë raciste dhe kujdeseve ditore që përfshihen në sigurimin e kafshatës së gojës dhe veshjes. Mirëpo, ai kur ballafaqohet me kriza dhe sfida, atyre iu kundërvihet me eufori dhe reaksione spontane. Merret me trajtimin e pasojave të krizës duke harruar rrënjët që kanë depërtuar në mendjet e tyre, të shtrira në koncepte dhe besime, tradita dhe kulturën dominuese. Për këtë krizat zgjasin duke u shtuar në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, politike, ushtarake, ekonomike etj.

Për këtë, hulumtimi në tiparet dhe përbërësit e personalitetit të pjekur dhe të fuqishëm për bartjen e përgjegjësisë, në vlerat që nxisin efikasitetin tek umeti dhe e përgatisin për shfrytëzim të drejtë të kapaciteteve dhe atyre që pengojnë pjekurinë dhe efikasitetin është domosdoshmëri për përcaktimin e pikënisjeve të reformimit dhe prioritetëve reformuese. Një hulumtim i tillë është pjesë e urtësisë, “el hikme”, të cilën Allahu ia ka dhënë pozicionin e parë në programin e thirrjes drejt Tij kur iu drejtua të Dërguarit të Tij, duke i thënë:

"ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ"

“Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.”⁹

Shpallja (vahji), pasi për edukimin dhe thirrjen islame ka caktuar rrugët e urtësisë, këshillës me të mirë dhe polemizimit me të mirë, ka vendosur shenjat në rrugën e hulumtuesve në çështjen e kuptimit të edukimit dhe thirrjes me qëllim që më pas me mendjet dhe shqisat e tyre të kristalizojnë detajimet e secilës rrugë. E gjithë kjo me qëllim që si rezultat i këtij kuptimi të jetë kristalizimi i shkencave të urtësisë,

⁹ En Nahl: 125.

shkencave të këshillimit me të mirë dhe shkencave të polemizimit me të mirë, dhe krejt në fund trajnimin e aktivistëve në këto shkenca ndaj programeve dhe metodave të saj. Sa i përket ngecjes në konceptet beduine dhe eksperiencës automatike ajo merr pjesë në kornizën e analfabetisë kulturore, që ua ka imponuar arabëve ashpërsia dhe thatësia e klimës natyrore. Më pas traditat janë bashkuar që këto çështje t'i ruajnë dhe të kujdesen për to. Shkruesit e sires dhe sunetit nuk kanë bërë përpjekjet e mjaftueshme për sqarimin se si Allahu ka dërguar në mesin e analfabetëve të Dërguar, i cili u lexon atyre ajetet e Tij, i pastron ata dhe u mëson Librin dhe Urtësinë.

Kjo lë të kuptohet se “*preciziteti*” në studimin e psikës njerëzore për të zbuluar ligjet dhe për të njohur përbërësit dhe traditat efikase, si dhe për të njohur pengesat dhe traditat vdekjeprurëse të zhvillimit të së parës dhe mbrojtjen e njeriut nga e dyta, është objekt studimi i kuptimit të drejtë edukativ, “el fikhut terbevij”, për të cilën obligohen institucionet pedagogjike të bëjnë përpjekje për kristalizimin, përhapjen dhe aktivizimin e tyre.

Pikërisht këtë ka për qëllim ky studim. Përmes tij dëshiron të japë një kontribut dhe të nxisë kujdesin për të. Me shpresë që Allahu do të na mundësojë ta shohim gjendjen tonë, të na udhëzojë dhe të na bashkojë në rrugën e drejtë, ngase Ai është Ndihmësi më i mirë.

KAPITULLI I PARË


KUPTIMI I EFIKASITETIT DHE RËNDËSIA E TIJ

Efikasiteti (*el failijeh*), në përgjithësi, nënkupton përpjekjen dhe veprimin për të arritur gradat më të larta të suksesit dhe realizimin e rezultateve më të mira.¹⁰ Udhëheqësit, cilësohen si efikasë kur “daljet”, respektivisht prodhimi (*output*) ose rezultatet që arrijnë, janë më të mira dhe më shumë se “hyrjet”, respektivisht investimi (*input*) që përfshin përpjekjet, harxhimet dhe resurset njerëzore dhe materiale, të cilat i kanë investuar. Sa më të vogla të jenë “hyrjet”, respektivisht investimet në krahasim me “daljet-prodhimin” dhe për kohë më të shkurtër, aq më i madh dhe më me ndikim është efikasiteti.¹¹

Vlerësimi i efikasitetit realizohet sipas qëllimeve të caktuara të punës dhe sipas matësve të efikasitetit. Ky vlerësim është i dobishëm në tri çështje:

1. Ofron feedback që ndihmon në vlerësimin e punëve, më të realizuara;
2. Ofron rregullat dhe propozon kushtet e nevojshme për përcaktimin e nivelit të nevojshëm të angazhimit për realizimin e një arritjeje më të mirë;
3. Furnizimi i udhëheqësve me informacione që ndërlidhen me planet e ardhshme ku në bazë të tyre do të marrin vendimet dhe do të përgatisin strategjitë.

Vlerësimi i efikasitetit realizohet sipas qëllimeve të caktuara të punës dhe sipas matësve të efikasitetit. Ky vlerësim është i dobishëm në tri çështje




¹⁰ Robert Albanese, **Managing: Toward Accountability For Performance**, 3rd ed. (Homewood, Illinois, 1981), p. 16.

¹¹ Ibid, p. 15.

Efikasiteti është një term shumë i gjerë. Kuptimi i tij ndryshon sipas temave dhe specializimeve. Në sferën politike mund të ketë kuptimin e krahasimit mes arritjeve (*output*) politike dhe “hyrjeve” (*input*) të harxhuara.

Në sferën ekonomike, efikasiteti shihet në dy çështje:

1. Ndërlidhet me suksesin e institucioneve ekonomike në prodhimin e asaj që është e mundur nga investime të caktuara;
2. Ndërlidhet me suksesin e këtyre institucioneve për përshtatjen e veprimeve të duhura me çmimin e tregut dhe nevojat ekzistuese sipas çmimeve të investimit. Në sferën ushtarake, efikasiteti nënkupon realizimin e shkallëve më të larta të fitores me humbje më të vogla njerëzore, materiale dhe ushtarake.¹²



Në Kur'anin Famëlartë, fjalën “hyrje”, investime (*input*), e gjejmë të shprehur me disa emra. Si, për shembull:

- 1- (*El Vus'u*). Allahu i Lartëmadhëruar thotë:

"وَلَا نُكَلِّفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا وَلَدَيْنَا كِتَابٌ يَنْطِقُ بِالْحَقِّ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ"


¹² Ibid, pp. 75-76.

“Ne nuk e obligojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij dhe te Ne është libri (i shënimeve) që shënon saktësisht (veprat) dhe atyre nuk u bëhet padrejtë.”¹³

2- Ngjashëm me këtë kemi edhe fjalët: (*El Kuvveh*) dhe,

3- (*Er-Ribat*). Kjo shihet në ajetin kur’anor: “وَأَعِدُّوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ”

“E ju përgatituni sa të keni mundësi forcë, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kudër tyre.”¹⁴. Grafiku në vijim e sçaoron këtë realitet si vijon:



Sa i përket “daljeve”, prodhimit (*output*), Kur’ani këtë e potencon me emrin (*el akibeh*) “fundi”. Ky emër përsëritet në dhjetra ajete kur’anore dhe në të shumtën e rasteve vjen i shoqëruar me fjalën (*el mut tekin*) “të ruajturit, të devotshmit”, pra, ata që i ruhen ndeshjes me urdhrat dhe ligjet e Allahut në jetë, univers dhe në zhvillimin historik dhe shoqëror. Kur efikasiteti arrin gradën më të lartë të mundur, atëherë Kur’ani për njerëzit që cilësohen me të, e përdor emrin (*el muflihun*) “të shpëtuarit, të suksesshmit”, në kohë kur i shpëtuar apo i suksesshëm është ai që realizon qëllimin e synuar.¹⁵

¹³ El Mu’minun: 62.

¹⁴ El Enfal: 60.

¹⁵ Er Razi, **Et Tefsir**, (Suretul Bakareh), vëll. II, f. 34.

Po ashtu, për nivelin e “*daljeve-prodhimit*” të supozuara nga umeti islam, Kur’ani cakton dy limite:

- a- maksimumin, atëherë kur umeti është në gjendje të shfrytëzojë “hyrjet” e investuara;
- b- minimumin, atëherë kur ka dobësi në përvojë dhe aftësi të nevojshme për shfrytëzimin e “hyrjeve”.

Në lidhje me këto dy limite flet ajeti kur’anor:

“يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَرِّضِ الْمُؤْمِنِينَ عَلَى الْقِتَالِ إِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ عِشْرُونَ صَابِرُونَ يَغْلِبُوا مِائَتَيْنِ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ يَغْلِبُوا أَلْفًا مِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَفْقَهُونَ الْآنَ خَفَّفَ اللَّهُ عَنْكُمْ وَعَلِمَ أَنَّ فِيكُمْ ضَعْفًا فَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ مِائَةٌ صَابِرَةٌ يَغْلِبُوا مِائَتَيْنِ وَإِنْ يَكُنْ مِنْكُمْ أَلْفٌ يَغْلِبُوا أَلْفَيْنِ بِإِذْنِ اللَّهِ وَاللَّهُ مَعَ الصَّابِرِينَ”

“O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, (trima të fuqishëm), do t’i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t’i mundni një mijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë!”


Sa i përket cilësimit kur’anor në ajetin e parë në lidhje me jobesimtarët: “بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَفْقَهُونَ” **“ata janë njerëz që nuk kuptojnë”**, sepse ata nuk kuptojnë ndikimin e besimit në efikasitet e as rëndësinë e mendjeprehtësisë që ofron udhëzimi kur’anor në fushën e investimit të kapaciteteve dhe të mobilizimit të energjive.

Sa i përket lehtësimit ndaj besimtarëve në shkallën e dyfishimit, kjo nënkupton se performanca e njeriut musliman edhe në gjendjen më të dobët të tij duhet të jetë dyfish më i madh se performanca e jobesimtarit në gjendjen më të mirë të tij. Bazuar në këtë, çka mund të themi për uljen e efikasitetit të besimtarit në krahasim me jobesimtarin derisa ka arritur gradën më të ulët në mesin e të gjitha shoqërive njerëzore?!

Efikasiteti i umetit realizohet përmes:


- 1- arritjeve që plotësojnë nevojat dhe përballen me sfidat brenda vendit;
- 2- me kontributin civilizues që ofron umeti jashtë vendit.

Grafiku në vijim e sharon këtë realitet si vijon:



Popujt e përparuar, në planet e tyre zhvillimore dhe strategjitë për të ardhmen, janë kujdesur shumë për realizimin e efikasitetit prodhues. Për këto qëllime kanë themeluar institucione për hulumtime dhe trajnime. Shembull për këtë kemi atë që kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë SHBA-të, Japonia dhe Gjermania, të cilat ngrenë nivelin e efikasitetit në aktivitetet ekonomike, administrative dhe politike, qoftë brenda vendit apo jashtë. Në SHBA organizohen konferenca dhe simpoziume mujore ku përfshihen përfaqësues të tri fuqive:

1. *fuqia e njohjes;*
2. *fuqia e pasurisë;*
3. *fuqia politike dhe luftarake.*



E gjithë kjo me qëllim që të realizohen tri çështje:

- a- Njohja e mjeteve që realizojnë maksimumin e “daljeve-prodhimit” përballë minimumit të “hyrjeve-investimit”;
 - b- Vlerësimi i nivelit të koordinimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve të tri fuqive të lartëpërmenduar;
- Vlerësimi i rezultateve të arritura dhe njohja e detajeve të feedback-ut (reagimit). Grafiku në vijim e sçaoron këtë realitet si vijon:



Shembull të këtyre konferencave kemi Konferencën e Dytë të shkencave ekonomike e organizuar në mars të vitit 1990 në Universitetin Georgetown në Washington. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë më shumë se 800 pjesëmarrës. Në mesin e tyre kishte specialistë të psikologjisë, sociologjisë, politikës, filozofë, ekonomistë, menaxherë etj. Në këtë konferencë janë paraqitur afër 200 kumtesa, të cilat janë debatuar në 50 seanca. Në fund, abstraktet e të gjithë këtyre kumtesave janë tubuar në një libër në titull: “Morali, logjika dhe efikasiteti”. Tema e kësaj konferenca ishte vazhdim i konferencës së parë të organizuar në Fakultetin e Administratës pranë univesitetit të Harvardit në vitin 1989. Kjo konferencë si temë kryesore kishte rishikimin e bazave tradicionale të vjetra rreth ekonomisë, të cilat bëjnë ndarjen mes tregtisë dhe biznesit dhe mes vlerave dhe përgjegjësisë morale, si dhe diskutimin e

ndikimit të vlerave dhe përgjegjësisë morale në rritjen e efikasitetit të prodhimit nga kompanitë e mëdha.¹⁶

Ngjashëm me këtë kemi edhe studimet që janë bërë rreth “efikasitetit” politik në Gjermani pas katastrofave politike dhe ushtarake që sollën shkatërrim masiv në Evropë dhe Gjermani në veçanti dhe në tërë botën në përgjithësi gjatë dy Luftërave Botërore. Në lidhje me këtë kemi konferencën e organizuar nga Qendra e Studimeve Federale në Universitetin Leicester me rastin e dyzetvjetorit të themelimit të Unionit Federal në Gjermaninë Perëndimore. Raporti i konferencës temë qendrore kishte kontrollimin e ndikimit të federatës dhe demokracisë në efektivizimin e zhvillimit të Gjermanisë. Nga raporti shihet se të dy faktorët: federata dhe demokracia, kishin rol pozitiv, mirëpo sinjalizon në dobësinë e efikasitetit, sepse që të dyja ishin të imponuara nga SHBA-të dhe Franca, të cilat i frikësoheshin ngritjes së një qeverie qendrore që do të qeverisë me politikën e Hitlerit.¹⁷

Kur u shfaq epërsia japoneze në fushën e industrisë dhe tregtisë botërore, në SHBA dhe Evropë u bashkuan univesitetet dhe institucionet hulumtuese për të studiuar efikasitetin japonez dhe epërsinë e madhe në “daljet-prodhimin-fitimin” që arriti Japonia në krahasim me “hyrjet-investimin” që ofronte. Këto studime vazhdojnë edhe sot e kësaj dite ku janë angazhuar mijëra pedagogë, psikologë, sociologë dhe menaxherë për të zbuluar pikat e dobëta në programet edukativo-arsimore amerikane dhe pikat e forta në sistemin edukativo-arsimor japonez. Po ashtu, universitetet në katedrat e tyre shkencore kanë caktuar lëndë të veçanta për të studiuar shkaqet e efikasitetit japonez në fusha speciale. Për studimin e kësaj çështjeje kanë përgatitur të gjitha nevojat e duhura, kanë nxjerrë qindra vëllime dhe kanë organizuar konferenca mes organizatave zyrtare dhe institucioneve ekonomike, jo vetëm për të mbetur në teori, por për zbatim.

Hulumtimet e nxjerra nga qendrat studiuese tregojnë se Japonia posedon një sistem edukativo-arsimor i cili ndikon kryesisht në efikasitetin e zhvillimit të Japonisë në rrafshin ekonomik dhe përparimin shoqëror.¹⁸

¹⁶ Richard M. Coughlin, **Morality, Rationality and Efficiency**: New York: M.E. Sharpe, Inc. 1991.

¹⁷ Simon Bulmer, **Efficiency, Democracy and West Federalism**, (Department of Government, Victoria Univesity of Manchester, UK, 1989).

¹⁸ Charlie G. Turner, **Japanese Dynamic Efficiency in the Global Market**, (New York: Quorum books, 1991).


KAPITULLI I DYTË

EDUKIMI, SHKALLËT E PJEKURISË SË PERSONALITETIT DHE FORMAT IDEOLOGJIKE DHE PSIKIKE

Bazamenti i parë mbi të cilin ngrihet zhvillimi i efikasitetit është që institucionet edukativo-arsimore të jenë të vetëdijshme rreth mënyrës së realizimit të “**pjekurisë së plotë në personalitetin e njeriut**”. Këto institucione duhet të ndihmohen nga organet e menaxhimit dhe sigurimit me qëllim të ruajtjes së kësaj pjekurie nga deformimi, sepse kjo pjekuri është kusht bazë për efikasitetin e njeriut dhe fuqisë së tij për realizimin e arritjeve, bartjen e përgjegjësisë dhe suksesit të projekteve.

Edukata e vetëdijshme punon për zhvillimin e pjekurisë së personalitetit njerëzor. Këtë e realizon përmes tri fazave të gjendjes psikologjike dhe shoqërore. Këto faza janë:

- Faza e varësisë (*dependence*);
- Faza e pavarësisë (*independence*);
- Faza e ndërvarësisë (*interdependence*). Grafiku në vijim e shfaq këtë realitet si vijon:




Njeriu, fëmijërinë e tij e fillon me fazën e parë, duke qenë i varur nga të tjerët në ushqim, përkujdesje dhe këshillim. Pa këtë mbështetje, ai nuk mund të vazhdojë jetën e tij, qoftë edhe për disa orë ose disa ditë. Më pas fillon pavarësinë graduale derisa të arrijë në një gradë që kujdeset për veten e tij dhe menaxhon çështjet e jetës së tij. Nëse ka jetë për të vazhduar në zhvillim, ai do të ngrihet në një shkallë të tretë të pjekurisë, e cila do të përfundojë në njërën prej dy formave:

1. *Pjekuri fizike, mentale dhe emocionale, gjë që do ta ndihmojë të bashkëpunojë me të tjerët, duke ruajtur pavarësinë dhe efikasitetin;*
2. *Pjekuri e mangët që përfundon në pjekuri fizike, por mentalisht dhe emocionalisht mbetet fëmijë ose adoleshent, ose arrin në pjekuri mentale dhe emocionale, por mbetet i varur ndaj të tjerëve në aspektin fizik.¹⁹*

Grafiku në vijim e sharon këtë realitet si vijon:

¹⁹ Stephen R. Covey, **The 7 Habits of highly Effective People**, (New York: Fireside Book, 1990), pp. 48-49.




Motivi në këtë fshihet se kur zhvillohet personaliteti njerëzor përmes këtyre tri fazave, atë e shoqëron gradualizimi tjetër në format mentale, psikike, shoqërore dhe fizike të njeriut, gjë që përfundon në njërin prej dy çështjeve:

1. *Format efikase, të cilat i mundësojnë përgatitjen e planeve mentale, psikike dhe fizike, përmes së cilave do të ketë mundësi në bartjen e përgjegjësisë dhe sukses në biznes dhe shfrytëzimin e shanseve që i ofrohen;*
2. *Format penguese që do të jenë pranga psikologjike që vështirësojnë përballimin e sfidave, ngarkesa shoqërore që e pengojnë bartjen e përgjegjësisë dhe perde mentale që e verbërojnë për të parë atë që i sjell dobi ose e dëmton.*

Format janë elemente të forta në personalitetin tonë. Ato kanë një tërheqje marramendëse në pjesën e pandërgjegjshmërisë. Njëjtë sikur gravitacioni në univers që mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ ndaj njeriut, po ashtu edhe gravitacioni i traditave mund të na pengojë nga realizimi i synimeve ose mund të na ndihmojë në rregullimin e përpjekjeve dhe ecjen drejt qëllimeve, ngjashëm siç rregullon gravitacioni punën e sistemit diellor, satelitët dhe yjet, duke i ruajtur ato gjatë lëvizjes së rregulluar. Forma fillon me:

- 1- *Farën e idesë, ndërsa nga ideja korrim punën;*

- 2- kur mbjellim punën, korrim traditën;
- 3- kur mbjellim traditën, korrim personalitetin;
- 4- kur mbjellim personalitetin korrim fatin dhe përfundimin tonë.²⁰ Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Edukata e vetëdijshme kupton këtë gradualitet në zhvillimin e traditave, kupton rolin që luajnë traditat në jetën tonë dhe përgatitet për zhvillimin e traditave të mira dhe ndryshimin e traditave të këqia. Kjo është esenca e edukatës peygamberike në fillim të islamit, duke u përballur fuqishëm me traditat e racizmit fisnor.

Në lidhje me format e lartshënuara japim një sqarim më të detajuar.

²⁰ Ibid, 46.


PJESA E PARË

Faza e varësisë dhe format ideologjike dhe psikike

Faza e varësisë sillet rreth një botëkuptimi të caktuar për ndikim dhe arritje, të përfshirë shkurt në fjalinë: **“ti je përgjegjës”**. Kjo lë të kuptohet se personi që është në këtë fazë, nuk ka efikasitet dhe gjithnjë mbështetet tek të tjerët për gjërat që dëshiron, duke i bërë ata përgjegjës për dështimin e tij. Dështimin e tij e arsyeton me fjalitë si më poshtë:

- *Ti je shkak për dështimin tim;*
- *Ti duhesh qortuar për atë që më ka ndodhur;*
- *Ti je përgjegjës për rezultatet;*
- *Ti nuk më ke udhëzuar;*
- *Ti nuk je kujdesur për mua.*
-

Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Njeriu që është fizikisht i varur, si, për shembull, personi i paralizuar ose me të meta fizike, ka nevojë për ndihmën e tjerëve. Nëse emocionalisht është i varur, atëherë ndjenjat për vlerën e tij dhe stabilizimin psikik i merr nga ajo çka thonë të tjerët për të. Nëse nuk e duan ose nuk e lavdërojnë, ndihet i dëshpëruar. Po nëse mentalisht

është i varur, atëherë ka nevojë për dikë që mendon për të në çështjet dhe problemet e jetës.²¹


Në realitet, personi që është në fazën e varësisë, është njeri që ka humbur vetëdijen dhe besimin në veten e tij. Kjo vetëdije është një fuqi me të cilën dallohet njeriu nga kafsha dhe i jep mundësinë për të parë dhe kuptuar atë që vepron. Sikur ti, që gjatë leximit të këtij libri të qëndrosh larg vetes sate dhe të përpiqesh të shohësh me sytë e mendjes se si lexon, si funksionon mendja dhe si përshtaten ndjenjat e tua, do ta gjesh veten sikur të ishe ndonjë person tjetër. Ne nuk jemi ndjenjat tona, as reaksionet e as mendimet tona, sepse ne mund të mendojmë me të gjitha këto, larg vetvetes sonë dhe botës që na rrethon.

Njohja me **“vetëdijen tonë”** është prej pikënisjeve më të rëndësishme të funksionalitetit tonë, ngase ajo na ndihmon të shohim veten dhe të tjerët, na mundëson të vlerësojmë përvojat tona dhe të të tjerëve, veprimet tona dhe të të tjerëve. Andaj, për shkak të kësaj fuqie, ne do të mund të ndryshojmë traditat tona të vjetra dhe, në vend të tyre, të zhvillojmë tradita të reja.

Mirëpo, **“pamjen e vetes”** dhe pamjen e të tjerëve nuk mund ta bëjë ai që zhvillimi i tij është ndalur në fazën e “varësisë”. Një gjë e tillë nuk mund të jetë e lehtë, përpos nëse bashkohen të gjithë faktorët:

- 1- *Përfshirë institucionet e zhvillimit shoqëror, në rend të parë familja;*
- 2- *Institucionet edukativo-arsimor, si shkolla dhe universiteti;*
- 3- *Institucionet e menaxhimit dhe udhëheqësisë. Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:*

²¹ Ibid, 49.



E gjithë kjo me qëllim të zhvillimit të shkathtësive intelektuale dhe sigurimin e një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin e drejtë të fuqisë mentale dhe të vullnetit, ku më e rëndësishme është ambienti i drejtësisë, lirisë dhe respektit reciprok të njerëzve. Nëse këto institucione dështojnë në punën e tyre, atëherë te njeriu do të formohen dy forma negative:

- a- **E para:** *pamundësia për të parë veten e tij;*
- 5- **E dyta:** *pamundësia për të marrë iniciativë dhe reaksion mekanik.* Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Sa i përket formës së parë, asaj të pamundësisë për të parë veten, këta njerëz nuk e shohin veten, përpos siç shihen nga të tjerët, gjë që në këtë hulumtim e quajmë “*pasqyra shoqërore*” që nënkupton mendimet, thëniet dhe pikëpamjet e njerëzve ndaj tyre. Kur “*pasqyra shoqërore*” bëhet burim i vetëm për të parë veten tonë, atëherë ne veten tonë do ta shohim si në paqyrat e karnavaleve, në të cilat fotografitë herë dalin të vogla e herë të mëdha, herë të qarta e herë të thyera, herë me sy të mëdha trishtuese e herë me sy të vegjël si vrima. Kështu do të jenë pikëpamjet tona ndaj vetes sonë individuale dhe kombëtare, varësisht nga pasqyrat shoqërore. Në këto situata, për ne muslimanët thuhet:

1. *Njeriu lindor nga natyra e tij është përtac dhe urren punën dhe sistemimin;*
2. *Njeriu arab në formimin e tij psikologjik është kundër bashkimit dhe bashkëpunimit;*
3. *Kultura arabe është kulturë e gjuhës dhe stilistikës;*
4. *Muslimani duron ndaj padrejtësisë duke pritur drejtësinë nga qielli;*
- 6- *Muslimani është armiqësor në formimin e tij psikologjik etj.* Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:




Edhe pse këto koncepte janë të copëtura dhe jo të ndërlidhura mes vete, ato në të shumtën e rasteve janë lëshime psikologjike të orientimeve të atyre që i shprehin ato.

Këto koncepte reflektojnë dukuritë e dobësisë së tyre më shumë se sa reflektojnë realitetin tonë, mirëpo, megjithatë, papjekuria jonë intelektuale dhe mbështetja jonë në “pasqyrat shoqërore” dhe të ngjashme me to, si pasqyrat politike dhe ato ekonomike, na bëjnë të shohim veten tonë përmes këtyre fotografive të përziera, gjëra që nxisin destabilizim dhe luhatje në punët dhe reagimet tona. Kështu është gjendja e shumicës absolute të njerëzve të Botës së Tretë, përfshirë edhe shtetet arabe dhe islame bashkëkohore. Është kështu për arsye se sistemet edukativo-arsimore dhe sistemet e vlerësimit në këto shtete:

- në rend të parë - janë vertikale ku njeriut i imponohet të dëgjojë pa diskutuar fare dhe të zbatojë atë që kërkohet pa të drejtë për të pyetur;

1- **- së dyti** - të saktën dhe gabimin, si dhe të mirën dhe të keqen, e vlerëson sipas kriterëve të asaj “se çka do të thonë njerëzit”! Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Kur’ani Famëlartë, këtë traditë e quan “**syfaqësi**”, duke u tërhequr vërejtjen njerëzve që e bëjnë atë se do të dështojnë në punët e tyre dhe do të kenë përfundim të keq. Kjo vërehet në ajetet e mëposhtme:

”يُرَءَوْنَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا”

“Veprojnë vetëm sa për t’u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin Allahun.”²²

“وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ خَرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بَطَرًا وَرِئَاءَ النَّاسِ”


“Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t’i parë bota.”²³

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَبْطُلُوا صِدْقَاتِكُمْ بِالْمَنِّ وَالْأَذَى”

“O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar dhe me ofendim.”²⁴

“الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ”

“Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe) dhe pengojnë dhënien e ndihmës.”²⁵
Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Gjithashtu, i Dërguari i Allahut, Muhamedi s.a.v.s., në dhjetëra hadithe u tërheq vërejtjen njerëzve të tillë, duke i nxitur besimtarët të mos i përshtaten momentit, në atë mënyrë që kur njerëzit bëjnë mirë, edhe ata bëjnë mirë, ndërsa kur njerëzit bëjnë

²² En Nisa': 142.

²³ El Enfal: 47.

²⁴ El Bekare: 264.

²⁵ El Maun: 6-7.

keq, edhe ata bëjnë keq. Muhamedi s.a.v.s. i nxit besimtarët të jenë të vendosur dhe të udhëzuar me bindjet e tyre të pavarura, në atë mënyrë që kur njerëzit bëjnë mirë, edhe ata bëjnë mirë, ndërsa kur njerëzit bëjnë keq, ata largohen nga e keqja.

Sa i përket formës së dytë të varësisë, të cilën e quajmë “reaksion mekanik”, në këtë rast personi humb fuqinë e iniciativës dhe të gjitha veprat e tij janë vetëm reaksione mekanike, të padrejtura dhe të pakontrolluara nga mendimi apo vullneti i lirë. Njerëzit që kanë reaksione mekanike vuajnë nga dobësia e të menduarit dhe zgjedhjes. Ata bëhen viktimë të rrethanave dhe veprimeve të jashtme, si dhe janë të pamundur të kontrollojnë emocionet e tyre, qortojnë të tjerët për problemet me të cilat ballafaqohen, janë të verbër për të kuptuar ngjarjet dhe burimet e ndikimit, vrapojnë pas të tjerëve për të kërkuar ndihmë e konsultë dhe veten e tyre e bëjnë gjah për keqpërdorësit.

Veprimet tona janë vetëm reaksione mekanike, për arsye se zhvillimi në familje ka qenë imponues, edukimi dhe arsimimi në shkollë ka qenë diktues, sistemi i menaxhimit ka qenë detyrues dhe sistemi i gjyqimit ka qenë i padrejtë, që ka synuar neglizhimin, ose ka qenë i qëllimtë për të përforcuar reaksionet mekanike, duke synuar dominimin ndaj tyre. Me këtë përzgjedhje mekanike të gabueshme, veprimet tona janë bërë vetëm reaksione dhe reflektime të nënshtruara ndaj epsheve dhe emocioneve tona. Ky është problemi i parë në personalitetin e njeriut bashkëkohor në Botën e Tretë, përfshirë atë islame dhe arabe. Çdo përpjekje për reformim dhe ripërtëritje që nuk fillon nga analizimi i kësaj problematike, duke i bashkuar të gjitha përpjekjet shkencore për studimin dhe trajtimin e saj, do të jetë vetëm një përvojë e dështuar në ciklin e përpjekjeve për reformim, të cilat kanë dështuar më herët ose janë ngurtësuar në kohën e tashme nga fakti se edhe kjo përpjekje do të jetë, gjithashtu, vetëm një reaksion nën parullën e reformimit dhe të ripërtëritjes.

Personin e varur, Kur’ani Famëllartë e quan “كَالْ” (*kel-len*), duke theksuar se prej vetive të këtij personi është se ai gjithnjë është i varur nga zotëriu i tij dhe se ngado që ta udhëzosh atë, ai nuk sjell asnjë dobi. Ndërsa i Dërguari i Allahut këtë gradë e quan “عَجْزٌ” (*axhzun-dobësi, pamundësi*) duke kërkuar prej Allahut mbrojtje prej saj dhe thoshte: “O Zot kërkoj mbrojtje prej Teje nga pamundësia dhe përtacia.”²⁶

Gjithë institucionet, duke përfshirë familjen, institucionet edukativo-arsimore, institucionet menaxhuese dhe ato sunduese, bashkëpunojnë për të zhvilluar “varësinë” dhe për të thelluar traditat vdekjeprurëse, duke filluar nga nëna në familje, e cila në mënyrë ekstreme ruan fëmijën nga çdo gjë që e rrethon duke e

²⁶ Transmeton Buhariu në Sahih, libri “Ed-Deavatu”.

mbajtur duarlidhur nga aventurat dhe njohja e gjërava përreth tij, deri në atë shkallë saqë i bën gati ushqimin, veshjen dhe fjetjen si dhe merr përgjegjësinë edhe për vendin e këmishës, pantallonave, këpucëve që nga fëmijëria derisa të rritet dhe të bëhet burrë.

Në anën tjetër, babai i imponon të gjitha traditat dhe e frikëson nga çdo e re, duke i kërkuar llogari për çdo dalje dhe hyrje. Kjo çështje vazhdon te mësuesi, i cili të vërtetën e kufizon vetëm në fjalët që ai i dikton nxënësit, për të, ai lexon dhe mendon, si dhe kufizon lëvizjet e tij. Të njëjtën e gjejmë edhe në plan-programet mësimore, në të cilat gjen ose të “*kaluarën e gjyshërve*” lulëzues ose të “*tashmen e të huajve*” përparues. E njëjta gjë vazhdon edhe në instancat më të larta, duke përfshirë udhëheqësit e punëve, administratës, partive, shoqatave dhe institucionet udhëheqëse, të cilat veprojnë sipas logjikës faraonike: “مَا أُرِيكُمْ إِلَّا مَا أَرَى” **“Nuk shoh për juve mendim tjetër pos asaj që unë e shoh”**²⁷ dhe duke përfunduar me popujt të cilët heqin dorë nga përgjegjësia, tamam siç tregon Kur’ani për Beni Israilët, të cilët i thanë Musait a.s.: “فَاذْهَبْ أَنْتَ وَرَبُّكَ فَقَاتِلَا إِنَّا هَاهُنَا قَاعِدُونَ” **“Shko ti dhe Zoti yt luftoni, ndërsa ne do të qëndrojmë këtu.”**²⁸ Kur ata shohin rezultatet e dështuara, gjithë këtë e arsyetojnë se ka qenë vullneti i Allahut, edhe pse Allahu nuk krijon rezultate përpos pasi rob i të marrë masat.

Rezultati përfundimtar i gjithë këtyre orientimeve dhe veprimeve është përhapja e “imitimit dhe varësisë” në gjitha aktivitetet dhe nivelet. Fëmijët, të rinjtë, burrat dhe gratë imitojnë të tjerët dhe mbështeten tek ata në ngrënien, pirjen, veshjen, mjetet e transportit, mjetet e informimit, dhe më pas i imitojnë ata në sjellje, pamje, tradita, arte dhe raportet e tyre. Qeveritë dhe shtetet imitojnë të tjerët në politikat, sistemet, admintrimet dhe institucionet. Mendimtarët, pedagogët, letrarët, artistët etj. janë të pamundur të studiojnë realitetin dhe ta analizojnë atë, por mbështeten ose në thesarin e gjyshërve të tyre, ose importimin e veprave të kolegëve të tyre në shtete të tjera. Aktivistët në fushën e reformimit mbështeten në importimin e ideologjive dhe programeve të të tjerëve. Ngjashëm me ta janë edhe ekonomistët, sportistët, ushtarakët etj., duke përfshirë të gjitha poret e jetës.

²⁷ Gafir: 29.

²⁸ El Maide: 24.


PJESA E DYTË

Faza e pavarësisë dhe format ideologjike dhe psikike

Ekzistimi i “*pavarësisë nga të tjerët*” përqendrohet rreth një botëkuptimi të caktuar të efikasitetit dhe zbatimit, bazë e së cilës është thënia: “Unë jam përgjegjës.” Njeriu në këtë fazë bart përgjegjësitë e tij dhe përballlet me sfidat.

Pikëpamjet dhe pikënisjet e tij në punë, ngrihen mbi thëniet e mëposhtme:

- a- *Unë mbështetem në veten time;*
- b- *Unë kam mundësi të zgjedh;*
- c- *Unë jam përgjegjës për dështimin;*
- d- *Unë jam përgjegjës për trajtimin e çështjeve.* Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Njeriu i pavarur nga të tjerët fizikisht, do të realizojë vetëm nevojat dhe përgjegjësitë e tij materiale. Nëse ai është i pavarur intelektualisht, atëherë do të zhvillojë bindjet e tij nga brendia dhe do të orientohet në vetveten e vet. Po nëse ai është i pavarur edhe emocionalisht, atëherë nuk do të ndikohen ndjenjat e tij nga bashkëveprimi me të tjerët.

Faza e “*pavarësisë nga të tjerët*” është më e mirë se faza e “*varësisë*”. Zakonisht, orientimet shoqërore lavdërojnë fazën e “*pavarësisë*” dhe nxisin për të, sepse nëse

krahasohet me fazën e “varësisë” shihet qartë vlera e saj, ngase ajo liron njeriun nga dominimi dhe shfrytëzimi i të tjerëve, duke e mënjeluar atë nga të gjitha fatkeqësitë dhe dëmet që vijnë si rezultat i varësisë ndaj tyre.²⁹

Këtë fazë, në jetën reale e pasqyrojnë **tri** forma efikase, të cilat çojnë në efikasitetin e performancës dhe të zbatimit, respektivisht suksesit. **Këto tri tradita janë:**

Forma e parë: fuqia për marrjen e iniciativës.


Personat e tillë cilësohen me dy cilësi: e para: ata kanë realizuar një shkallë të lartë të pjekurisë mentale, gjë që u mundëson “besim dhe vetëdije me veten”. Ata shohin veprat e veta, i analizojnë dhe i vlerësojnë ato, për të parë shkallën e saktësisë dhe të gabimit. Për këtë, ata janë të fuqishëm për përcaktimin e asaj që dëshirojnë të punojnë dhe më pas marrin iniciativën për realizim e përgjegjësi që bartin. Natyrës njerëzore në esencë i duhen caktuar objektivat dhe më pas duhet marrë iniciativë për realizimin e këtyre objektiveve, e jo t’u lihet në duar të tjerëve të formojnë jetën tonë dhe të vendosin për fatin tonë.³⁰

Me shprehjen “marrje e iniciativës” është për qëllim që veprat tona të mos jenë reaksion mekanik ndaj ndikimeve të jashtme, të cilat sillen përreth nesh, pa pasur ne ndikim në to, siç është rasti me personat në fazën e “varësisë”, ngase, në esencë, njeriu nga natyra e tij është i fuqishëm për të përballuar ndikimet e jashtme dhe për të zgjedhur reaksionin që ngrihet mbi bazën e njohjes së vetes së tij. Ai:

- I. ka fuqinë e **perceptimit** të gjërave,
- II. ka **ndërgjegje**, respektivisht njohje të thellë të brendshme rreth të saktës dhe gabimit,
- III. ka **vullnet** të pavarur, respektivisht fuqi për lëvizje, duke u bazuar në njohjen e vetes së tij dhe i liruar nga ndikimet e tjera. Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:

²⁹ Stephen R. Covey. Op. Cit, pp. 49-50.

³⁰ Ibid, pp. 75-79.




Sa i përket teorive të psikologjisë së kushtëzuar, të cilat konsiderojnë sjelljen e njeriut vetëm si reaksion i kushtëzuar dhe mekanik, mund të themi se ato janë nxjerrë nga eksperimentet e bëra ndaj kafshëve, në veçanti minjve, majmunëve, pëllumbave, qenve dhe individëve me probleme psikologjike. Këto teori nuk mund të japin koment ndaj sjelljes së njeriut, ngase rrethanat elementare të formimit të njeriut e bëjnë atë të jetë mbi botën e kafshëve. Njeriu, krahas çështjes së stimulimit dhe reaksionit, posedon edhe lirinë e zgjedhjes dhe, si rezultat i saj, zhvillohet tradita më e madhe të njeriut dhe shumë efikase, ajo është tradita e proaktivitetit (*proactivity*), që nënkupton se ne si lloj njerëzor jemi përgjegjës për jetën tonë dhe se sjellja jonë është rezultat i vendimeve tona të vetëdijshme dhe të qëllimta, e jo reaksion i kushtëzuar. Po ashtu, ne kemi mundësinë që ndjenjat tona t'ua nënshtrojmë vlerave, si dhe posedojmë iniciativën dhe përgjegjësinë për të orientuar çështjet në drejtimin e duhur.

Dallimi mes atyre **që kanë fuqinë e marrjes së iniciativës** dhe atyre **që nuk kanë këtë fuqi** është si dallimi i ditës me natën.

- 1- *Grupi i parë* kanë mundësinë e gjetjes së alternativave të sjelljes së kërkuar, duke zgjedhur sjelljen e përshtatshme. Kanë mundësi të kontrollojnë nervozën dhe të përdorin metodat e përzgjedhura. Llogarisin veten përgjegjës për të përballuar sfidat dhe për të realizuar arritjet. Kanë mundësinë për të kuptuar situatat dhe burimet e ndikimit. E gjithë kjo iu mundëson të përcaktojnë

objektivat përfundimtare dhe të përcaktojnë mjetet, institucionet dhe përgatitjet e nevojshme për realizimin e këtyre objektivave.

- 2- *Ndërsa grupi i dytë* ndien dobësi në të menduar dhe në zgjedhje. Ata ndihen viktimë e rrethanave dhe ndikimeve të jashtme, goditen me frikë dhe nervozizëm të tepruar. Qortojnë të tjerët në sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen. Nuk kuptojnë situatat e as burimet e ndikimit. Vrapojnë tek të tjerët duke kërkuar ndihmë dhe këshillim duke rënë viktimë e dështimit dhe shfrytëzimit. Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Personat që kanë fuqi të zgjedhin reaksionet, nuk i nënshtrohen ashpërsisë së klimës natyrore. Ata e bartin me vete gjendjen klimatike. Për ta është njësoj koha me shi ose e kthjellët. Ata, duke bartur vlerat dhe parimet e tyre, ecin në drejtimin e tyre, të cilin e kanë zgjedhur me vetëdije, njohuri dhe vullnet. Kur vlerat nxisin për punë dhe arritje, atëherë gjendja klimatike nuk mund të ndikojë në aktivitetin dhe arritjen e tyre. Është e drejtë të thuhet se njeriu bashkëkohor, i cili jeton në Amerikë dhe në

Evropën e ftohtë, nuk është ndikuar dhe vazhdon të mos ndikohet nga kushtet klimatike, duke vrapuar në të gjitha pjesët e tokës për të hulumtuar rreth zbulimeve gjeografike dhe shkencore, si dhe për të kërkuar vende për okupim. Ai kudo që shkon, i nënshtron kushtet klimatike, e nuk nënshtrohet ndaj tyre dhe e përshtat ngrohjen dhe ftohjen, sipas objektivave të tij të përcaktuara.

Sa i përket personave, të cilët sjelljet e tyre janë vetëm reaksion mekanik, në të shumtën e rasteve i përshtaten ndikimeve të kushteve klimatike. Nëse koha është e mirë, edhe sjellja dhe disponimi i tyre është i mirë, po nëse koha është e keqe, edhe orientimet e tyre keqësohen dhe arritjet e tyre pakësohen. Kur këto veprime mekanike përsëriten në jetën e tyre, ato bëhen pjesë e kulturës dhe traditave të tyre. Kjo është gjendja e shumë prej popujve bashkëkohorë të Botës së Tretë, të cilët shfrytëzohen nga natyra dhe nuk dinë ta shfrytëzojnë atë dhe vazhdojnë të mbesin viktimë e thatësisë, temperaturave të larta, katastrofave natyrore, mungesës së ujit dhe vërshimeve të lumenjve dhe detrave.

Personat që kanë fuqinë e iniciativës dhe përcaktimit të objektivave dhe mjeteve janë njerëz gjithnjë të nxitur nga vlerat dhe parimet e tyre. Ata janë të fuqishëm të nënshtrojnë ndjenjat e tyre ndaj vlerave duke menduar thellësisht dhe pa nxitim. Është e vërtetë se edhe ata ndikohen nga rrethanat e jashtme shoqërore dhe psikologjike, por reagimi ndaj këtyre ndikimeve është i kontrolluar nga vlerat që i posedojnë, me vetëdije ose pa vetëdije.

Personat që cilësohen me reaksion mekanik ndikohen nga rrethanat shoqërore në mënyrë mekanike. Kur njerëzit sillen me ta mirë, ata ndihen mirë dhe rehat, por, nëse njerëzit nuk sillen me ta mirë, atëherë, u prishet disponimi, ndihen nervoz dhe kalojnë tërë kohën duke mbrojtur veten dhe duke arsyetuar sjelljet dhe veprimet e tyre nga thashethemet.

Personat që kanë fuqinë e iniciativës dhe përcaktimit të objektivave dhe mjeteve ndërveprojnë me klimën politike në mënyrë të lirë. Ata studiojnë natyrën e periudhës në të cilën kalojnë, duke përcaktuar objektivat dhe duke përzgjedhur mjetet e përshtatshme.

Personat që cilësohen me reaksion mekanik, ndikohen nga klima politike dhe ushtarake në mënyrë mekanike. Kur qetësohen stuhitë politike dhe luftarake përreth ose afër tyre, ata mendojnë se bota është shndërruar në kopsht sigurie dhe paqeje, duke harruar dhe anashkaluar përgatitjen dhe duke u marrë me kënaqësitë e kësaj bote. Por, kur destabilizohet siguria, ndryshojnë politikat dhe befasohen me rreziqe,

vrapojnë në kryeqendrat e botës dhe institucionet ndërkombëtare për të kërkuar drejtësinë e humbur.

Mënyra e parë është ajo që praktikojnë politikat izraelite, ndërsa mënyra e dytë është ajo e politikave arabe në konfliktin arabo-izraelit që prej më shumë se një shekull. Ngjashëm me të është edhe veprimi i grupacioneve dhe partive aktive në Izrael, shtetet arabe dhe islame. Në kohën kur Izraeli është i vetëdijshëm për mosmarrëveshjet në mjetet dhe qëndrimin unik në objektivat, duke ia lënë kohës, praktikës dhe popullit të drejtën e shfaqjes se cili grup është në të drejtë, vërejmë se partitë politike dhe grupacionet e ndryshme në vendet arabe dhe islame, paraprakisht vendosin se e drejta absolute është pikërisht në atë që ato mendojnë, ndërsa gabimi absolut është tek të tjerët. Kështu ngrihet niveli i nervozizmit dhe reaksionet mekanike, pa llogaritur në rezultatet negative të mundshme. Ajo që na dëmton më së shumti nuk është ajo që na ndodh neve, por pajtimi ynë me atë që na ndodh. Është normale që ne të dëmtohem fizikisht ose ekonomikisht, por personaliteti dhe identiteti ynë nuk duhet dëmtuar fare. Këtë e ka vërejtur Elinor Rozfelt, duke thënë: “Askush nuk mund të na dëmtojë pa pëlqimin tonë...” Ngjashëm me këtë ka thënë edhe Gandi: “Britanikët nuk mund të na privojnë nga dinjiteti ynë nëse ne vet nuk heqim dorë nga ai.”

Në realitet, përvojat më të rënda tonat, mund të vijnë si rezultat i sprovave të vështira, të cilat formojnë personalitetin tonë dhe zhvillojnë fuqitë tona të brendshme, zhvillojnë në brendinë tonë lirinë e bashkëveprimit me kushtet e rënda në të ardhmen dhe na bëjnë model të mirë për të tjerët.

Cilësia e dytë e personave që kanë fuqinë e marrjes së iniciativës është se ata kanë realizuar një shkallë të lartë të pjekurisë emocionale, duke u liruar vullneti i tyre nga epshet dhe nervozizmat e pakontrolluara. Kështu ata bëhen të fuqishëm për zgjedhjen e sjelljeve alternative të përshtatshme për situatën dhe përcaktimin e veprave dhe fushave në të cilat përqendrojnë energjinë dhe kohën e tyre. Zakonisht çdo njeri ka një grumbull të madh të interesave dhe problemeve, të cilat mund të grumbullohen në një rreth, të cilin mund ta quajmë **“rrethi i interesimeve”**.


grumbulli i interesimeve
dhe problemeve

“rrethi i interesimeve”.

Po ashtu, rrethin e interesimeve mund ta ndajmë në dy rrathë të tjerë: “*rrethi i intereseve*” rreth gjërave që nuk mund të ndikojmë dhe “**rrethi i ndikimit**” rreth çështjeve që mund të ndikojmë.




Niveli i efikasitetit të njeriut kufizohet përmes njohjes se në cilin prej dy rrathëve ai përqëndron përpjekjet e tij dhe kalon pjesën më të madhe të kohës së tij. Ata që përqendrojnë përpjekjet e tyre në rrethin e ndikimit, cilësohen me efikasitet dhe urtësi, ngase ata veprojnë në një fushë në të cilën mund të arrijnë diçka. Energjia e tyre harxhohet në vendin e vet dhe ndikimi i tyre është evident. **Rrethi i ndikimit tek ata shkon duke u rritur dhe duke u zhvilluar.**



Ata që nuk janë efikas duke vepruar me reaksione mekanike, ata harxhojnë kohën e tyre në rrethin e interesave që nuk kanë ndikim. Kur dështojnë, e zëvendësojnë atë duke u përqendruar në kritikën ndaj dobësive dhe mangësive të të tjerëve, për çështjet dhe problemet që nuk kanë dorë dhe përfundojnë duke akuzuar të tjerët. **E gjithë**

kjo shpie në humbjen e energjisë jo në vendin e vet si dhe tkurrjen e rrethit të ndikimit.



Në realitet, sa më shumë që përqendrojmë përpjekjet tona në rrethin e interesimeve, e jo në rrethin e ndikimeve, aq më shumë do të ndihmojmë në rritjen e problemeve që dominojnë ndaj nesh.³¹

Kjo është natyra e mendimit të njeriut që e nxjerrin institucionet tona edukativo-arsimore në shtetet arabe dhe islame. Njeriu në këto shoqëri harxhon gjithë energjinë e tij intelektuale, psikologjike dhe materiale në rrethin e interesimeve të tij, duke anashkaluar rrethin e ndikimit. Praktikrat e këtij mendimi të gabuar janë të qarta në politikat e qeverive zyrtare, aktivitetet që realizojnë partitë dhe grupacionet kombëtare dhe islame, si dhe jetën që e jetojnë individët e rëndomtë.


Qeveritë lënë pas dore “rrethin e ndikimit” ku njerëzit mund të drejtojnë energjitë e tyre, realizimin e drejtësisë, shanset e barabarta, formimin e unitetit kombëtar, ruajtjen e të gjithë resurseve njerëzore, mendore dhe materiale, si dhe shfrytëzimin e drejtë të tyre si premisë për formimin e umetit dhe unitetit kombëtar të fuqishëm për të përballuar sfidat dhe për të plotësuar nevojat. Në vend që të merren me këtë, ata kërcejnë në “rrethin e interesimeve” ku drejtohen për të përfituar simpatinë e fuqive të jashtme, punojnë për të përfituar mbështetjen e tyre në organet ndërkombëtare dhe duke kërkuar ndihmën e tyre në çështjet e paqes dhe të luftës.

³¹ Ibid, pp. 81-83.

Partitë dhe grupacionet e ndryshme lënë pas dore luftimin e sëmundjeve të brendshme, siç janë: analfabetizmi ideologjik, racizmi, zhvlerësimin e njeriut, sulmit ndaj lirisë së tij në pronësim, mendim dhe shprehje si hap për rimëkëmbje prej dobësisë nga brenda dhe okupimit nga jashtë. E lënë gjithë këtë dhe kërcejnë në *“rrethin e interesimeve”* që përfshijnë nxitjen për të sulmuar interesat e okupatorit në çdo vend, duke përdorur metoda jo të pjekura që shtrembërojnë pamjen e umetit në botë dhe ndihmojnë ata që shfrytëzojnë dobësinë e umetit për të përforcuar edhe më shumë sundimin e tyre, duke nxitur gjithë botën kundër tyre, duke u bazuar se kinse janë duke e luftuar terrorizmin dhe duke e penguar ekstremizmin, gjë që shkakton ngushtimin e *“rrethit të ndikimit”* të këto parti dhe grupacione.

Individi i thjeshtë, i cili jeton në vendet arabe dhe islame, kalon ditën dhe natën duke menduar dhe polemizuar në *“rrethin e interesave”* që përfshin domosdoshmërinë e luftimit të fuqive okupuese dhe sioniste dhe duke i dënuar bashkëpunëtorët e tyre, qofshin udhëheqës apo qeveri. Në anën tjetër, harron *“rrethin e ndikimit”*, duke lënë pas dore studimin nëse është student, duke u bërë përtac në punën e tij, nëse është punëtor, duke i nëpërkëmbur të drejtat e të tjerëve, nëse është përgjegjës, duke vjedhur, mashtruar e monopoluar nëse është tregtar. Kjo gjendje vlen në të gjitha çështjet e *“rrethit të ndikimit”* ku ka mundësi të kryejë me përpikëri dhe ta trajtojë problemin që më pas e gjithë kjo të ndikojë në përmirësimin e *“rrethit të interesimeve”*.


Në disa rrethana, të disa njerëz, për shkak të pozitës, raporteve të gjera, pasurisë etj., *“rrethi i ndikimit”* është më i madh se *“rrethi i interesimeve”*.



Kjo gjendje reflekton dritëshkurtësinë dhe egoizmin, sepse te personat efikas, së paku, është i barabartë “*rrethi i interesimeve*” me “*rrethin e ndikimit*” dhe bartin përgjegjësi për të shfrytëzuar ndikimin e tyre në mënyrë efikase. Shembuj për këtë kemi udhëheqësit politik, ekonomik, ideologjik dhe fetar, të cilët lënë pas dore përgjegjësitë për të udhëhequr popujt e tyre dhe preferojnë të merren me epshet dhe kënaqësitë brenda rrethit të racizmit familjar, fisnor, lokal dhe grupor. Ekzistimi i këtyre elementeve është shenjë e prerë për joefikasitetin dhe dështimin e sistemeve edukativo-arsimore dhe kulturës dominuese. Gjithashtu, ky është argument se rishikimi i këtyre sistemeve edukativo-arsimore dhe kulturore është prioriteti numër një i programeve reformuese.


Sfida me të cilën përballemi në lidhje me “*rrethin e interesimeve*” dhe “*rrethin e ndikimit*” është nevoja për përcaktimin se sa kontrollojmë problemet reale brenda rrethit. Si zakonisht, ky kontroll ndahet në tri pjesë:

- 1- **Kontrollim i drejtpërdrejtë:** ky lloj përfshin problemet që ndërlidhen me mendimet, orientimet dhe sjelljet tona.
- 2- **Kontrollim indirekt:** ky lloj përfshin problemet që ndërlidhen me mendimet, orientimet dhe sjelljet e të tjerëve.
- 3- **Pa kontrollim në mënyrë absolute:** ky lloj përfshin problemet që nuk mund të bëjmë asgjë përballë tyre. Grafiku në vijim e sqaron këtë çështje:



Metodat efektive për secilin prej këtyre tri llojeve të problemeve ofrojnë zgjidhje të veçanta.


- 1- a-Problemët për të cilat kemi kontroll të drejtpërdrejtë i përballojmë përmes** punës për ndryshimin e traditave, mendimeve, pikëpamjeve dhe vlerave tona, sepse të gjitha këto bien në rrethin e problemeve që mund të depërtojmë te ato. Zbatimi praktik i këtij përballimi është të rishikojmë plan-programet dhe institucionet tona edukative, duke filluar nga edukimi familjar dhe duke vazhduar në edukim shkollor, universitar, ushtarak, administrativ, politik etj., duke u bërë një kontroll të hollësishëm dhe të sinqertë. Më pas duhet bërë trajtimi që propozon ky diagnostifikim, duke ndryshuar atë që kërkon ndryshim dhe duke reformuar atë që kërkon reformim. Grafiku në vijim e sqaron këtë çështje:



b-Sa i përket problemeve për të cilat kemi kontroll indirekt, ato i përballojmë përmes punës për ndryshimin e metodave të ndikimit ndaj të tjerëve. Ata të tjerët ndahen në dy grupe. Një grup jeton në mesin tonë brenda mendimeve tona dhe i përket popullit tonë, por dallon nga ne në mendime, pikëpamje dhe sjellje. Grupi i dytë është ai grup që jeton jashtë vendeve, besimit dhe kulturës sonë. Raporti ynë me këtë grup është raport ndikimi pozitiv dhe negativ.

Sa u përket atyre që janë nga mesi jonë dhe jetojnë me ne në një vend, me ta duhet hapur rrugë të reja për dialog dhe mirëkuptim që synon arritjen në pikënisje të përbashkëta që i sigurojnë çdonjërit lirinë e jetës, qëndrimit dhe shprehjes dhe lejon bashkëpunimin për sigurimin e këtyre të drejtave. Me këtë veprim i shmangemi kontakteve provokative dhe çrregullimeve që shkaktojnë humbjen e energjive dhe sjellin dështimin e përpjekjeve.

Sa u përket atyre që jetojnë jashtë vendeve, besimit dhe kulturës sonë, me ta duhet bërë përpjekje për t'i kuptuar. Kjo realizohet duke themeluar qendra studimi që na njohin me bazat e tyre historike, filozofike, shoqërore dhe kulturore, si dhe me motivet e tashme të sjelljeve dhe orientimet e tyre për të ardhmen. Përmes këtyre njohurive zhvillojmë forma të reja të diskursit përmes të cilave paraqesim veten para tyre dhe para botës përreth nesh: *“Diskurs që ngrihet në nivelin e ndikimit në mendimet e tyre dhe mendimet e udhëheqësve që në duart e tyre kanë të drejtën e sjelljes së vendimeve.”* .Grafiku në vijim e sqaron këtë çështje:



c-Sa i përket problemeve për të cilat nuk kemi fare kontroll ndaj tyre, duhet mësuar të bashkëjetojmë me to, pa reaksione të pakontrolluara, edhe pse i urrejmë ato. Grafiku në vijim e sqaron këtë:



Më pas duhet pritur momentin kur këto probleme marrin pjesë brenda rrethit të ndikimit tonë dhe, në këtë rast, fillojmë të parballemi me to dhe t'i trajtojmë si duhet.

Me këtë mënyrë, nuk e shtojmë fuqinë e këtij lloji të problemeve, e as nuk i japim shansin për ta shtuar kontrollin ndaj nesh. Këtë lloj të bashkëjetesës me këto probleme për të cilat nuk kemi kontroll, Kur’ani e trajton përmes tri strategjive:

1- durim me të mirë;

2- largim me të mirë;

3- falje me të mirë. Kjo shihet qartë në ajetet kur’anore:

"فَاصْبِرْ صَبْرًا جَمِيلًا"

“Ti, pra, duro me një durim pa ankesë (të mirë).”³²


"وَاهْجُرْهُمْ هَجْرًا جَمِيلًا"

“Dhe largohu prej tyre i matur.”³³

"فَاصْفَحِ الصَّفْحَ الْجَمِيلَ"

“E ti sillu me njerëzshmëri.”³⁴

Ibn Tejmije gjatë komentimit të këtyre ajeteve, ka thënë: “Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij të largohet prej tyre në mënyrë të mirë, të falë në mënyrë të mirë dhe të durojë në mënyrë të mirë. **Largim i mirë është largim pa dëmtim, falje e mirë është falje pa qortim dhe durim i mirë është durim pa ankim.**”³⁵, siç vërehet në grafikun në vijim:



³² El Mearixh: 5.

³³ El Muzzemmil: 10.

³⁴ El Hixhr: 85.

³⁵ Ibn Tejmije, “El Fetava”, Ilmus suluk, vëll. I, f. 666.

Ekziston edhe një çështje mjaft e rëndësishme që ndërlidhet me raportin mes “*rrethit të interesimeve*” dhe “*rrethit të ndikimit*”. Kjo çështje është se edukimi i njeriut për të kontrolluar mirë koncentrimin në “*rrethin e ndikimit*” rezulton në efikasitetin për të zgjeruar këtë rreth dhe për të përfituar hapësira të reja nga “*rrethi i interesimeve*”, ngase kufijtë e përafërt në të dy anët e dy rretheve e bëjnë që ndikimi të jetë i mundshëm në çështjet që bien në “*rrethin e interesimeve*”, të cilat janë afër “*rrethit të ndikimit*”.

Për të ilustruar dhe sqaruar këtë çështje, do të sjellim një shembull nga lideri indian, Gandhi. Ai për të përballuar okupatorin britanik u koncentrua në “*rrethin e ndikimit*” në të cilin çdo indian mund të marrë pjesë. Ai ftoi në bojkotim ekonomik ndaj okupatorit, duke filluar me bujqit, respektivisht prodhuesit e orizit, i cili përbënte materien kryesore të tregtisë së okupatorëve. Oponentët e Gandit prej indianëve filluan përpjekjet e tyre përmes rezistencës ushtarake që përfshihej në “*rrethin e interesimeve*”, gjë që ishte e pamundur që popullata indiane të marrë pjesë, për shkak të dallimit të madh në fuqinë ushtarake mes Indisë dhe Britanisë. Rezultati i gjithë kësaj ishte se metoda e Gandit ishte efikase, ngase i mundësoi pjesëmarrje çdo indiani dhe e detyroi qeverinë britanike t’i përgjigjet kërkesave të tij për liri dhe pavarësi përderisa në procesin e okupimit më e madhe është humbja se sa fitimi.

Forma e dytë: Fuqia për përcaktim logjik të qëllimit dhe praktikave të tij.

Realizimi i kësaj tradite arrihet përmes përgatitjes së aktivistëve për të qenë të përpiktë në disa praktika:

Praktika e parë

Kristalizimi i një botëkuptimi të qartë se ku duam të shkojmë, me qëllim që ky botëkuptim të jetë kriter për çdo veprim që dëshirojmë të realizojmë sot, nesër, javën e ardhshme, muajin e ardhshëm, vitin e ardhshëm apo dekadën e ardhshme. Krahës kësaj, duhet pasur kujdes për të pasur të qartë qëllimin e përgjithshëm dhe përfundimtar për t’u ardhur në ndihmë aktivistëve, të cilët duhet të bëjnë kujdes që të mos bien në kundërshtim veprat e tyre të përditshme me kriterin që kanë përcaktuar, si dhe t’u vihet në ndihmë për përcaktimin e mjeteve të nevojshme dhe kuptimin e fillimit dhe ecjes drejt qëllimit përfundimtar. Nëse nuk caktohet qëllimi përfundimtar, atëherë është shumë e lehtë që aktivistët të gjejnë veten në pikat e

dështimit, **se janë duke u ngjitur në shkallët që janë vendosur në murin e gabuar** dhe se janë **duke u lodhur me punë të rënda pa realizuar asnjë efikasitet**.

Fillimi me “*përcaktimin e qëllimit në mënyrë logjike*” ngrihet mbi një parim të rëndësishëm natyror. Ky parim thotë se çdo gjë lind dy herë:

1-lindje logjike;


2- lindje materiale.

Sikurse ai që dëshiron të ndërtojë një shtëpi, para se të vendosë gurin e themelit, ka nevojë për një parafytyrim të kësaj shtëpie. Më pas parafytyrimin e tij e nxjerr në plan të shkruar në letër, i cili më pas shndërrohet në ndërtesë të ngritur. Zbatimi i këtij parimi mund të realizohet në të gjitha sferat e jetës, ku veprimi fillon me përcaktimin e përfytyrimit, e më pas ky përfytyrim shndërrohet në veprime praktike sipas kritereve të qëllimit logjik në të cilin duhet përfunduar.

Edhe pse, siç thamë se, çdo veprim lind dy herë: *lindje logjike dhe lindje materiale*, mirëpo nuk është e domosdoshme që lindja e parë të jetë e dobishme. Nëse ne nuk planifikojmë për lindjen e mirëfilltë të aspekteve të jetës sonë planifikim të vetëdijshëm që ngrihet mbi njohjen e vetes sonë, bartjen e përgjegjësisë përballë kushteve dhe rrethanave që na rrethojnë, rreziqet që kërcënojnë të tashmen dhe të ardhmen tonë si dhe sfidat që pengojnë realizimin e nevojave tona, atëherë do t’u japim mundësinë të tjerëve të realizojnë planifikimin e lindjes së parë sipas interesave dhe qëllimeve të tyre. Me këtë do t’u japim shanse të mëdha për të formuar dhe deformuar ekzistimin tonë. Në këtë rast, veprimet tona do të jenë vetëm reaksion i pakontrolluar dhe normat e jetës sonë do të jenë vetëm zbatim i projekteve që kanë përgatitur të tjerët. Në këtë rast do të jemi në situatë t’i nënshtrohemi katastrofave natyrore dhe politike, duke u mbështetur tek te tjerët për të trajtuar pasojat e këtyre katastrofave, duke përfshirë këtu edhe humbjen e identitetit, përkatësisë dhe zhvlerësimin e vetes.³⁶

Ky është shkaku që bën shtetet okupatore të kujdesen fort për të pasur në kontroll sistemet edukativo-arsimore, këshilluese, informative dhe administrative në vendet e pushtuara. E gjithë kjo bëhet me qëllim që lindjet e para logjike në sferën politike, shoqërore, ekonomike dhe ushtarake të jenë në pajtueshmëri me **qëllimet e pushtuesve**, që u plotësojnë atyre ambiciet dhe u forcojnë pushtimin. Grafiku në vijim e sqaron këtë renditje:


³⁶ Stephen R. Covey, op.cit, p. 100.



Praktika e dytë

Zgjedhja e mirë e lidershipit të suksesshëm dhe organizimi i shëndoshë. Arritja e suksesit në zgjedhjen e këtyre dy elementeve është çështje shumë e rëndësishme ngase materializon parimin: *lindja dy herë*. Kështu që zgjedhja e lidershipit është lindja e parë e punës dhe organizimi i shëndoshë është lindja e dytë. Gjetja e **lidershipit efikas**, krahas **organizimit efikas**, shpie **në efikasitet në mendime dhe arritje**, sepse efikasiteti nuk mbështetet vetëm në sasinë e përpjekjeve dhe energjisë që harxhohet, por mbështetet edhe në harxhimin e përpjekjeve në fushat e përshtatshme. Për këtë duhet **patjetër të bëhet dallimi i hollësishëm mes udhëheqësisë dhe organizimit**. *Udhëheqësi do të thotë veprimi i çështjeve të sakta, ndërsa organizimi nënkupton: Zbatimin e çështjeve të sakta me mënyra dhe metoda të sakta*. Udhëheqësi nënkupton **përcaktimin e murit të saktë**

se ku duhet të vendosen shkallët, ndërsa organizim do të thotë **ngritja e përpiktë në këto shkallë**.³⁷ Grafiku në vijim na mundëson ma me kuptue këtë realitet si duhet:



³⁷ Ibid, f. 101.

Praktika e tretë:

Kristalizimi i një programi të qartë për punë. Për përpilimin e këtij programi duhet mbështetur në tri çështje:

E para: *rishikimi i programeve aktuale*, të cilat kanë arritur te ne nga gjeneratat e mëhershme për të kuptuar se cilat prej tyre e kanë humbur efikasitetin ose u ka kaluar koha.



E dyta: *mbështetja në vlerat dhe parimet që besojmë*,

E treta: *të fillojmë nga qendra e “rrethit të ndikimit”*, të cilën e sqaruam më parë, dhe angazhimi për ta zgjeruar vazhdimisht. Duhet përkujtuar se programi i punës ndikohet me boshtin e përkushtimit ndaj atij që e ka venduar. ***Boshtet e përkushtimit janë të shumta. Ka:***

- a- bosht të përkushtimit ndaj parimeve,*
- b- bosht të përkushtimit ndaj familjes,*
- c- ndaj vendit,*
- d- ndaj punës,*
- e- ndaj pasurisë,*
- f- ndaj raporteve të miqësisë dhe armiqësisë,*
- g- ndaj epshit,*
- h- ndaj pasurisë,*
- i- postit dhe grave,*
- j- ndaj fraksionit fetar,*
- k- ndaj egos etj.*


Nuk është kusht që të shterren të gjitha këto boshte në interes të njërës prej tyre, por ajo që kërkohet është përplotësimi i tyre në mënyrë të shëndoshë dhe të drejtë, në atë mënyrë që boshti i përkushtimit ndaj parimeve të jetë në qendër të **“rrethit të ndikimit”** dhe më pas boshtet e tjera të sillen përreth tij. Ky është boshti i edukatës islame sipas parimit të **“mesatares”** në sjellje dhe përgatitja e njeriut musliman që me të mirat që ia ka dhënë Allahu të synojë në jetën e ahiretit pa harruar pjesën e tij nga të mirat e dynjasë dhe kënaqësive të saj në mënyrë legjitime. Grafikat më poshtë i përmbledhin në këto pika:

Praktika e tretë: duhet mbështetur në tri çështje:



Forma e tretë: përpikëria në radhitjen e prioriteteve në programin e punës.

Kjo traditë kompletohet me dy traditat e para ngase këto të dyja koncentrohen në lindjen logjike të punës, ndërsa tradita e tretë koncentrohet në lindjen materiale të saj. Thënë ndryshe, dy traditat e para përbëjnë përmbajtjen teorike të punës, ndërsa e treta përmbajtjen praktike. Përderisa të arrihet pajtueshmëria e praktikimit mes tri traditave, nuk do të mund që puna të jetë efikase. Kjo nënkupton obligueshmërinë e bashkimit mes kulturës mendore dhe shkathtësive praktike, në veçanti në mesin e atyre që marrin vendin e udhëheqësisë dhe organizimit. *Në të njëjtën kohë mund të kuptohet se sa i rrezikshëm është dorëzimi i punës, udhëheqësisë dhe organizimit, personave që nuk kanë aftësi të thella në parime, besim dhe shkencat teorike që ndërlidhen me çështjen.* Pjekuria në këto tri tradita (çështje) dhe arritja në pozitën e epërsisë ndaj të tjerëve sjell rezultatin: **“Suksesi në arritjet individuale dhe realizimi i fitoreve personale.”**, siç shihet në grafikun vijues:



PJESA E TRETË

Shkalla e mbështetjes reciproke me të tjerët dhe format ideologjike dhe psikologjike

(Pjekuria)

Shkalla e reciprocitetit të mbështetjes me të tjerët përfaqëson shkallën më të lartë të zhvillimit dhe pjekurisë së personalitetit. Elementet psikologjike shoqëruese të kësaj shkalle janë elemente të lidërshiptit efikas dhe të suksesshëm që sillen rreth një pikëpamje të caktuar të efikasitetit prodhues, e bazuar në sintagmën: **“Ne jemi përgjegjës.”** Nga kjo nënkuptohet se pronari i kësaj shkalle nuk mendon në vete e as nuk vepron në vete, por mendon me të tjerët dhe vepron për të realizuar sukseset më të mira dhe më të mëdha. Pikëpamjet e tij ngrihen mbi çështjet vijuese:


- *Ne mundemi të bëjmë kështu;*
- *Ne mundemi të bashkëpunojmë për të arritur kështu;*
- *Ne mundemi të grumbullojmë mendjet, shqisat, energjitë dhe burimet tona për të arritur çështjet më të mëdha.*

Shkalla e mbështetjes reciproke me tjerët është më e mirë se shkalla e “pavarësisë nga të tjerët”, sepse e dyta nuk përfaqëson pjekurinë e mjaftueshme të personalitetit njerëzor, si dhe personat e pavarur mund të jenë prodhues të shkëlqyeshëm, por ata nuk janë të përshtatshëm për të udhëhequr, e as për punë me grup, familje, institucion, parti apo shtet, ngase ata sillen rreth vetvetes. Shembulli i tyre është si shembulli i atij që luan tenis me një ekip futbollit. Këtu shihet qartë urtësia e kryerjes së ibadeteve islame në formë kolektive, e jo individualisht. Në veçanti këtu përfshihet leximi i Fatihasë në formë të shumësit: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë, na udhëzo në rrugën e drejtë...”** e jo në njëjës: Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj, më udhëzo në rrugën e drejtë.

Njeriu që në mënyrë reciproke mbështetet me të tjerët në aspektin **material** është njeri që në rend të parë mbështetet në aftësitë dhe shkathtësitë e tij fizike, por ai është i bindur se bashkëpunimi me të tjerët i sjell arritje më të mëdha se sa nëse punon vetë. Njeriu që arrin këtë shkallë **emocionalisht** është njeriu që e di vlerën e vetes së tij, por ai është i bindur se ka nevojë për dashurinë e të tjerëve dhe dashurinë reciproke. Njeriu që arrin këtë shkallë **intelektualisht** është njeri që ka fuqi për të menduar në mënyrë të pavarur, por ai është i bindur për rëndësinë e grumbullimit të aftësive intelektuale me të tjerët. Njeriu që arrin këtë shkallë **socialisht** është njeri

që di të zgjedhë atë që dëshiron, por beson në rëndësinë e vullnetit dhe dëshirave të të tjerëve.

Këtë shkallë nuk mund ta arrijë pos atij që më parë ka arritur shkallën e **“pavarësisë nga të tjerët”**, sepse ata nuk posedojnë veten e tyre e as nuk kanë personalitet të fuqishëm për të kryer këtë lloj veprimi. Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:



Këtu shihet qartë urtësia e kryerjes së ibadeteve islame në formë kolektive, e jo individualisht ..***“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë, na udhëzo në rrugën e drejtë...”*** e jo në njëjës: Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj, më udhëzo në rrugën e drejtë.

Shkallën e mbështetjes reciproke me të tjerët e shoqërojnë disa forma psikologjike dhe ideologjike pozitive, të cilat çojnë në pasurimin e performancave dhe arritjeve. Këto elemente janë:

Forma e parë: Ideja “fitoj unë dhe fitojnë edhe të tjerët.”

Ky element është orientim psikologjik-logjik që ka për qëllim dobinë reciproke në gjitha aktivitetet njerëzore. Si rezultat i këtij orientimi është detyrimi i të gjithëve për bashkëpunim për interes të përbashkët, pa ndierë nevojën për garim ose dëshirë për t’ia tejkaluar të tjerëve. Të cilësuarit me këtë lloj edukate të të menduarit, edukata islame e konsideron pjesë të besimit të singertë. Në lidhje me këtë orientim kemi një numër të madh të haditheve pejgamberike dhe praktikave në kohën e Pejgamberit s.a.v.s.. Prej tyre veçojmë thënien e Muhamedit s.a.v.s.: “*Nuk mund të ketë besim të plotë ndonjëri prej jush derisa të dëshirojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për veten.*”³⁸

Në realitet elementi i idesë “fitoj unë dhe fitojnë edhe të tjerët” është element i përshtatshëm për lidhshirin e suksesshëm, ngase i shfrytëzon të gjitha **potencialet njerëzore siç janë:**

- njohja e vetes;
- vullneti i pavarur;
- botëkuptimi për të ardhmen;
- fuqia për mësim reciprok;
- për ndikim reciprok dhe dobi reciproke.


Njeriu ka nevojë për një sasi të madhe të trimërisë dhe vetëbesimit për të qenë i përpiktë në këtë lloj të të menduarit, në veçanti nëse është duke bashkëpunuar me njerëz që veprojnë sipas sintagmës: “*Fitoj unë dhe humbin të tjerët.*”

Ideja “fitoj unë dhe fitojnë edhe të tjerët” është element bazë në efikasitetin e njeriut, ngase përfshin pesë dimensionë të ndërhyra me njëra-tjetrën në aktivitetet e jetës së suksesshme. Këto dimensionë fillojnë me “*personalitetin e pjekur*”, më pas lëvizin në drejtim të “*raportëve ndërnjerëzore*”, vazhdojnë në “*aftësinë për kryerjen e kontratave*”, realizimin e “*arritjeve dhe sukseseve*” me kusht të plotësisht të “*ambientit dhe sistemit të përshtatshëm*” dhe “*përshtatshmërisë së metodave dhe mjeteve të bashkëpunimit*” me qëllimet e vendosura më parë për idenë.

³⁸ Transmeton Buhariu në Sahih, libri “El iman”. Ngjashëm me të transmeton Tirmidhiu në librin “El kijameh”. Po ashtu, e transmetojnë edhe Nisaiu, Ibn Maxheh, Darimiu dhe Ahmedi.

- **Sa i përket dimensionit të parë “personaliteti i pjekur”** është bazament mbi të cilin ngrihet *ideja “fitoj unë dhe fitojnë edhe të tjerët”*. Ky personalitet ka tri veçori:
 - **E para: “El istikame”** që nënkupton jetën e njeriut në përputhshmëri me vlerat që i beson në të gjitha qëndrimet dhe raportet e tij ditore.


E dyta: Pjekuria, e cila reflektohet në realitet duke ruajtur baraspeshën mes trimërisë dhe konsideratës ndaj të tjerëve. Grafiku në vijim i përmbledhë këto pika:




Trimëria realizohet kur njeriu shpreh qartë mendimet dhe ndjenjat e tij, ndërsa konsiderata realizohet kur bën përpjekje për të kuptuar të tjerët dhe duke respektuar ndjenjat e tyre. *Baraspesha mes trimërisë dhe konsideratës shpie në baraspeshën e personalitetit*. Nëse njeriu posedon trimëri, por i mungon konsiderata ndaj të tjerëve, atëherë do të mendojë sipas formës: *fitoj unë dhe humbin të tjerët*. Këtë mungesë të konsideratës ndaj të tjerëve do ta plotësojë me fuqinë e pozitës së tij, pushtetit, fanatizmit, detyrës etj. Po nëse është prej atyre që kanë konsideratë ndaj të tjerëve, por trimëri të ulët, atëherë do të mendojë sipas formës: *“humb unë dhe fitojnë të tjerët”*, që do t'i sjellë humbje atij dhe atyre për të cilët është përgjegjës.

- **Veçoria e tretë e personalitetit të pjekur është ajo që quhet “mentalitet i bollshëm”**, që nënkupton mentalitet që shohin se në jetë ka dhunti të bollshme dhe të mjaftueshme për secilin njeri. *Njerëzit e një mentaliteti të tillë sillen me një ndjeshmëri të thellë të besimit dhe të qetësisë. Ata mendojnë se gjithë njerëzit kanë mundësi të marrin pjesë në pozita, dobi, planifikim, vendimmarrje dhe se shanset janë të barabarta për të gjithë për punë, arritje dhe sukses*. Shih grafikun në vijim:

Shkallën e mbështetjes reciproke me të tjerët e shoqërojnë disa forma psikologjike dhe ideologjike pozitive:



Dimensioni i dytë i idesë “fitoj unë dhe fitojnë të tjerët” është *“raportet ndërnjerëzore”* të ngritura mbi besimin reciprok. Besimi është kapitali që shpie në vazhdimin e këtyre raporteve. Pa këtë besim, do të dominojnë komplimentet artificiale, do të zvogëlohet besueshmëria, do të humbasë mirëkuptimi dhe do të ndërpritet arritja dhe sukcesi. Shih grafikun që vijon:



Dimensioni i tretë i idesë “fitoj unë dhe fitojnë të tjerët” është *“aftësia për kryerjen e kontratave dhe realizimin e arritjeve dhe sukseve”*. Edhe kjo është fryt i raporteve njerëzore fisnike. Në këtë dimension duhet të kihet parasysh pesë çështje:


- realizimi i rezultateve të dëshiruara;
- plotësimi i këshillave, të cilat orientojnë në realizimin e rezultateve;
- plotësimin e resurseve të nevojshme njerëzore dhe materiale për arritje dhe sukses, kristalizimi i kritereve të arritjeve;
- vlerësimi i kohës dhe në fund;
- vlerësimi përfundimtar i arritjeve.



Dimensioni i katërt i idesë "fitoj unë dhe fitojnë të tjerët" është përshtatshmëria e ambientit dhe sistemit me idenë dhe respektimi i rezultateve dhe fryteve.



Dimensioni i pestë i idesë “fitoj unë dhe fitojnë të tjerët” është përshtatshmëria e metodave dhe mjeteve me qëllimet, ngase nuk mundet realizimi i idesë “*fitoj unë dhe fitojnë të tjerët*” me metoda dhe mjete të idesë “*fitoj unë dhe humbin të tjerët*”.³⁹analizo këtë grafikë:



Është për të ardhur keq se shumica e njerëzve që dalin nga institucionet edukativo-arsimore në shtetet arabe dhe islame nuk mendojnë sipas elementit “**fitoj unë dhe fitojnë të tjerët**”, por ata shpërndahen në ndonjërin prej pesë elementeve të mëposhtme:


- *fitoj unë dhe humbin të tjerët*;
- *humb unë dhe fitojnë të tjerët*;
- *humb unë dhe humbin të tjerët*;
- *fitoj unë dhe nuk më interesojnë të tjerët*;
- *fitojnë të tjerët me kusht që unë të fitoj ose nuk do të fitojë askush*.

Ngulitjen e këtyre pesë elementeve të të menduarit e ndihmon edhe ajo se ambienti i përgjithshëm dhe kultura dominuese e mbështesin në mënyrë praktike.

³⁹ Stephen R. Covey, op.cit. pp. 220-234.

MOS HARRO!

Është për të ardhur keq se shumica e njerëzve që dalin nga institucionet edukativo-arsimore në shtetet arabe dhe islame nuk mendojnë sipas elementit “**fitoj unë dhe fitojnë të tjerët**”, por ata shpërndahen në ndonjërin prej pesë elementeve të mëposhtme:




Sa i përket detajeve të këtyre pesë elementeve, themi:

1. *Forma e idesë "fitoj unë dhe humbin të tjerët".*

Ky mendim është orientim psikologjik që për pikënisje ka urrejtjen dhe garimin dhe shikon jetën se një mejdan për garim ku nuk mund të fitohet

përpos duke humbur tjetri. Nëse merr pushtetin njeri me mendim të tillë, atëherë ai do të jetë diktator që nuk bashkëpunon me askënd e as nuk është i sigurtë me të askush. Fillimi i këtij lloj të menduari është në familjen ku edukata ngrihet mbi bazën e krahasimit të fëmijës me vëllezërit dhe bashkëmoshatarët e tij, ku në bazë të këtij krahasimi ofrohet dashuria, shpërblimi, llojet e lavdërimit ose nënçmimit, pranimi ose refuzimi etj. Këtë element të të menduarit e mbështet edhe grupi i shokëve që bëjnë diskriminime mes anëtarëve të tij. Po ashtu, këtë lloj të mendimit e mbështet edhe shkolla kur provimet kryhen në bazë të garimit individual dhe duke përdorur metoda arsimore që nuk ngrihen mbi parimin e bashkëpunimit dhe punës individuale. Më pas këtë dukuri e shohim të mbështetur edhe në fanatizmin fisnor, partiak dhe fraksional duke përhapur praktikën e tij në fushat e sektorit publik, përfshirë edhe zgjedhjet lokale dhe parlamentare, në fushën e tregtisë dhe të garimit në të, lavdërimit me post dhe pozitë shoqërore, si dhe aftësitë shkencore dhe profesionale. Si rezultat i gjithë kësaj është vrasja e efikasitetit dhe mosarritja e suksesit. Niveli i këtij lloji të të menduarit ngrihet në jetën politike aktuale në vendet arabe dhe islame dhe bëhet shkak për humbjen e kapaciteteve, nxitjen e përçarjeve dhe kompleteve që shpien në shkatërrim dhe falimentimin e projekteve. Kjo formë mund të vërehet më qartë në grafikun që vijon:



Është e vërtetë se në jetë ka disa fusha që duhet patjetër të ketë garime, mirëpo shumica e sferave të jetës nuk kanë nevojë për garime që përçajnë, shkatërrojnë bashkëpunimin dhe shkaktojnë dobësinë dhe humbjen.

2. *Forma e idesë “humb unë dhe fitojnë të tjerët”.*

Kjo formë e të menduarit është më e keqe se ai paraprak, ngase personat e tillë nuk kanë vetëbesim në veten e tyre, janë të pandërgjegjshëm dhe presin humbje apo dështim në çdo punë. Për këtë jetojnë të viktimizuar nga luhatjet e tyre. Ata shumë lehtë gëzohen dhe dëshprohen, shpresojnë dhe zhgënjehen. Ata gjithnjë kërkojnë të jenë të pëlqyer dhe të pranuar te njerëzit. Shumë lehtë mahniten nga fuqia e të tjerëve dhe heqin dorë nga ajo që kanë filluar.

Personat që përqafojnë këtë mendim janë të dashur nga personat e mendimit “*fitoj unë dhe humbin të tjerët*”, ngase ata i gjejnë viktimë me çmim të ulët dhe nuk i rezistojnë armiqësisë së tyre.

Problemi serioz te personat e mendimit “*humb unë dhe fitojnë të tjerët*” është se ata kohë pas kohe janë të luhatur në qëndrimet e tyre, gjë që bën që edhe raportet me të tjerët të jenë në luhatje të vazhdueshme. Ata në shumë raste fshehin ndjenjat e tyre dhe më pas, papritmas, shpërthejnë dhe humbin baraspeshën. Ata goditen nga luhatja në qëndrime, sëmundjet nervore dhe depresioni.

Baza e këtij lloj të të menduarit është në fëmijëri, ku fëmija rritet nën edukimin e prindërve që sillen ndaj tij me arrogancë të vazhdueshme dhe duke i zhvlerësuar veprat e tij. Ky mendim shtohet edhe nga shokët përmes talljeve dhe ofendimeve reciproke. Ky mendim edhe më shumë shtohet në shkollë përmes dënimeve të rënda dhe ofendimeve në raste dështimi në provime ose arritjeve të sukseseve të ulëta. Rrethi në të cilin jeton -në disa raste- rrit edhe më shumë këtë mendim përmes formave të ndryshme të talljeve, etiketimeve me ofiqe të ndryshme dhe poshtërimeve. Kjo formë mund të vërehet më qartë në grafikun që vijon:

Forma e idesë "humb unë dhe fitojnë të tjerët".

Kjo formë e të menduarit është më e keqe se ai paraprak

personat e tillë nuk kanë vetëbesim në veten e tyre

janë të pandërgjegjshëm dhe presin humbje apo dështim në çdo punë

Ata shumë lehtë gëzohen dhe dëshprohen


shpresojnë dhe zhgënjehen

Problemi serioz te personat e mendimit "humb unë dhe fitojnë të tjerët" është se ata kohë pas kohe janë të luhatur në qëndrimet e tyre

Ata në shumë raste fshehin ndjenjat e tyre dhe më pas, papritmas, shpërthejnë dhe humbin baraspeshën

Ata goditen nga luhatja në qëndrime, sëmundjet nervore dhe depresioni.

Baza e këtij lloji të të menduarit është në fëmijëri:



më shumë shtohet në shkollë përmes dënimeve të rënda dhe ofendimeve në raste dështimi në provime - është dominues në mesin e udhëheqësve të shteteve të **Botës së Tretë**


Ky mendim është dominues në mesin e udhëheqësve të shteteve të **Botës së Tretë**, të cilët i nënshtrohen tiranisë dhe pajtohen të jenë pasues në pozita të ndryshme përgjegjëse.

3.

Forma e idesë “humb unë dhe humbin të tjerët”.

Ky lloj i të menduarit shfaqet kur bashkëveprojnë dy persona të idesë “*fitoj unë dhe humbin të tjerët*”. Ky bashkëpunim mes tyre ngrihet mbi bazën e armiqësisë dhe të egoizmit si dhe dëshirës së secilit prej tyre në shkatërrimin e tjetrit. Këto orientime negative ngrihen për t’u grumbulluar në një mendim të vetëm e që është urrejtja dhe dëshira për hakmarrje, gjë që shpie në dëmtim ose krim që shpie në humbjen e të dy palëve.

Pronarët e këtij mendimi janë të ndikuar nga ndjenjat e hakmarrjes dhe e vetmja gjë që iu intereson është hulumtimi rreth metodave dhe mjeteve të ndryshme që shkatërrojnë armikun e tyre përballë, po edhe nëse kjo gjë shkakton shkatërrimin e vetes së tyre. Ky lloj i mendimit është filozofia e konflikteve partiake, grushtshteteve ushtarake dhe sistemet politike që i kanë sjellë këto konflikte, sisteme të cilat u kanë sjellë katastrofa **shoqërive arabe dhe islame** bashkëkohore, duke u humbur pasurinë, duke u shkatërruar energjinë dhe duke shkaktuar largimin e njerëzve në vende të ndryshme të botës. Grafiku në vijim e sqaron këtë formë:



...është **filozofia e konflikteve partiake, grushtshteteve ushtarake dhe sistemet politike që i kanë sjellë këto konflikte, sisteme të cilat u kanë sjellë katastrofa shoqërive arabe dhe islame bashkëkohore**, duke u humbur pasurinë, duke u shkatërruar energjinë dhe duke shkaktuar largimin e njerëzve në vende të ndryshme të botës.

4.

Forma e idesë “fïtoj unë dhe nuk më interesojnë të tjerët”

Personat që mendojnë kështu, dëshirojnë sukses për veten e tyre pa u interesuar për fitimin apo humbjen e të tjerëve. Ky mendim është dominues në mesin e udhëheqësve administrativ dhe personave me poste në detyra të ndryshme në **vendet arabe dhe islame**. Ky mendim është dominues edhe te masa e thjeshtë, të cilët mendojnë për të siguruar veten e tyre, duke i lënë të tjerët të mendojnë vet në sigurimin e jetës së tyre. Këtë mënyrë të mendimit e mbështesin edhe shumë proverba popullore të përcjella nga Nasradin Hoxha dhe të tjerë, ta rikujtojmë formën e kësaj ideje si vijon:

Forma e idesë “fïtoj unë dhe nuk më interesojnë të tjerët”

1-dëshirojnë sukses për veten e tyre pa u interesuar për fitimin apo humbjen e të tjerëve


2-Ky mendim është dominues në mesin e udhëheqësve administrativ dhe personave me poste në **vendet arabe dhe islame**.

3-Ky mendim është dominues edhe te masa e thjeshtë, të cilët mendojnë për të siguruar veten e tyre, duke i lënë të tjerët të mendojnë vet në sigurimin e jetës së tyre

5.

Forma e idesë “fitoj unë dhe fitojnë të tjerët ose nuk fiton askush”.

Personat që mendojnë kështu kushtëzojnë edhe fitimin e të tjerëve krahas fitimit të tyre. Nëse nuk sigurojnë për veten e tyre fitore, e ndërpresin punën dhe flijojnë projektin. **Ky mendim është dominues në shoqëritë arabe dhe islame në mesin e biznesmenëve dhe të rinjve.** Rreziku i këtij lloji të mendimit fshihet në atë se në rast se marrin në dorë udhëheqësi, shfrytëzojnë pozicionin e tyre dhe çdo gjë e nënshtrojnë në shërbim të interesave të tyre.



Përhapja e këtyre pesë formave të të menduarit, të cilat i potencuam më lart, **në shoqëritë arabe dhe islame** bartin me vete rreziqe që vështirë se mund të vlerësohen, ngase shkaktojnë në përhapjen e asaj që e quan Covey⁴⁰ **“mentalitet i thatë”**, e cila jetën e sheh si një copë buke, ku nëse dikush merr një kafshatë, do të shkaktojë mangësi në pjesën tjetër të pronarit të saj. Personat e këtij mendimi suksesin e të tjerëve e llogarisin humbje të tyre edhe nëse të suksesshmit janë familjarët ose shokët e tyre të afërt. Ata stabilitetin dhe sigurinë e tyre e shohin në shkatërrimin e stabilitetit dhe sigurisë së të tjerëve. Ata janë të paaftë për të bashkëpunuar me njerëz që kanë aftësi për arritje. Për këtë, nëse janë në pozita udhëheqëse, afër vetes ofrojnë të dobët dhe të paaftë që i nënshtrohen atij, nuk rrezikojnë pozitën e tyre dhe gjithnjë u thonë **“po”**. Ata janë të shqetësuar dhe gjithnjë merren me krahasimin e qendrave dhe pronave me ato të tjerëve, bëjnë përpjekje marramendëse për zbukurimin e çështjeve që të shtojnë ndjenjën për vlerën e tyre. Ky mentalitet udhëheq raportet e shteteve, organizatave, institucioneve dhe individëve të **Botës së Tretë**. Për këtë, është shumë e vështirë që personat e **“mentalitetit të thatë”** të bashkëpunojnë me të tjerët dhe gjithnjë dështojnë në organizimin e energjisë së të punësuarve që janë nën udhëheqjen e tyre.

Kur’ani Famëlartë “mentalitetin e thatë” e quan **“Esh shuhh-koprraci”** kur thotë:

“وَمَنْ يُوقَ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ”

“E kush i ruhet lakmisë së vetvetës, të tillët janë të shpëtuarit.”⁴¹

⁴⁰ Covey është drejtor i qendrës Covey për zhvillimin e resurseve njerëzore në SHBA.

⁴¹ Et Tegabun: 16.

Forma e idesë “fitoj unë dhe fitojnë të tjerët ose nuk fiton askush”.



Ky mendim është dominues në shoqëritë arabe dhe islame në mesin e biznesmenëve dhe të rinjve.



Ky mendim është “**mentalitet i thatë**”, e cila jetën e shih si një copë buke, ku nëse dikush merr një kafshatë, do të shkaktojë mangësi në pjesën tjetër të pronarit të saj.

Kur’ani Famëllartë “*mentalitetin e thatë*” e quan “*Esh shuhh-koprraci*” kur thotë:

“وَمَنْ يُوقَ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ”

Duke analizuar ajetet dhe hadithet që trajtojnë problemin e “Esh shuh-koprraci” shihen qartë çështjet vijuese:

- a. *Koprraci ndaj të tjerëve në çështjet e jetës duke i ngushtuar mundësitë për përfitime, siç ndodh me qeveritë që përkufizojnë lirinë e veprimit dhe ngarkojnë popullatën me tatime të ndryshme. Ngjashëm me të është edhe shfrytëzimi i biznesmenëve në momentet e vështira, krizat, luftërat etj. për monopolizim dhe rritje të çmimeve.*
- b. *Koprraci në kryerjen e obligimeve dhe rritjen e papunësisë.*
- c. *Koprraci në solidaritetin social, ndërprerjen e lidhjeve dhe mëshirës si dhe përhapjen e egoizmit, krahas harxhimeve të tepërta në ahengje dhe dëfrime.*
- d. *Koprraci në pamjen shoqërore të adhurimit dhe kufizimi i fetarizmit vetëm në ibadetet fetare, gjithashtu koncentrimi në pamjen e jashtme të ibadeteve pa marrë në konsideratë kuptimin dhe esencën e tyre dhe marrja me “fjalë dhe formalitete” pa “përpjekje dhe veprime”.*
- e. *Koprraci në drejtësi dhe përhapja e mashtrimit në shitblerje. Siç potencohet në ajetin kur'anor*

(وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ الَّذِينَ إِذَا اكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وُزَنُوا لَهُمْ يُخْسِرُونَ)


“Të mjerët ata që mangu masin e peshojnë. Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë. E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, vënë mangut.”⁴² Fjala “tetfif” përfshin të gjitha sferat e jetës: 1- Në punë nënkupton lodhjen e punëtorëve nga ana e punëdhënësit, duke i ngarkuar me punë të rënda në kohë kur u japin atyre paga më të vogla se të tjerëve. 2- Në tregti “tetfif” nënkupton marrjen e plotë të çmimit gjatë blerjes dhe mangësi në matje gjatë shitjes.

- f. *Koprraci në flijim me shpirt dhe pasuri si dhe paaftësi para rreziqeve të jashtme, në kohë kur shprehet shumë i ashpër para vëllezërve dhe popullatës së brendshme.*

Muhamedi s.a.v.s. ka sqaruar rreziqet e koprracisë, duke thënë: **“Kini kujdes nga koprracia, ngase popujt e mëparshëm janë shkatërruar nga koprracia, i ka urdhëruar të këpusin lidhjet familjare dhe e kanë bërë atë, i ka urdhëruar të jenë dorështrydhur dhe e kanë bërë atë dhe i ka urdhëruar të bëjnë vepra të këqia dhe i kanë bërë ato.”**⁴³ Grafiku në vijim i përmbledh këto pika:

⁴² Mutaaffifin: 1-3.

⁴³ Muhamed Halil El Hatib, “It’haful enam bihutabi resulil enam”, f. 115, citua nga El Hakim. Ngjashëm transmetohet edhe në Suneni Ebu Davud dhe El Mundhirij në “Et terhibu vet Tergibu”, vëll. III, f. 158. Për të mësuar më shumë rreth **“terbijetil islamijeti”** të autorit Maxhid Arsan el Kilani.




Forma e dytë e shkallës së mbështetjes reciproke me të tjerët është “*kuptoi të tjerët më pas lëri të të kuptojnë*”. Zbatimi praktik i këtij elementi është shkathtësia e “*komunikimit dhe dialogut pozitiv*”. Është kështu sepse komunikimi është shkathtësia më e rëndësishme në jetën tonë. Nëpërmjet komunikimit kalojmë pjesën më të madhe të jetës sonë dhe se **të kuptosh njerëzit dhe t’i dëgjosh ata me të mirë është prej elementeve më të rëndësishme të bashkëpunimit të suksesshëm me ta**. Me shprehjen “*t’i dëgjosh ata me të mirë*” nuk kemi për qëllim vetëm dëgjim të thjeshtë, por me këtë kemi për qëllim koncentrim gjatë dëgjimit, kujdes dhe kuptimin e gjithë asaj që dëshirojnë të përcjellin deri te ne, të kuptosh motivet që i vënë në lëvizje dhe qëllimet që dëshirojnë të realizojnë dhe në fund të kuptosh anët e sakta dhe gabimet në to. Grafiku në vijim e qartëson këtë qështje:



Nëse të gjitha këto i kemi të qarta, atëherë kalojmë në hapin e dytë e që është përpjekja për t'i bërë të kuptojnë qëllimet tona. Duhet të kuptojmë se:

- 1- 10% e komunikimit tonë kuptohet në të folur;
- 2- 30% në tonin e zërit dhe sinqeritetin e të folurit;
- 3- 60% në gjestikulationet tona, siç janë livëzjet, mimikat dhe format e tjera të shprehjes me anë të shenjave.⁴⁴, siç shihet në grafikun vijues:



FORMA E DYTE

Shkathhtësinë e të dëgjuarit, Kur'ani e paraqet si një nga shkaqet e të kuptuarit, i cili shpie drejt besimit dhe shpëtimit. Kjo shihet në ajetet vijuese:

“إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَسْمَعُونَ”

“Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon.”⁴⁵

“الَّذِينَ يَسْتَمِعُونَ الْقَوْلَ فَيَتَّبِعُونَ أَحْسَنَهُ أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَاهُمُ اللَّهُ وَأُولَئِكَ هُمْ أُولُو الْأَلْبَابِ”

⁴⁴ Stephen R. Covey, op.cit, pp. 237-255.

⁴⁵ Err Rrum: 23.

“Të cilët dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.”⁴⁶

”وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ”

“Kur lexohet Kur’ani, ju dëgjoni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë.”⁴⁷

Në të kundërtën, humbja e shkathtësisë së të dëgjuarit është shkak prej shkaqeve të mosbesimit dhe të humbjes. Kjo shihet qartë në ajetet vijuese:

”فَاعْرِضْ أَكْثَرَهُمْ فَهُمْ لَا يَسْمَعُونَ”

“Shumica e tyre ia kthyen shpinën, andaj ata nuk e dëgjojnë.”⁴⁸

”أَمْ تَحْسَبُ أَنَّ أَكْثَرَهُمْ يَسْمَعُونَ أَوْ يَعْقِلُونَ”

“A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë ose kuptojnë.”⁴⁹

”وَمِنْهُمْ مَّنْ يَسْتَمِعُ إِلَيْكَ حَتَّى إِذَا خَرَجُوا مِنْ عِنْدِكَ قَالُوا لِلَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ مَاذَا قَالَ آنِذَا”

“Prej tyre ka asish që vijnë të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre që kanë dije u thonë: Çka tha ai më parë.”⁵⁰

”وَعَرَضْنَا جَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ لِلْكَافِرِينَ عَرْضًا الَّذِينَ كَانَتْ أَعْيُنُهُمْ فِي غِطَاءٍ عَنْ ذِكْرِي وَكَانُوا لَا يَسْتَطِيعُونَ سَمْعًا”

“Atë ditë ua prezentojmë Xhehenemin jobesimtarëve me një prezetim të hapët. Atyre që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin.”⁵¹

Allahu e ka ndaluar të Dërguarin e Tij që ta teprojë në kërkimin e ajeteve dhe të mrekullive që do të bindin jobesimtarët, të cilët nuk dëgjojnë në atë mënyrë që shpie në udhëzim të drejtë, duke e informuar se ata janë në mesin e të vdekurve që nuk dëgjojnë përpos në Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë. Allahu thotë:

”وَإِنْ كَانَ كَبُرَ عَلَيْكَ إِعْرَاضُهُمْ فَإِنْ اسْتَطَعْتَ أَنْ تَبْتَغِيَ نَفَقًا فِي الْأَرْضِ أَوْ سُلَّمًا فِي السَّمَاءِ فَتَأْتِيَهُمْ بِآيَةٍ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَمَعَهُمْ عَلَى الْهُدَىٰ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْجَاهِلِينَ إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ وَالْمَوْتَىٰ يَبْعَهُمُ اللَّهُ ثُمَّ إِلَيْهِ يُرْجَعُونَ”

⁴⁶ Ez Zumer: 18.

⁴⁷ El A'raf: 204.

⁴⁸ Fussilet: 4.

⁴⁹ El Furkan: 44.

⁵⁰ Muhammed: 16.


⁵¹ El Kehf: 100-101.

“Por, nëse refuzimi i tyre të është bërë brengë e madhe, ti kërkoje, nëse ke mundësi, ndonjë vrimë në tokë ose shkallë në qiell e t’u sjellësh atyre ndonjë argument. Të kishte dashur Allahu i kishte tubuar në rrugë të drejtë; po ti mos u bë nga të padijshmit. Vetëm ata që kanë dëgjim të shëndoshë i përgjigjen (ftesës). ***Të vdekurit*** (ata që nuk dëgjojnë dhe nuk besojnë) ***Allahu i ringjall, e pastaj tek Ai kthehen.***”⁵²

Njeriu që edukohet në institucionet edukative të Botës së Tretë, përfshirë edhe shtetet arabe dhe islame, **nuk dëgjon që të kuptojë, por dëgjon për t’u përgjigjur nga ajo që sillet në mendjen e tij.** Ai gjithnjë mendon se ajo që sillet në mendjen e tij është e vërteta, dhe se të tjerët nuk e dëgjojnë këtë të vërtetë dhe nuk e kërkojnë atë për këtë. Ai në veten e tij formon bindje paraprake që vijnë si rezultat i dëshirave të tij vetjake dhe përkatësisë së tij racore, ku më pas kalon kohën e tij duke dialoguar me të tjerët që t’i bindë të pranojnë të vërtetën që ai posedon. Aftësitë e tij intelektuale mbesin të paralizuara nga të kuptuarit dhe të angazhuara me rradhitjen e asaj se çka do të thotë. *Pikërisht për këtë, shumë shpejt polemika shndërrohet në hasmëri dhe konflikt, duke u ngritur zërat dhe duke u koncentruar tërësisht në pafajësimin e vetes dhe fajësimin e të tjerëve.* Polemizuesit këtë e shfaqin përmes lëvizjeve të vrazhda, shenjave dhe mimikave të rënda. Kur përhapet paaftësia nga shkathtësia e të dëgjuarit dhe bëhet pjesë e kulturës dominuese, atëherë ajo nxjerr diktator, i cili nuk dëgjon askënd përpos vetes së tij, drejtor burokrat, i cili imponon vendimet e tij, baba autoritar, i cili i imponon urdhërat e tij, mësues, i cili i imponon mendimet e tij dhe i ushtron nxënësit të jenë pasiv dhe të dëgjueshëm, dhe, krejt në fund, rezultati i gjithë kësaj është humbja e urave komunikuese, dështim i edukatës, sterilitet i shoqërive, dështim i takimeve dhe konferencave e më pas ndjenjat e trazuara dhe reaksionet revoltuese nuk shfaqen përpos në formë të intrigave, kompleteve dhe dëmtimeve reciproke.

Në të kundërtën, humbja e shkathtësisë së të dëgjuarit është shkak prej shkaqeve të mosbesimit dhe të humbjes. **Kjo shihet qartë në ajetet vijuese:**

⁵² El En’am: 35-36.



Forma e tretë e shkallës “mbështetje reciproke me të tjerët” është forma e “bashkëveprimit kolektiv”.

Kjo formë është esenca e parimeve të lidërshipt të suksesshëm, ngase motivon interesat, bashkon përpjekjet dhe shpërthen energjitë dhe aftësitë. Ky është pikësynimi përfundimtar nga zbatimi i pesë formave për të cilat folëm më parë. Bashkëveprimi i synuar nënkupton se përplotësimi i individëve dhe koordinimi i përpjekjeve tek secili është me efikasitet më të madh dhe dobi më të madhe se sa grupe njerëzish të pakoordinuar. Bashkëveprimi me këtë kuptim është ligj i jetës dhe i shoqërisë njerëzore. Këtë e qartëson grafiku vijues:

FORMA E TRETE



Ky sistem gjendet edhe në elementet përbërëse të hapësirës. Ai gjendet në:

- 1- Eko-sistem.
- 2- Ai gjendet në botën e kafshëve dhe të insekteve, siç janë bletët dhe milingonat, të cilat bashkëpunojnë për të siguruar ushqimin, banimin dhe sigurinë.
- 3- Ai gjendet në botën e bimëve ku rrënjët e afërta njëra me tjetrën bashkëveprojnë për të përmirësuar llojin e dheut dhe për të përforcuar procesin e zhvillimit.
- 4- Ai gjendet edhe në botën e gjësendeve të ngurta, siç janë shtyllat e ndërtesave dhe këmbët e tavolinave, të cilat bartin mbi vete gjëra të rënda më shumë se sa bartin sikur të ishin të vetmuara dhe të palidhura njëra me tjetrën. **Këto pika i përmbledhim në grafikun që vijon:**



Sa i përket njeriut, i cili posedon lirinë e të menduarit dhe lirinë e të zgjedhurit, mbetet përgjegjësi e institucioneve edukative, siç janë familja, shkolla, organet shtetërore dhe të sigurisë që të gjitha të bashkohen për të ruajtur humanitetin e njeriut, përgatitjen e tij dhe organizimin e jetës së tij që të përshtatet me këto ligje dhe t'i bëjnë me dije rreziqet e konfrontimit me to, si dhe pasojat e dështimit të veprave dhe të arritjeve.

Bazamenti mbi të cilin ngrihet forma e bashkëveprimit është të qenurit i vetëdijshëm për vlerën e divergjencave dhe të dallimeve intelektuale, psikike, emocionale dhe fizike ndërmjet individëve dhe shoqërive dhe se këto dallime e bëjnë njeriun të jetë më bashkëveprues se sa sikur të ishin të njëjtë. Kjo shihet qartë në dallimet fizike mes njerëzve, por është më i padukshëm në raportet shoqërore dhe dallimet intelektuale dhe emocionale. Për shembull, ne vërejmë se dallimet në formimin fizik mes mashkullit dhe femrës janë shkak për tërheqjen e secilit prej tyre kundrejt tjetrit dhe faktor për dashuri. Sikur të ishin të njëjtë në formim, do të irritoheshin mes vete dhe nuk do të ekzistonte kjo tërheqje, e as nuk do të formohej familje. Bazament në bashkëveprim, pra, është të kuptojmë vlerën dhe dobitë e mëdha që kanë dallimet mes individëve dhe shoqërive, mes kulturave dhe racave njerëzore, dhe se sistemet edukative duhen shfrytëzuar që këto dallime të zbukurojnë edhe më shumë jetën, për të shtuar afërsinë, dashurinë, komunikimin, besimin dhe bashkëpunimin reciprok në fusha të ndryshme të saj, përfshirë atë materiale, shoqërore, politike etj. Kjo çështje përfshihet në ajetin kur'anor:

“وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ إِلَّا مَن رَّجِمَ رَبُّكَ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ وَتَمَّتْ كَلِمَةُ رَبِّكَ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ”

“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime. Përveç atij që mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata. Fjala e Zotit tënd: “Gjithsesi do ta mbushë Xhehenemin me të gjithë xhinët dhe njerëzit”, ka marrë fund (është plotësuar).”⁵³

Duhet të jemi objektivë dhe **të themi se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përgjegjësit kanë kuptuar frytet pozitive të llojllojshmërisë dhe diversitetit mes banorëve të saj.** Ata kanë bërë plane për të pasuruar kulturën dhe jetën amerikane. Për këtë çështje kanë caktuar një ditë festive e njohur me emrin *“Dita kombëtare”* në të cilën çdo vit dalin grupet dhe etnitetet në çdo qytet për të prezantuar prodhimet,


⁵³ Hud: 118-119.

ushqimet, letërsinë dhe kulturën e veçantë të tyre. Në këtë ditë këmbëjnë vizitat, uratat dhe lavdëratat nga mëngjesi deri në mbrëmje.



Mirëpo, ata që nuk dijnë vlerën e këtyre dallimeve dhe diversiteteve mes njerëzve, i marrin si shkas për urrejtje dhe hasmëri, duke menduar se e vërteta është vetëm tek ata dhe se nderi dhe bukuria është e veçantë e tyre. Për këtë, ata mendojnë se janë meritore për të qenë zotërinj, ndërsa të tjerët pasues të tyre, mendojnë se kanë të drejtë që të tjerëve t’u caktojnë udhëheqës që merren me çështjet e tyre, i orientojnë veprimet e tyre, përcaktojnë rrogat pa u konsultuar fare me ta. Kjo çështje ndez xixën e konfliktit në vend të bashkëveprimit dhe urrejtjes në vend të dashurisë. *Kjo formë e të menduarit është ajo që orienton raportet mes individëve, shoqërive, partive, grupeve, qeverive, qyteteve, fshatrave dhe shkretëtirave në vendet arabe dhe islame.* Përveç kësaj, janë përhapur urrejtjet etnike, format e diskriminimit fisnor, racor dhe



lokal në punë, qendra dhe burime të furnizimit. Këto çështje janë përshkallëzuar në shumë vende për t'u shndërruar në protesta dhe luftëra që kërkojnë ndarje. Tragjeditë që po shohim sot në **vendet arabe dhe islame janë** shembuj praktik për këtë që po themi. Këto detaje vërehen më poshtë si vijon:



Edukata bart përgjegjësi të madhe në përhapjen e këtij mendimi negativ. Kjo arrihet përmes historisë xhahilite, poezisë dhe ligjëratave pa i kritikuar fare e as pa i krahasuar pasojat e saj në realitetin e vështirë me të cilin po ballafaqohen sot vendet arabe dhe islame.

Po ashtu, sistemet administrative bartin një përgjegjësi të ngjashme me të nëpërmjet praktikave fanatike në shpërndarjen e posteve dhe vendeve të deputetëve në Parlament.

Njëkohësisht që kultura dhe traditat dominuese bartin përgjegjësi të ngjashme me to, sepse të gjitha bashkëveprojnë negativisht me çështjet e dallimeve dhe divergjencave njerëzore në formimin e marrëdhënieve shoqërore.




Forma e shtatë dhe e fundit e “personalitetit të pjekur - të formuar” është mbrojtja e vazhdueshme e përmbajtjeve të gjashtë formave që i potencuam më parë. Po ashtu, rishikimi i praktikave përmes kontrollimit të ndikimit në realitetin në të cilin jemi duke jetuar, me qëllim të pastrimit dhe ripërtëritjes së energjive dhe shkathtësive.

Forma e mbrojtjes ka për qëllim ripërtëritjen e katër dimensioneve në jetën tonë:

- 1- **Ripërtëritje fizike**, e cila përfshin praktikën në zbatimin e formave të shëndosha në punë, lëvizje, ushtrime sportive, kujdesi për ushqim dhe rregullimi i problemeve psikike dhe mentale.
- 2- **Ripërtëritje mentale**, e cila përfshin praktikën për vazhdim në të mësuarit, kërkim të njohurive të dobishme dhe aftësinë për planifikim dhe shkrim.
- 3- **Ripërtëritje shpirtërore**, e cila përfshin kristalizimin e vlerave, përkujdesin për kryerjen e ibadeteve dhe zbatimin në vazhdimësi të veprave të mira, studimit dhe meditimit.
- 4- **Ripërtëritje shoqërore-emocionale**, e cila përfshin praktikën në dashurinë e njerëzve, solidarizimi me ta, kontributi në ruajtjen e sigurisë. Kësaj i


bashkëngjitet edhe dashuria ndaj krijesave të tjera që e rrethojnë duke bërë përpjekje për të bashkëjetuar me to.




Aktivizimi i kësaj forme dhe praktikimi i saj kërkon fuqi dhe vendosmëri të fortë për t’u liruar nga pengesat e traditave shoqërore dhe kulturore, të cilave u ka kaluar koha si dhe nga pengesat e trashëguara në mendime, sisteme dhe institucione të cilat nuk janë të përshtatshme për kohën bashkëkohore. Këtu shihet urtësia e **thirrjes së vazhdueshme kur’anore** për pendim, “**teube**”, dhe se Allahu i do të penduarit dhe të pastërtit. Është kështu ngase pendimi është ripërtëritje e vazhdueshme e vlerave të besimit. Ecje krahas ligjeve të Allahut, të cilat thonë se Allahu çdo ditë është në gjendje të ndryshme dhe se Ai nuk ndalet nga krijimi i krijesave të reja, njerëz dhe gjësende, gjë që, nga ana tjetër, kërkon ripërtëritje të

njeriut në format, aftësitë dhe orientimet e tij për t'u njohur me dukuritë e krijimit të ri dhe përpikërinë në bashkëveprim me to.

Në anën tjetër, Kur'ani në mënyrë të vazhdueshme qorton ata që thonë se ne kështu i kemi gjetur baballarët tanë duke vepruar dhe se ne vazhdojmë gjurmëve të tyre. Po ashtu, e qorton këtë qëndrim ngase është shkak kryesor në ngurtësinë e jobesimtarëve dhe të hipokritëve ndaj trashëgimisë në besim, traditave dhe institucioneve të vdekura. Mund të paramendojmë se sa e madhe do të ishte humbja sikur besimet, mendimet, sistemet dhe institucionet e xhahilijetit do të qëndronin përballë besimit, mendimit, sistemit dhe institucioneve islame. Mund të paramendojmë madhësinë e kësaj humbjeje nëse shohim pasojat negative të vazhdimit të shumë prej këtyre traditave shoqërore dhe politike të xhahilijetit në jetën bashkëkohore në vendet arabe dhe islame. Analizo grafikun që vijon:



Pjekuria -në shtatë format- për të cilat biseduam më parë dhe arritja e shkallës së superioritetit ndaj të tjerëve nënkupton aftësinë për të kontribuar në **“suksesin e arritjeve kolektive dhe realizimin e fitoreve kombëtare”**.



Duhet të jemi objektiv dhe të themi se traditat dominuese në shoqëritë *arabe dhe islame* bashkëkohëre qëndrojnë si pengesë e madhe përballë zbatimit të një pjese të madhe të formave të kësaj ripërtëritje. E gjithë kjo për shkak se nuk mund të heqin dorë nga traditat e baballarëve, si dhe duke e konsideruar çdo gjë të vjetër si të shenjtë, të paprekshme, dhe përhapjen e mendimit tradicional në të gjitha pikëpamjet dhe marrëdhëniet.

Institucionet edukative dhe informative bartin përgjegjësi të madhe në gjithë këtë çështje, ngase nxisin përkushtimin ndaj çdo gjëje që është e vjetër duke e konsideruar si të shenjtë, duke i anashkaluar shkathtësitë e ripërtëritjes dhe duke u marrë me çështje që nuk lidhen fare me realitetin e jetës së njerëzve e as me botën që i rrethon.

KAPITULLI I TRETË

EDUKATA DHE ZHVILLIMI I EFIKASITETIT TEK UMETI

Edukata e vetëdijshme dhe reformuese nuk mjafton vetëm me nxjerrjen e “*personalitetit të pjekur-formuar*”, por kalon drejt përgatitjes së hartës së umetit të fuqishëm për mobilizimin e përpjekjeve të individëve dhe organizimin e tyre në rrjetin e marrëdhënieve shoqërore *që lehtëson veprimin e institucioneve ekzekutuese, siç janë ato politike, ekonomike dhe ushtarake, të cilat zbatojnë parimet dhe orientimet e propozuara nga institucioni edukativ*. Është kështu, sepse bazamenti i efikasitetit të institucioneve ekzekutuese në çdo shoqëri është rezultat i efikasitetit të institucionit edukativ, i cili përgatit punëtorë për institucionet e lartpërmendura. Kur një shoqëri është më superiore se një shoqëri tjetër, në realitet këtu kemi superioritet të edukatorëve dhe institucioneve edukative ndaj të ngjashmeve në shoqëritë e tjera. Shkaku në këtë fshihet se humanizimi i njeriut është kushti kryesor përreth të cilit sillet fuqia e shoqërive dhe ngritja e civilizimeve. **Ky humanizim i njeriut realizohet kur sistemet edukative arrijnë sukses në ngritjen e raporteve mes njeriut dhe vëllait të tij njeri dhe botës përreth tij në bazë të vetëdijes së hapur**, e fuqishme në kuptimin e ligjeve të kësaj bote dhe në njohjen e saj si realitet objektiv i pavarur prej njeriut. Kur raportet e njeriut me vëllanë e tij njeri dhe me botën përreth tij ngrihen mbi këtë rregull, atëherë shoqëria bëhet “**shoqëri e hapur**”. Mirëpo, kur organizimi edukativ ngrihet mbi zhvlerësimin apo shkatërrimin e humanizimit të njeriut, atëherë raportet e njeriut shpëputen nga bota që e rrethon dhe shoqëria shndërrohet në “**shoqëri të mbyllur**”, e cila cilësohet me cilësi të kundërta me ato të “shoqërisë së hapur”. Grafiku që vijon e qartëson këtë realitet:



Secila nga këto dy shoqëri ka cilësitë dhe orientimet që përcaktojnë rrjedhën e aktiviteteve efikase. Këto cilësi do t'i sqarojmë në vijim:

PJESA E KATËRT

Cilësitë e “shoqërisë së hapur” dhe “shoqërisë së mbyllur”

Cilësitë e “shoqërisë së hapur”


“Shoqëria e hapur” cilësohet me cilësi të cilat përgatisin zhvillimin e fuqive dhe mundësive të individëve dhe shoqërive duke i mobilizuar në nivelin e mjaftueshëm për plotësimin e nevojave dhe përballimin e sfidave.

Cilësitë e tilla më të rëndësishme janë:

- 1- **Cilësia e parë:** Dominimi i “*shpirtit të punës kolektive*” në aktivitetet e jetës momentale. Është kështu sepse reagimet e njerëzve për të përballuar sfidat dhe për të plotësuar nevojat në ambientin përreth tyre nuk do të jenë efikase, përpos nëse ngrihen mbi organizimin e përpjekjeve, koordinimin e mirë mes tyre dhe zgjedhjen e mjeteve dhe metodave më të mira dhe më pas përdorimi, zëvendësimi dhe vlerësimi i tyre, bazuar në “vetëdijen” e grupit ndaj kërkesave të situatave në të cilat kalojnë.
- 2- **Cilësia e dytë:** Ngritja e raporteve të njerëzve me botën mbi bazën e “*vetëdijes*” së thellë me realitetin duke kuptuar informacionet që ndërlidhen me këtë realitet. Kjo vetëdije dhe ky kuptim janë elementet që mundësojnë njeriun të risistemizojë shkathtësitë e ekuilibruara, të qëndrojnë përballë sfidave të realitetit dhe të riformulojë këtë realitet dhe ta zhvillojë atë.
- 3- **Cilësia e tretë:** Ngritja e raporteve të njeriut me botën përreth tij mbi bazën e përplotësimit me të. Me përplotësim nënkuptojmë të ndikojë dhe të ndikohet reciprokisht. Ky është fryt i vetëdijes kritike, që domethënë vetëdijes së fuqishme për të kuptuar realitetin, për ta kritikuar, për të kristalizuar veprat, strategjitë dhe mjetet e nevojshme për bashkëveprim me sfidat, rreziqet dhe problemet. Me anë të kësaj cilësie, njeriu dallon nga kafsha, e cila “*përshtatet*” me botën përreth tij dhe ndikohet pa pasur mundësinë për të ndikuar dhe nuk mund të ngrejë raporte të pavarura me të, përpos lidhjeve organike dhe reaksioneve instiktive dhe mekanike.
- 4- **Cilësia e katërt:** Njohja e ndarjes së kohës në të “*kaluar*”, të “*tashme*” dhe të “*ardhme*”. Rëndësia e kësaj njohjeje fshihet në atë se përmes saj njeriu ka mundësinë të përcaktojë fillimin e “*periudhave historike*” dhe përfundimin e tyre. Po ashtu, ka mundësi të dallojë periudhat në të cilat njerëzit kanë ngritur raporte në mënyrë të pavarur dhe efikase me botën përreth, duke iu përgjigjur

sfidave, duke ndikuar në realitetin e tyre, duke realizuar humanizimin dhe duke ngritur kulturën e tyre në vendin gjeografik në të cilin kanë jetuar.

“Periudha historike” është një grumbull ambiciesh, interesimesh dhe vlerash që synojnë realizime përmes punës njerëzore, formimit të orientimeve dhe kulturës së përgjithshme. Sa më shumë që këto ambicie, interesime dhe vlera të realizojnë humanizimin e njeriut, aq më shumë periudha historike do të cilësohet si e përparuar. Në anën tjetër, sa më shumë që këto ambicie, interesime dhe vlera të dështojnë në realizimin e humanizimit të njeriut, aq më shumë periudha historike do të cilësohet si e prapambetur. Grafiku vijues i përmbledh këto cilësi të dy shoqërive:



Cilësitë e “shoqërisë së mbyllur” janë si në vijim:

1- Cilësia e parë: Në “shoqërinë e mbyllur” njerëzit nuk kuptojnë as nuk e njohin rëndësinë e punës kolektive. Për këtë, timonin ia dorëzojnë “*elitës tirane*”, e cila dominon ndaj shumicës, i zhvesh nga humanizimi i tyre, i izolon nga bashkëveprimi me realitetin, i ndalon nga kritikimi i këtij realiteti dhe u imponon atyre “*kulturën e heshtjes*”, gjë që i bën vetëm spektatorë ndaj asaj që ndodh përreth tyre dhe i shndërron ata përmes “*kallëpit logjik*” në viktimë të fjalëve të kota dhe reklamave dezorientuese me qëllim të nënçmimit të tyre.

Përmes proceseve të shkatërrimit dhe zhvlerësimit të lartcituara, njeriu i thjeshtë goditet nga frika, ka frikë nga raportet e sinqerta, duke dyshuar në ekzistimin e tyre, dhe bashkohet me moshatarët e tij në grupe njerëzore pa pasur vetëdije rreth gjendjes momentale e as shpresë për të ardhmen. Atyre u mungon mendimi, vlerat njerëzore dhe lidhjet e dashurisë së nevojshme për ngritjen e shoqërive njerëzore të realta dhe bashkëndihmuese. Ata bëhen tamam siç i ka cilësuar Kur’ani: *kanë sy, por nuk shohin, kanë veshë, por nuk dëgjojnë dhe kanë mend, por nuk kuptojnë, ata janë si kafshët, bile edhe më keq.*⁵⁴

2- Cilësia e dytë: Pamundësia e njerëzve në “shoqërinë e mbyllur” për të kuptuar çështjet e kohës së tyre dhe zhvillimet aktuale, pamundësia për të kritikuar, analizuar dhe ndërhyrë në rrjedhat e saj. Për këtë, zhvillimi historik i shkel ata dhe shndërrohen në viktimë të tij. Këtë lloj të pamundësisë, Kur’ani e quan “vdekje”, për të cilin ka thënë:

“أَوَمَنْ كَانَ مَيِّتًا فَأَحْيَيْنَاهُ وَجَعَلْنَا لَهُ نُورًا يَمْشِي بِهِ فِي النَّاسِ كَمَنْ مَثَلُهُ فِي الظُّلُمَاتِ لَيْسَ بِخَارٍ مِّنْهَا كَذَلِكَ زُيِّنَ لِلْكَافِرِينَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ”

“Vallë, a është ai që qe i vdekur kurse Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësira (i humbur) dhe nuk mund të shpëtojë nga ajo. Ja, kështu (si këtij në errësirë) iu duket mirë mohuesve ajo që veprojnë.”⁵⁵

Vdekja që potencohet në këtë ajet është vdekje e kapaciteteve mendore dhe të vullnetit, e jo vdekje e trupit njerëzor, ngase Allahu nuk i ngjall trupat e vdekur para

⁵⁴ “Ne kemi krijuar, me të vërtetë, shumë xhind dhe njerëz për Xhehenem: ata kanë zemra (mend) me të cilat nuk kuptojnë, kanë sy me të cilët nuk shohin, kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si shtazë, madje, edhe më të zi. Ata janë të pakujdesshëm.” (El E'raf:179).

⁵⁵ El En'am: 122.

Ditës së Kiametit. Për këtë, këtu për qëllim është humnizimi i njeriut që e dallon nga kafsha. Për këtë, ajeti kur'anor thotë: *وَجَعَلْنَا لَهُ نُورًا يَمْشِي بِهِ فِي النَّاسِ* **“...Dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njerëzve...”**, dhe nuk ka thënë: *“Ec me të në tokë...”*, ngase njeriu në tokë ecën me sytë e ballit, ndërsa mes njerëzve ecën me kapacitetet e tij mendore të shëndosha dhe me vullnetin e tij të prerë. Këto të dyja janë për qëllim në ajetin kur'anor. Me këtë realitet ndërlidhet edhe rreziku i sulmit ndaj mendjes dhe vullnetit të njeriut me depresion, joefikasitet dhe ngurtësi. Allahu i Lartmadhëruar që ka ndaluar vrasjen e njeriut, pra trupin e njeriut përpos me të drejtë, në asnjë mënyrë nuk ka lejuar vrasjen e psikës së njeriut, pra mendjen dhe vullnetit të tij, edhe nëse pronari i tyre është jobesimtar dhe kriminel. Kjo nënkupton se në asnjë mënyrë nuk ka lejuar sulmin ndaj humanitetit të njeriut, shkatërrimin e mendjes dhe vullnetit të tij, sepse nëse i mbytet mendja dhe vullneti, ai do të bëhet kafshë e pamundur për të kuptuar argumentet e së vërtetës dhe dritës së mesazhit, që si rrjedhojë bëhet i pamundur besimi dhe siguria.

3- Cilësia e tretë: Njeriu në *“shoqërinë e mbyllur”* nuk *“përplotësohet”* me botën përreth tij, por përshtatet me të. Njeriu i *“përshtatur”* nuk është efikas, por shndërrohet në objekt që ndikohet nga të tjerët dhe nuk ndikon ai te të tjerët. Përshtatshmëria është instikt i kafshëve që humb humanitetin e njeriut dhe e bën atë të dobët për të mbrojtur veten. Është kështu sepse njeriu i paaftë për të ndryshuar gjendjen reale, përshtatet me këtë realitet, i nënshtrohet presioneve dhe i dorëzohet sfidave. Për këtë, njerëzit gjatë tërë historisë kanë bërë përpjekje, gjë që vazhdojnë edhe sot të dominojnë ndaj këtyre faktorëve, të cilat i bëjnë *“të përshtaten”* dhe i nënshtrohen sfidave të realitetit. Përpjekjet e tyre më së shumti shihen në luftën kundër padrejtësisë që sjell ndaj tyre *“elita tirane”* brenda shtetit ose ndonjë *“popull”* që i lufton ata nga jashtë.

4- Cilësia e katërt: Njeriu në *“shoqërinë e mbyllur”* vazhdon të vuajë nga pandjeshmëria me llojet e kohës: *e kaluar, e tashme dhe e ardhme*. Koha për të është gjithnjë *“e tashme”* e vazhdueshme që nuk ka *“të kaluar”*, e as *“të ardhme”*, ndaj vazhdon të vuajë nga pamundësia për të kuptuar sfidat dhe dobësinë para problemeve. Kur e *“tashmja”* shndërrohet në të kaluar dhe e ardhmja në të tashme, do të vazhdojë të vuajë nga ndryshimet e fuqishme gjatë ndryshimeve momentale pa pasur ndikim në rrjedhat e saj. Në gjitha këto kundërthënie sheh afrimin e kiametit.⁵⁶

⁵⁶ Paul Freire, **Education for critical consciousness**, New York: The continuum, co. 1989, pp. 3-30.

PJESA E PESTË

Edukata reformuese dhe edukata e ngurtë e mendjes dhe e vullnetit

Secila shoqëri, qoftë “shoqëria e hapur” apo “shoqëria e mbyllur”, del si rezultat i një sistemi të caktuar edukativ. Për llojin e parë të sistemit, këtu do të përdorim termin “*edukata reformuese*”, ndërsa për sistemin e dytë emrin “*edukata e ngurtë logjike*”.

Me termin “*edukatë reformuese*” kemi për qëllim edukatën në të cilën bashkëpunojnë familja me institucionet edukativo-arsimore, siç janë shkollat dhe fakultetet, duke iu bashkëngjitur edhe institucionet administrative dhe gjyquese me qëllim të përgatitjes së klimave, përvojave dhe aktiviteteve të nevojshme për “**reformimin**” e shkathtësive mendore dhe fizike, si dhe orientimet vullnetare tek njeriu. Ky njeri, i cili posedon aftësi dhe përgatitje deri në atë nivel që i mundëson atij të ngrejë raporte me botën përreth tij dhe me njerëzit e tjerë, duke u bazuar në parimin e “**plotësimit**” e jo “**të përshtatjes**”, duke kuptuar të ardhmen dhe duke pasur vetëdije që i mundëson shpikjen e mjeteve të nevojshme për t’u përballur me sfidat e vendit dhe të kohës, si dhe për të marrë pjesë në sjelljen e vendimeve që ndërlidhen me të tashmen dhe të ardhmen e tij.

Sa i përket “*edukatës së ngurtë logjike*” me këtë **nënkuptohet të menduarit sipas kallëpeve të ngurta dhe orientimi i vullnetit të njeriut në atë mënyrë që njerëzit i shndërron në kope njerëzore** që shumë lehtë mund të shfrytëzohen sipas dëshirave të udhëheqësve tiranë, **qoftë babai, pushtetari apo elitë drejtuese**. Edukata e ngurtë logjike realizohet përmes edukimit familjar autoritar, institucioneve edukative zyrtare dhe mjeteve të informimit, të cilat veprojnë nën ndikimin e sistemeve diktatoriale dhe të partive elitare, të cilat veprojnë për të sjellë shumicën përreth disa personave elitar, të cilët në shoqëri paraqiten si të pagabuar, dhurues të jetës dhe persona që bëjnë historinë.


Secila nga këto dy lloje të edukatës ka anët pozitive dhe ato të dobëta. Edukata reformuese nxjerr shoqëri dhe institucione që janë të fuqishme për të vlerësuar aktivitetet individuale dhe kolektive të bazuara në baza shkencore dhe logjike, pa u trishtuar kur të kuptojë se ai duhet të heqë dorë nga shumë bindje, vlera, tradita, aktivitete mendore dhe praktika që pengojnë përparimin. Për këtë, edukata reformuese angazhohet për të diskutuar problemet aktuale me plot guxim dhe

pozitivitet, që ka për qëllim diagnostifikimin dhe trajtimin e jo përhapjen e fitneve dhe mosmarrëveshjeve. Krahas kësaj, edukata reformuese realizon trajnimin e njeriut që në mënyrë të vazhdueshme të vlerësojë arritjet dhe të analizojë çështjet, në mënyrë dialektike ruan raportet me realitetin dhe hulumton format dhe mjetet shkencore të nevojshme për ta përballuar këtë realitet dhe për ta kuptuar dhe zhvilluar atë.

Njeriu i edukatës reformuese koncentrohet në sfidat ekzistuese. Ai nuk zhytet në të **“kaluarën”** e të parëve të mëdhenj, ngase arritjet e mëdha të të parëve janë veprat e tyre, e jo veprat e tij, dhe se ato arritje kanë plotësuar nevojat e kohës së tyre, e jo të kohës së tij. Njeriu i edukatës reformuese nuk zhytet në të **“tashmen”** e të tjerëve nga shoqëritë e përparuara bashkëkohore, sepse arritjet e tyre shkencore dhe shoqërore janë rezultat i bashkëveprimit me rrethanat e veçanta të tyre, e jo me rrethanat e tij, janë zgjidhje të problemeve të tyre, jo problemeve të tij dhe plotësim i nevojave të tyre, jo nevojave të tij. *Importimi i përvojave pedagogjike të gatshme nga jashtë, nxjerrin “identitet të huaj” në kulturë, ndjeshmëri të ulët, dëshpërim në shpresë dhe krizë në identitet.*

Nga kjo nuk duhet kuptuar se njeriu i edukatës reformiste i këput të gjitha rrënjët me të kaluarën, e as i mbyll dyert nga e tashmja e të tjerëve, por kuptimin e ka se ky njeri veprimin e tij e përqendron në përballimin e “sfidave” dhe të problemeve të së tashmes. Ai shfrytëzon përvojat e së kaluarës të nxjerra nga trashëgimia e të parëve për të mësuar bazat e të tashmes së tij dhe mediton rreth përvojave të të tjerëve të importuara nga jashtë për të pasuruar njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të përballuar sfidat e të tashmes së tij dhe për të plotësuar nevojat e tij.

Për realizimin e qëllimit të lartshënuar, metodat e edukatës reformuese për nxënësit ofrojnë mundësinë e diskutimit dhe dialogimit, i orientojnë për hulumtim në burimet e përvojave metodologjike dhe mbjellin tek ata bindjen në llojllojshmërinë e këtyre përvojave. Ata nuk përkufizohen vetëm në atë që i thotë *“elita dominuese”*, e as nuk e pranojnë si të saktën e vetme. I ushtrojnë nxënësit për analizim dhe kritikim, si dhe për njohje për anët pozitive dhe negative, duke respektuar autorët dhe duke pasur kujdes ndaj lëndimit dhe ofendimit të tyre. Kur ndodhin mospajtime në të kuptuarit e ndonjë çështjeje, secila palë ka të drejtë të shfaqë mendimin e tij dhe më pas që të gjithë presin për të zbuluar zbatimi praktik se cili është kuptimi i saktë.



Mos harro!

Importimi i përvojave pedagogjike të gatshme nga jashtë, nxjerrin “identitet të huaj” në kulturë, ndjeshmëri të ulët, dëshpërim në shpresë dhe krizë në identitet.

Kjo është metodologjia kur'anore gjatë dialogut me ata që janë larguar nga mësimet e tij, duke kërkuar prej tyre të presin **“përfundimin”**, që nënkupton përfundimin e mësimëve teorike dhe shpifjeve të tyre kundër këtyre mësimëve në ngjarje praktike që sqarojnë të vërtetën nga e pavërteta. Allahu thotë:

“وَلَقَدْ جِئْنَاهُمْ بِكِتَابٍ فَصَّلْنَاهُ عَلَىٰ عِلْمٍ هُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا تَأْوِيلَهُ يَوْمَ يَأْتِي تَأْوِيلَهُ يَقُولُ الَّذِينَ نَسُوهُ مِنْ قَبْلُ قَدْ جَاءَتْ رُسُلُنَا بِالْحَقِّ قَهْلَ لَنَا مِنْ شُفْعَاءَ فَيَشْفَعُوا لَنَا أَوْ نُرَدُّ فَنَعْمَلَ غَيْرَ الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ قَدْ خَسِرُوا أَنْفُسَهُمْ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ”

“Ne u sollëm atyre një libër (Kur'anin) që ua shkoqitëm në baza të diturisë, e që është udhërrëfyes e mëshirë për ata që besojnë. Ata nuk presin tjetër, por vetëm atë që do t'u vijë (dënim i premtuar) ajo që e pritnin, ata që më parë e kishin harruar thonë: Vërtet të dërguarit e Zotit tanë erdhën me fakte të vërteta, a keni ndonjë ndërmjetësues që të na shpëtojë, ose të kthehemi (në dynja) e të veprojmë tjetër nga ajo që vepruam! Ata shkatërroan vetveten dhe u shkoi huq trillimi që e bënin.”⁵⁷

Shprehja **“te’vil”** në ajetin kur'anor, siç thotë Ibn Tejmije në librin e tij *“Fetava”*, ka kuptimin e përfundimit, pra ndryshimit ose shndërrimit të teksteve kur'anore në ndodhi shoqërore dhe kozmike. Për këtë, në edukatën reformuese, nuk ka hapësirë për të monopoluar të vërtetën, për akuza të terrorizmit ideologjik dhe akuza të devijimit akaidologjik, *përderisa sheriati jobesimtarëve u jep të drejtën për të pritur ngjarjet që zbulojnë të vërtetën nga e pavërteta dhe përderisa muxhtehidit që e qëllon i jep dy sevape, ndërsa atij që gabon një sevap*. Trajnimi i nxënësve për tolerim dhe pranimin e mendimit të tjerëve është mbrojtje për ardhmërinë e tyre nga orientimet e terrorizmit politik, mbylljen e lirisë dhe totalitarizmit.

Edukata reformuese përqendrohet në diagnostifikimin e gjendjes reale. Ajo nuk harxhon energjinë e saj në sulm ndaj të tjerëve që i mashtrojnë dobësia e gjendjes reale për të okupuar, *sepse natyra e të fortëve është të shfrytëzojnë dobësinë e të dobtëve*. Atëherë kur edukata reformuese të ketë sukses në kthim në gjendjen normale të shoqërive **“tirane dhe poshtëruese”**, do të shndërrohet armiqësia e të fortëve në miqësi dhe poshtërimi i tyre në respekt.

Edukata reformuese kupton mirë dallimin mes **“botës kulturore”** dhe **“botës natyrore”**. Kultura është arritje njerëzore, të cilën njeriu ia shton botës natyrore. Ndërsa **“bota natyrore”** është ekzistim i universit, të cilin e ka krijuar Allahu dhe e

⁵⁷ El A'raf: 52-53.

ka angazhuar njeriun të zbulojë ligjet e tij për të shfrytëzuar në formimin e “**botës kulturore**”, të cilën e ngre ai. Analizo grafikun vijues:




PJESA E GJASHTË

Sistemet bashkëkohore të edukimit në vendet arabe dhe islame


Përhapja e “ngurtësisë mendore” dhe “vetëdijes naive”

Edukata dominuese në vendet arabe dhe islame, qoftë në familje, në shkolla apo universitete, në institucionet fetare apo kulturore, në partitë apo grupacionet, ose në praktikën e mjeteve të informimit dhe kulturore, të cilat janë nën mbikqyrjen e shteteve dhe qeverive, është edukata që nuk posedon asnjë cilësi të reformimit. E gjithë kjo, për shkak vijues:


- 1- **Shkaku i parë:** Është edukatë e “*ngurtë mendore dhe e vullnetit*”. Ajo ka për qëllim që mendja dhe vullneti të mbeten rob të edukatës së të folurit dhe zgjerimeve gjuhësore. Për shkak të kësaj cilësie, disa këtë edukatë e akuzojnë se është edukatë “*teorike*”. Kjo kritikë është e gabuar, ngase e barazojnë atë që është “*teorike*” me atë që është “*fjalë e pakuptimtë*”. Në realitet, edukata aktuale bashkëkohore në vendet arabe dhe islame ka nevojë për “**teori**”, ngase teoria merret me gjendjen reale dhe e analizon atë, gjë që ndihmon në të kuptuarit e tij në mënyrë të plotë. Edukata aktuale në vendet arabe dhe islame ka nevojë për **analizë**, **hulumtim** dhe **kreativitet**. Për këtë, kjo teori nuk është teorike, por është “*fjalë e pakuptimtë*”, që mendjet i vë në një kallëp të caktuar dhe formon orientimet sipas asaj që kërkojnë interesat e elitës në pushtet. *Programet e kësaj edukate janë përgatitur në atë mënyrë që të jenë larg jetës, të zbrazëta nga realiteti, të varfra në aktivitet shkencor dhe anojnë drejt imagjinatës, naivitetit dhe formalitetit.*



2- Shkaku i dytë: Metodatat e përdorura në institucionet e saj nuk nxisin diskutimin dhe dialogun e temave, por pranojnë *fjalimet* dhe *ligjëratat*. Po ashtu, nuk nxisin veprimin me nxënësit dhe njerëzit e thjeshtë, por u imponojnë një sistem të rreptë që i detyron të përshtaten me të. Për këtë, sistemin edukativ që praktikon familja, shkolla, universiteti, partitë politike dhe grupet reformuese, nuk i përgatisin njerëzit për përplotësim, konsultim dhe punë kolektive, ngase reziston dukurinë e shfaqjes së “*udhëheqësve diktatorë*” dhe popullatës së dëgjueshme.




3- Shkakut i tretë: Është edukata e prapambetur në zhvillimin e umetit dhe kohën kur i tërë globi është bërë sikur të jetë një fshat. Që të dyja këto çështje kanë nevojë për institucione dhe punë kolektive. Kjo edukatë është e huaj për të realizuar zhvillimin e shoqërive dhe kulturave vendore. Si rezultat i kësaj kulture prodhohen të gjitha dobësitë në fushën politike, administrative, ekonomike, ushtarake, legjislativë etj. Programet edukative ekzistuese luajnë rol të madh në ngulitjen e kësaj kulture përmes zhvillimit të hershëm të fëmijëve dhe nxënësve në prehërin e *kulturave të fanatizmit fisnor, lokal dhe racor*. Në vendet arabe, për shembull, këto kultura shihen në poezitë e **Imruul Kajs, En Nabigatu Dhubjani, Amr ibn Kulthum**, në poezitë paraislame të lavdëruesve dhe sulmuesve, për të vazhduar e gjithë kjo me poetët si **Xherir, Firezdek, El Ehtal, El Mutenebi** etj. Këto poezi dhe të ngjashme me to, siç janë ligjëratat dhe prozat, edhe pse nuk kanë ndonjë kuptim të madh shkencor bashkëkohor, megjithatë helmojnë mendjen dhe vullnetin e të rinjve në vitet e hershme, duke e shkatërruar tek ata ngritjen në shkallët e të menduarit analitik, mbyll vullnetin e tyre nga shembëlltyra e lartë e njeriut të edukatës islame. Kjo edukatë burgos përkatësinë e tyre brenda kufijve të fanatizmit të ngushtë, u vret atyre fuqinë për t'u zhvilluar dhe për të hyrë në fshatin e rruzullit tokësor në të cilin janë duke jetuar. Kjo edukatë mbush mendjet e të rinjve me orientime dhe vlera negative, të cilat dominonin gjatë periudhës së xhahilijetit, gjë që më pas ka formuar sjelljen e tyre në periudhën e pubertetit dhe atë në pozicione të udhëheqjes, administratë, politikë, kulturë, rrjetet informative, raportet shoqërore, përkatësia ideologjike dhe profesionale etj. Kjo edukatë zhvillon tek ata dëgjueshmërinë në vend të planifikimit dhe organizimit, reaksionin e shpejtë në vend të dialogut të qetë dhe logjik, individualizmin në vend të punës kolektive, nervozizëm në vend të realizimit të aspiratave, përballimit të sfidave dhe zgjidhjes së problemeve me atë që “thonë” e jo me atë që “veprojnë” dhe kështu trajtojnë çështjet e tyre me deklaratat dhe ligjëratat në vend të veprimeve të suksesshme.



4- Shkaku i katërt: Mosarritje në nivelin e duhur në “**sasinë**” dhe “**cilësinë**” edukative. Sa i përket “**sasisë**” edukative, studimet që janë realizuar në pedagogjinë krahasuese, tregojnë qartë se ndër shkaqet kryesore për efikasitetin e popujve si *Japonia* dhe mosefikasitetin e popujve si *popujt arabë dhe islamë* është edhe dallimi i madh në numrin e institucioneve edukative në të dy vendet. Për shembull, numri i universiteteve në Japoni është diku afër 1000 (një mijë) në një shtet që ka diku 60 milionë banorë,⁵⁸ ndërkohë bota arabe që ka diku 200 milionë banorë ka diku 100 (njëqind) universitete. Përqindje të ngjashme kemi edhe me shkollat fillore dhe të mesme. Sa i përket “**cilësisë**” edukative, krahasimi mes përmbajtjeve mësimore në një shtet si Shtetet e Bashkuara të Amerikës me shtetet arabe dhe islame nxjerrin në pah se “*efikasiteti*” i popullit të SHBA-së dhe joefikasiteti i shteteve arabe dhe islame fshihet në atë se programet mësimore tek e para përqëndrohen rreth nevojave dhe sfidave të së “*tashmes*”. Ata për këtë qëllim shfrytëzojnë përvojat e së “*kaluarës*” dhe përpiqen për të zbuluar sfidat e së “*ardhshmes*” në gjithë rruzullin tokësor. Në anën tjetër, programet mësimore në vendet arabe dhe islame praktikojnë ikjen nga diskutimi i së “*tashmes*” dhe marrja e studiuesve me “*të kaluarën*” e të parëve dhe “*të tashmen*” e të huajve.

⁵⁸ Keto informata/ statistika janë të vjetra. Statistikat e vitit 2019 flasin kështu:

- 1- Numri i universiteteve nacionale/kombëtare: 86.
- 2- Numri i universiteteve publike ndërkombëtare: 98.
- 3- Numri i kolegjeve private junior: 301.
- 4- Numri i kolegjeve private parauniversitare: 619.
- 5- Numri i banorëve të Japonisë: 125.8 milionë viti 2020. Për më shumë rreth sistemit edukativo arsimor japonez, amerikan dhe atij arab shih punimin tonë me titull: “Mungesa e precizitetit në edukim dhe arsim”. www.drhafezi.net (vërejtje e recensentit).




PJESA E SHTATË

Edukata, efikasiteti dhe shkallët e nevojave njerëzore

Ka një lidhshmëri të ngushtë mes plotësimit të nevojave natyrore të njeriut, nga njëra anë, shpërthimit të energjisë në punë dhe ngritja e efikasitetit në arritje dhe kreativitet, nga ana tjetër. Zhvlerësimi i këtyre nevojave shkatërron efikasitetin e njeriut, shkakton çrregullim në praktika dhe e gjithë kjo përfundon në pamundësi dhe dembelizëm, gjë që shpie në dobësimin dhe shpartallimin e umetit.

Për gjithë këtë, edukata reformuese si objektiv kryesor e sheh zhvillimin e sistemit të vlerave që plotësojnë nevojat e njeriut dhe përpiqet për plotësimin dhe ruajtjen e tyre. Që edukata reformuese të jetë shumë efikase, duhet patjetër të ngrihet mbi bazën e vetëdijes së plotë për nevojat njerëzore dhe ndikimin e tyre në sjelljen, orientimet dhe shkathtësitë e njeriut, analizo grafikun më poshtë:




Psikologjia i ka kushtuar dukurisë së nevojave njerëzore një kujdes të veçantë, gjë që praktikisht e kanë zbatuar shkencat politike, të administratës dhe të edukimit. Prej burimeve bazë në këtë sferë kemi teorinë e shkallëve të nevojës së **Abraham Maslow**, pishtar i psikologjisë humaniste, e cila e llogarit njeriun si qenie të veçantë dhe bën dallimin mes tij dhe kafshëve.

Kjo teori ngrihet mbi bazën e asaj se njeriu ka motive dhe nevoja të shumta, të cilat orientojnë sjelljen e tij dhe të njëjtat ndryshojnë gjatë jetës. Ndonjëherë janë të fuqishme, e herë të tjera të dobta. Nevoja më e fuqishme në raste të caktuara nxisin aktivitetin dhe sjelljen.


Këto nevoja, Maslow i klasifikon në grupet e mëposhtme:

1. **Nevojat fiziologjike;**
2. **Nevojat e sigurisë;**
3. **Nevojat sociale (të përkatësisë);**
4. **Nevojat e vlerësimit (njohjes);**
5. **Nevojat e vetaktualizimit.**



Forma 1. Nevojat fiziologjike.


Radhitja e këtyre nevojave për nga fuqia, dobësia dhe ndikimi i tyre në efikasitetin e arritjeve është sipas figurës së mëposhtme, mos harro grafikun që vijon:




Në formën 1 të lartshënuar, shihet se shkalla më e lartë – bazike- është ajo e nevojave fiziologjike. Ajo është nevoja më e fuqishme ngase ato nevoja janë elementare dhe të domosdoshme për jetë, *siç janë nevoja për ushqim, veshje, strehim, martesë* etj. derisa nuk plotësohen këto nevoja elementare në atë shkallë saqë të sigurojnë jetën e trupit dhe kryerjen e detyrave, atëherë pjesa dërrmuese e interesimeve dhe aktiviteteve të njeriut do të përqendrohen rreth kësaj shkalle të nevojave, ndërsa për shkallët e tjera motivimi do të jetë më i vogël.

Forma 2. Nevojat e sigurisë.

Kur nevojat fiziologjike janë të plotësuara, atëherë, në krye të nevojave, vijnë ato të sigurimit. Ato dominojnë tek interesimet e njeriut dhe orientojnë aktivitetet e tij, siç është rasti në figurën e mëposhtme:




Në formën 2 shihen nevojat e sigurisë në krye, që nënkupton se janë nevojat më të fuqishme. *Nevojat e sigurisë nënkuptojnë lirim nga frika, dëmtimi fizik ose privimi nga nevojat elementare.* Kjo nënkupton ruajtjen e jetës, nderit dhe pasurisë deri në atë shkallë sa që individ i të jetë në gjendje të sigurojë ushqimin dhe strehimin për jetën e tij. Nëse siguria e njeriut është në rrezik, atëherë nevojat e tjera janë të parëndësishme për të dhe i tërë interesimi, aktiviteti dhe sjellja e tij përqendrohet në garantimin e sigurisë që synon dhe ruajtjen nga rreziku që e kërcënon.




Forma 3. Nevojat e përkatësisë.

Nevoja e tretë është nevoja sociale ose e përkatësisë. Pasi njeriu është qenie shoqërore dhe nuk mund të jetojë i vetmuar, atëherë vjen në shprehje nevoja për përkatësim dhe pranim nga individë të tjerë ose grupe të tjera. Njeriut kur i plotësohen nevojat elementare fiziologjike dhe nevojat e sigurisë deri në një nivel të pranuar, atëherë ai fillon të kujdeset për gjetjen e lidhjeve me të tjerët, kështu që - nevoja e përkatësisë- llogaritet si motivi më i fuqishëm i sjelljes së tij, siç shihet qartë në figurën e mëposhtme:



Forma 4. Nevoja e vlerësimit ⁵⁹.

Pasi njeriu të plotësojë nevojat e përkatësisë, ai në të shumtën e rasteve fillon të përfitojë respektin e grupit që i përket. Në këtë rast nevoja e katërt -nevoja për vlerësim- kalon në epiqendrën e interesimeve të tij, duke e orientuar sjelljen e tij dhe duke u ngritur në krye të interesimeve të tij, siç shihet qartë në figurën e mëposhtme:




Me nevojën e vlerësimit ndërlidhen dy motive: **pozita dhe fuqia**. Sa i përket pozitës, ajo mund të lindë me njeriun nëse ka lindur në një familje apo ambient që kanë pozitë të lartë. Pozitën njerëzit e kërkojnë në forma të ndryshme. Shumë prej tyre mjaftojnë vetëm me arritjet materiale, ndërsa të tjerë përpiqen ta arrijnë përmes arritjeve personale dhe vetaktualizimit. Sa i përket fuqisë, ajo është dy lloje: **fuqi e pozitës** dhe **fuqi e personalitetit**. Ka njerëz që absolutisht nuk kanë fuqi.

Forma 5. Nevoja për vetaktualizim.

Kur nevoja e vlerësimit plotësohet në mënyrë të pranuar, atëherë njeriu fillon të interesohet për gjërat që e forcojnë dhe e vazhdojnë këtë vlerësim. Në këtë rast -nevoja për vetaktualizim- bëhet motivi më i fuqishëm dhe arrin pikën më të lartë në shkallët e nevojave, siç shihet qartë në figurën e mëposhtme:

⁵⁹ **Vini re!** Këto grafika në këto forma lexohen nga e majta në të djathtë, dmth: sa here që plotësohet apo sigurohet shigjeta e parë prej këtyre nevojave; sigurohet/lartësohet tjetra, dhe kështu të gjitha nevojat apo kërkesat. Nëse e para sipas kësaj radhitje nuk plotësohet, e dyta nuk mund të realizohet. Por siç pohon edhe autori i librit që kjo radhitje nuk është



Sipas Maslow-it, nuk duhet patjetër që nevojat e njeriut të veprojnë sipas radhitjes që ai ka paraqitur. Po ashtu, nuk duhet patjetër që këto nevoja t'i përshtaten të gjithë njerëzve. Ato janë modeli dominues në të shumtën e kohërave dhe te shumica e njerëzve.

MOS HARRO: Grafika e shigjetave të lartëpërmendura duhet lexuar dhe duhet kuptuar se pa u plotësue nevoja e paraprake nuk realizohet nevoja që pason/vijon. (recenzuesi)

Nevoja e vetaktualizimit kërkon shumëfishimin e prodhimit të njeriut dhe përpjekjen maksimale në kreativitet.

- 1- Mendimtari ka nevojë të shkruajë dhe të prodhojë mendimet më të mira që janë në mundësinë e tij.
- 2- Komandanti ushtarak ka nevojë të realizojë fitoret më të rëndësishme dhe të fitojë luftrat më të mëdha.
- 3- Politikani ka nevojë të arrijë sukseset më të mëdha politike. Kështu, pra, vetaktualizimi është dëshirë e njeriut që të arrijë atje ku është në mundësinë e tij të arrijë, gjë që e nxit “efikasitetin” në formën më të kompletuar.

Hulumtimet e bëra pas Maslow-it në lidhje me nevojën e vetaktualizimit, kanë kristalizuar këtë nevojë në dy motive: **motivi i meritës** dhe **ai i arritjes**.

Sa i përket motivit të meritës ose ekuivalencës ajo përfshin fuqinë për të dominuar ndaj faktorëve të ambientit natyror dhe shoqëror. Njerëzit që kanë këtë motiv, nuk presin që gjërat të ndodhin vetvetiu, por dëshirojnë të kenë fuqi të formojnë ambientin për të ndodhur gjërat. Fuqia apo dobësia e këtij motivi varet nga eksperimentet e kaluara të suksesit apo dështimit. Pritjet e individëve formohen sipas përvojave të tyre. Ata që kanë pritje negative, tek ata dobësohet shpirti i iniciativës dhe i rrezikimit. Ata lejojnë që ambientin të ndikojë tek ata më shumë se sa bëjnë përpjekje për ta ndryshuar. Ky motiv është i ndryshueshëm sipas përvojave të suksesit dhe të dështimit. Sidoqoftë, ka raste kur motivi i meritës anon drejt qetësisë dhe plogështisë. Kur njeriu arrin në një moshë të caktuar, ai rrallë mund të arrijë më shumë se sa mendon se ka fuqi për ta bërë, sepse ai përpiqet për arritjen e gjërave që mendon se nuk ka fuqi për to.

Sa i përket motivit të arritjes, dijetarët që merren me sjelljen e njeriut kanë vërejtur se disa individë kanë nevojë të madhe për arritje, ndërsa disa të tjerë, ndoshta shumica, nuk shihet se kanë interes për arritje. Disa ekspertë mendojnë se karakteristikat më të rëndësishme të njerëzve që kanë nevojë të madhe për arritje janë:

- a. *Studimi i çështjes me përpikëri para se ajo të fillojë.*
- b. *Baraspeshim në rrezikim.*
- c. *Kujdesi për arritje më shume se motivet dhe shpërblimet.*
- d. *Kalimi i një kohe të gjatë në të menduarit rreth asaj se çka duhet punuar.*⁶⁰

⁶⁰ Paul Hersey and Ken Blanchard, **Managment of organizational behavior** (Englewood cliffs prentice – Hau, Inc. 1982) pp. 37-40.



Sipas Maslow-it, nuk duhet patjetër që nevojat e njeriut të veprojnë sipas radhitjes që ai ka paraqitur. Po ashtu, nuk duhet patjetër që këto nevoja t'i përshtaten të gjithë njerëzve. Ato janë modeli dominues në të shumtën e kohërave dhe te shumica e njerëzve.

Maslow ka vërejtur se ka disa njerëz që nuk i nënshtrohen shkallëve të nevojave të lartcituar. Ai për këtë ka sjellë shembull rastin e udhëheqësit indian, Gandit, i cili ka flijuar nevojat fiziologjike dhe të sigurisë me qëllim që të plotësojë nevojat e tjera, në kohën kur India luftonte për pavarësi nga pushtimi britanik.⁶¹

Nuk dua të merrem me kritika ndaj Maslow, i cili sjell një shembull si Gandi dhe anashkalon një gjeneratë të tërë siç është gjenerata e sahabëve në historinë islame, të cilët kanë paraqitur një shembull të rrallë të sakrifikimit me nevojat fiziologjike dhe të sigurisë me qëllim të ngritjes drejt vetaktualizimit. Sahabët mbesin një gjeneratë e rrallë që nuk përsëritet, siç potencon Kur'ani në mënyrë të qartë se arritja e kësaj shkalë, me të cilësohet një grup i të parëve dhe pak prej të mëvonshmëve.

⁶¹ Paul Hersey & other, op. cit, f. 29.

Në realitet, një hulumtim i thelluar në Kur'anin Famëlartë nxjerr në pah se Allahu i Madhërishëm këtë sakrifikim nuk e ka bërë rregull të përhershëm në strategjinë e veprimit islam, por e ka orientuar të Dërguarin e Tij përkohësisht, në kohën kur kërkoi prej tij të kërkojë një vend për të emigruar dhe veproi për të siguruar të gjitha shkallët e nevojave për pasuesit e tij, duke filluar nga nevojat fiziologjike, më pas ato të sigurisë, përkatësisë, gjë që plotëson kushtet për vetaktualizim në meritë dhe arritje, duke bërë përpjekje në bartjen e mesazhit islam në mbarë botën.

Vërehet se kujdesi i radhitjes së nevojave njerëzore është parim i ngulitur në shpalljet hyjnore për të cilat flet Kur'ani. Kjo shihet qartë në ajetet që flasin për lutjen e Ibrahimit a.s., ku thotë:

“رَبَّنَا إِنِّي أَسْكَنْتُ مِنْ ذُرِّيَّتِي بِوَادٍ غَيْرِ ذِي زَرْعٍ عِنْدَ بَيْتِكَ الْمُحَرَّمِ رَبَّنَا لِيُقِيمُوا الصَّلَاةَ فَاجْعَلْ أَفْنَدَةً مِنَ النَّاسِ تَهْوِي إِلَيْهِمْ وَارْزُقْهُمْ مِنَ الثَّمَرَاتِ لَعَلَّهُمْ يَشْكُرُونَ”

“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që të falin namazin, pra bëj që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata dhe, për të falënderuar me mirënjohje, furnizoi ata me fruta.”⁶²

“وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَدًا آمِنًا وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ الثَّمَرَاتِ مَنْ آمَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ قَالَ وَمَنْ كَفَرَ فَأُمَتِّعُهُ قَلِيلًا ثُمَّ أَضْطَرُّهُ إِلَى عَذَابِ النَّارِ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ”

“Dhe kur Ibrahim tha: Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoi me lloje të frutave! Allahu tha: (E furnizoi) Edhe atij që nuk besoi do t’ia mundësojë shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër, e pastaj do ta shtyej në dënimin e zjarrit, e sa përfundim i shëmtuar është ai.”⁶³

Lutja për plotësimin e nevojave të sigurisë, nevojave fiziologjike (frutet) dhe nevojat e vlerësimit (nga zemrat e njerëzve) janë mjete që ndihmojnë pasardhësit e Ibrahimit që të jenë të lirë për nevojat e vetaktualizimit, sipas konceptit kur’anor, të cilat janë (të falin namazin) dhe (me shpresë se do të falënderojnë). Falja e namazit nënkupton zbatimin e kuptimeve të tij në jetën reale, ndërsa realiteti i falënderimit është të përdorësh mirësitë e Allahut sipas programit të Tij. Jeta sipas këtyre dy parimeve nënkupton “efikasitetin” që “përpjekjen” dhe “mundësinë” njerëzore e vë për të

⁶² Ibrahim: 37.

⁶³ El Bakare: 126.

arritur vullnetin e Allahut në ngritjen e civilizimit njerëzor përmes urdhrit drejt së mirës dhe ndalimit nga e keqja.

Kur'ani të drejtën e sigurimit të nevojave njerëzore nuk e përkufizon vetëm për një lloj të caktuar, as për një besim të caktuar, por atë e bën të drejtë të barabartë për të gjithë njerëzit, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Kur Ibrahim i lutjen e tij për siguri, frute dhe nevojën për vlerësim, e përkufizoi vetëm për ata që besojnë, erdhi përgjigjja hyjnore *وَمَنْ كَفَرَ فَأُمَتِّعُهُ قَلِيلًا* **“Edhe atij që nuk besoi do t’ia mundësojë shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër.”** Shprehja “kalilen-për një kohë të shkurtër” këtu është për qëllim periudha e jetës së kësaj bote. Është cilësuar kështu sepse është shumë e shkurtër në krahasim me jetën e ahiretit që është e pafund.

Nga kjo mund të përfundojmë se nuk lejohet të jemi të pakujdesshëm në nevojat e njerëzve për ushqim, strehim, siguri dhe respekt për shkak të dallimeve në besim, sjellje, mendime dhe qëndrime. Nuk lejohet internimi, konfiskimi, ndërprerja e burimeve të jetës, largimi nga vendi i punës e as privimi nga liria. Në Kur'an kemi shkakun e zbritjes së ajetit kur'anor: *لَيْسَ عَلَيْكَ هُدَاهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ* **“Nuk është obligim yt (Muhamed) udhëzimi i tyre.”**⁶⁴ Ku flitet se një grup i muslimanëve financonin disa prej jehudëve të Beni Kurejdha dhe Beni Nadir në Medine me të cilët kishin lidhje familjare dhe ata deshën të ndërpresin këtë financim me qëllim që t’i detyrojnë të hyjnë në islam, atëherë zbriti shpallja që ndalon Muhamedin s.a.v.s. dhe i informon muslimanët se Allahu nuk pranon që presioni ekonomik të jetë mjet për udhëzimin e njerëzve.⁶⁵

Ngjashëm me të kemi edhe rastin kur Ebu Bekri r.a. deshi të ndërpresë ndihmën financiare që u ofronte disa prej atyre që u morëm me çështjen e shpifjes ndaj Aishes [radijallahu anha]. Erdhi shpallja dhe e ndaloi ndërprerjen e kësaj ndihme, duke thënë:

“وَلَا يَأْتِلِ أُولُو الْفَضْلِ مِنْكُمْ وَالسَّعَةِ أَنْ يُؤْتُوا أُولِي الْقُرْبَىٰ وَالْمَسَاكِينَ وَالْمُهَاجِرِينَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلْيَعْفُوا وَلْيَصْفَحُوا أَلَا تُحِبُّونَ أَنْ يَغْفِرَ اللَّهُ لَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ”

“Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjet e tyre, por t’ua falin (gabimet) dhe mos t’ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t’u falë ju? Allahu falë dhe mëshiron shumë.”⁶⁶..Analizo grafikun vijues me vëmendje:

⁶⁴ El Bakare: 272.

⁶⁵ Taberiu, Tefsir, (Suretul Bakare, 272), vëll. III, f. 94.

⁶⁶ En Nur: 22.

Nevoja e vetaktualizimit kërkon shumëfishimin e prodhimit të njeriut

1.1-Mendimtari ka nevojë të shkruajë dhe të prodhojë mendimet më të mira që janë në mundësinë e tij.

1.2-Komandanti ushtarak ka nevojë të realizojë fitoret më të rëndësishme dhe të fitojë luftrat më të mëdha.

1.3-Politikani ka nevojë të arrijë sukseset më të mëdha politike. Kështu, pra, vetaktualizimi është dëshirë e njeriut që të arrijë atje ku është në mundësinë e tij të arrijë, gjë që e nxit "efikasitetin" në formën më të kompletuar.

Hulumtimet e bëra pas Maslow-it në lidhje me nevojën e vetaktualizimit, kanë kristalizuar këtë nevojë në dy motive: **motivi i meritës dhe ai i arritjes.**

MOTIVI I MERITËS

MOTIVI I ARRTJES

Sa i përket motivit të meritës ose ekuivalencës ajo përfshin fuqinë për të dominuar ndaj faktorëve të ambientit natyror dhe shoqëror

Sa i përket motivit të arritjes, dijetarët që merren me sjelljen e njeriut kanë vërejtur se disa individë kanë nevojë të madhe për arritje, ndërsa disa të tjerë, ndoshta shumica, nuk shihet se kanë interes për arritje

karakteristikat më të rëndësishme të njerëzve që kanë nevojë të madhe për arritje janë:

a-Fuqia apo dobësia e këtij motivi varet nga eksperimentet e kaluara të suksesit apo dështimit.

b-Pritjet e individëve formohen sipas përvojave të tyre. Ata që kanë pritje negative, tek ata dobësohet shpirti i iniciativës dhe i rrezikimit.

c-Ata lejojnë që ambientet të ndikojnë tek ata më shumë se sa bëjnë përpjekje.

- Studimi i çështjes me përpikëri para se ajo të fillojë.
- Baraspeshim në rrezikim.
- Kujdesi për arritje më shumë se motivet dhe shpërblimet.
- Kalimi i një kohe të gjatë në të menduarit rreth asaj se çka duhet punuar

ABRAHAM MASLOW...SJELL PER SHEMBULL GANDIN DHE ANASHKALON KUR’ANIN !!

Gandi ka flijuar nevojat fiziologjike dhe të sigurisë me qëllim që të plotësojë nevojat e tjera, në kohën kur India luftonte për pavarësi nga pushtimi britanik...

1-Allahu i Madhërishëm këtë sakrifikim nuk e ka bërë rregull të përhershëm në strategjinë e veprimit islam...

2-Allahu e ka orientuar të Dërguarin e Tij përkohësisht, në kohën kur kërkoi prej tij të kërkojë një vend për të emigruar dhe veproi për të siguruar të gjitha shkallët e nevojave për pasuesit e tij.... nevojat fiziologjike, më pas ato të sigurisë, përkatësisë, gjë që plotëson kushtet për vetaktualizim në meritë dhe arritje..analizo këto ajete vijuese:

“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që të falin namazin, pra bëj që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata dhe, për të falënderuar me mirënjohje, furnizoi ata me fruta...”

Dhe kur Ibrahim tha: Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoi me lloje të frutave! Allahu tha: (E furnizoi) Edhe atij që nuk besoi do t’ia mundësojë shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër...”

- *Lutja për plotësimin e nevojave të sigurisë, nevojave fiziologjike (frutet)..*
- *dhe nevojat e vlerësimit (nga zemrat e njerëzve) janë mjete që ndihmojnë pasardhësit e Ibrahimit që të jenë të lirë për nevojat e vetaktualizimit...*
- *sipas konceptit kur'anor, të cilat janë (të falin namazin) dhe (me shpresë se do të falënderojnë). Falja e namazit nënkupton zbatimin e kuptimeve të tij në jetën reale..*
- *ndërsa realiteti i falënderimit është të përdorësh mirësitë e Allahut sipas programit të Tij.*
- *Jeta sipas këtyre dy parimeve nënkupton “efikasitetin” që “përpjekjen” dhe “mundësinë” njerëzore e vë për të arritur vullnetin e Allahut në nartien e civilizimit njerëzor*

Kur'ani të drejtën e sigurimit të nevojave njerëzore nuk e përkufizon vetëm për një lloj të caktuar, as për një besim të caktuar, por atë e bën të drejtë të barabartë për të gjithë njerëzit, qofshin besimtarë apo jobesimtarë...

Nga kjo mund të përfundojmë se nuk lejohet të jemi të pakujdesshëm në nevojat e njerëzve për ushqim, strehim, siguri dhe respekt për shkak të dallimeve në besim, sjellje, mendime dhe qëndrime. Nuk lejohet internimi, konfiskimi, ndërprerja e burimeve të jetës, largimi nga vendi i punës e as privimi nga liria...

Në Kur'an kemi shkakun e zbritjes së ajetit kur'anor: لَيْسَ عَلَيْكَ هُدَاهُمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ “Nuk është obligim yti (Muhamedi) udhëzimi i tyre.”¹ Ku flitet se një grup i muslimanëve financonin disa prej jehudëve të Beni Kurejdha dhe Beni Nadir në Medine me të cilët kishin lidhje familjare dhe ata deshën të ndërpresin këtë financim me qëllim që t'i detyrojnë të hyjnë në islam..Allahu nuk pranon që presioni ekonomik të jetë mjet për udhëzimin e njerëzve...Ngjashëm me të kemi edhe rastin kur Ebu Bekri r.a. deshi të ndërpresë ndihmën financiare që u ofronte disa prej atyre që u morëm me çështjen e shpifjes ndaj Aishes [radijallahu anha]. Erdhi shpallja dhe e ndaloi ndërprerjen e kësaj ndihme..

PJESA E TETË

Pakujdesi ndaj nevojave njerëzore dhe pengimi i efikasitetit të muslimanit bashkëkohor

Shumë prej njohësve të politikës dhe ekspertë pedagogjik pranojnë se ligjet e Maslow-it dhe psikologjia rreth shkallëve të nevojave njerëzore si në shoqëritë e botës së përparuar ashtu edhe në ato të Botës së Tretë janë në atë mënyrë që realizon qëllimet e botës së përparuar, në kohën që Bota e Tretë mbetet e prapambetur dhe e dobët.

Në shoqëritë e përparuara, politikat administrative, praktikat civile dhe ato të sigurisë, sigurojnë të gjitha nevojat fiziologjike, të sigurisë, të përkatësisë dhe të vlerësimit për qytetarët, qoftë brenda vendit apo jashtë, deri në atë nivel saqë motivi i vetëm mbetet vetaktualizimi përmes kreativitetit shkencor dhe arritjes ekonomike në fushat e ndryshme të jetës.

Ndërsa, në shoqëritë e Botës së Tretë, duke përfshirë shumicën e vendeve arabe dhe islame, praktikimi i shkallëve të nevojave në mënyrë të kundërt ka përfunduar në shkatërrimin e efikasitetit të njeriut në këto shoqëri. Pjesa dërmuese e banorëve të këtyre shoqërive në shkallën e kërimit të ushqimit, veshjes, banimit dhe martesës, pra të shkalla e nevojave fiziologjike, gjë që e bën ngritjen e njeriut në shkallën e vetaktualizimit si çështje të pamundur. Mjetet e shkatërrimit të këtyre nevojave realizohen përmes humbjeve të resurseve natyrore, qoftë përmes grushtshteteve, konflikteve fraksionale dhe lokale, çrregullimeve politike, sistemeve diktatoriale etj.

Po ashtu, nevojat e sigurisë janë shkatërruar përmes raporteve të këqija ndërmjet udhëheqësve dhe popujve. Që të gjithë janë të pasigurt, në dyshim, dhe nuk kanë besë mes vete, gjë që rezulton destabilizimin, pasigurinë mes njerëzve brenda vendit dhe ikjen nga vendi në shtetet e huaja. Shumë prej ekspertëve pranojnë se sistemet diktatoriale dhe procedurat policore janë imponuar në vendet e Botës së Tretë me qëllim që të jenë mjete që shkatërrojnë sigurinë dhe nderin e njeriut, gjë që e bën atë të kujdeset vetëm për nevojën e sigurisë dhe të jetë i paaftë për t'u ngritur në shkallën e vetaktualizimit, respektivisht në shkallën e kreativitetit dhe të arritjes.⁶⁷

Po ashtu, nevojat e përkatësisë janë shkatërruar përmes përhapjes së shkollave dhe ideologjive konfrontuese mes vete, ndarjes gjeografike, luftimit të faktorëve


⁶⁷ Noam Chomsky, **Detering Democracy**, New York: Hill and wang, 1992.

unifikues dhe sistematizimin e programve edukative dhe kulturore me qëllim të përhapjes së **“tjetërsimit kulturor”** tek të rinjtë, duke i lënë viktimë e ndjenjës për mangësi në shoqëri dhe moral.

Krizën dhe destabilizimin në piramidën e nevojave të njeriut bashkëkohor në vendet arabe dhe islame e ka shumëfishuar qëndrimi kontradiktor mes institucioneve edukative, kulturore dhe institucioneve administrative e të sigurisë. Institucionet edukative, informuese dhe shtëpitë botuese mbushin kokat e rinisë me çështjet e lirisë, unitetit, respektimin e njeriut, vëllazërinë islame etj. Kur qytetari i përgjigjet këtyre çështjeve edukative dhe kulturore duke u përpjekur t'i praktikojë ato në sjelljen, qëndrimet dhe orientimet e tij, në vend që të kompletohen këto çështje dhe të praktikohen në mënyrë të drejtë, ai përballet nga ana e institucioneve administrative dhe të sigurisë me qortime dhe dënime të rënda. Kur ai del jashtë vendit të tij në vendet e tjera arabe dhe islame, përballet me ligje dhe praktika që ia imponojnë të mohojë tërësisht idetë e unitetit dhe të vëllazërimit, të cilat i kishte mësuar më parë në institucionet edukative dhe kulturore. Ai përballet me pengesat e udhëtimit, listën e zezë, vendqëndrimin dhe shtypjet rajonale. Si rezultat i gjithë kësaj, kemi një zinxhir të dëshpërimeve dhe lëkundjeve psikologjike që kanë larë trurin nga besimi për unitet dhe miqësisë ndaj arabëve dhe muslimanëve. Shpërthimet ideologjike dhe psikologjike janë shumëfishuar dhe kanë përfunduar tek shumë individë, në veçanti të aftit dhe të talentuarit, deri në atë nivel që të mohojnë çështjet arabe dhe islame.

Format e pakënaqësisë janë të ndryshme. Ato shfaqen në mënyra të ndryshme. Qoftë përmes tërheqjes në vete, përgatitjes së kurtheve dhe hakmarrjeve, shthurjes morale dhe shoqërore. E gjithë kjo ndodh në botën arabe dhe islame, në kohën kur të gjithë kufijtë gjeografik dhe kulturorë janë larguar në vendet e botës përparimtare. Njeriu i shoqërive arabe dhe islame e sheh se si amerikanët dhe evropianet jetojnë në një kontinent të përplotësuar, pa u luftuar mes vete dhe pa u urrejtur. Kështu është në vendet përparimtare, në kohën kur në vendet arabe dhe islame është krejtësisht e kundërta. E gjithë kjo edhe më shumë e shton dëshpërimin e njeriut në shoqëritë arabe dhe islame dhe e dobëson efikasitetin në kreativitet dhe arritje.

Pakujdesi ndaj nevojave njerëzore dhe pengimi i efikasitetit të muslimanit bashkëkohor



PJESA E NËNTË

Edukata, efikasiteti dhe fuqitë konservatore, ekstremiste dhe reformiste

Shoqëritë njerëzore janë në ndryshim të vazhdueshëm. Për këtë sinjalizojnë edhe ajetet kur'anore: ﴿كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ﴾. **“Në çdo moment Ai është në gjendje** (të krijojë, të shpërblejë, të zhdukë).” anor:’Si dhe ajeti kur⁶⁸ ﴿وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ﴾ **“Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh.”**⁶⁹ Krijimi i ri nxjerr raporte të reja, raportet e reja kërkojnë formulime të reja të vlerave që rregullojnë këto raporte. Vlerat e reja kanë nevojë për institucione, praktika dhe mjete të reja.

Njerëzit nuk e kuptojnë këtë zinxhir në procesin e krijimit të ri - ose operacionet e kthimit historik - as nuk ndiejnë bashkëveprim efikas me to. Për këtë, ndryshimet e reja i hedhin jashtë dhe bien viktimë e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve. Për këtë sinjalizon ajeti kur'anor:

﴿بَلْ هُمْ فِي لَبْسٍ مِّنْ خَلْقٍ جَدِيدٍ﴾

“Jo, por ata janë në një huti rreth një krijimi të ri.”⁷⁰

Shkak për këto mosmarrëveshje dhe konflikte është se shoqëria kur fillon lëvizjen nga një periudhë historike në tjetrën, fillojnë të shfaqen vlera të reja dhe fillojnë të përgatisin ndjekësit për të vërtetuar ekzistimin e tyre, gjë që ngacmon vlerat dhe sistemet e vjetra, të cilat reagojnë dhe mobilizojnë ithtarët e tyre për t'i mbrojtur ato. Kështu fillon konflikti mes vlerave të vjetra dhe vlerave të reja. Në lidhje me këtë çështje, njerëzit ndahen në tri grupe:

- 1- Grupi i parë:** *Fuqitë konservative.* Ky grup dëshiron të ruajë të qëndrueshëm gjendjen aktuale dhe vepron për ta penguar *“lëvizjen e historisë”*.
- 2- Grupi i dytë:** *Fuqitë ekstremiste.* Ky grup dëshiron të përshpejtojë lëvizjen e historisë apo të ndryshojë rrjedhën e saj. Në të shumtën e rasteve, anëtarët e këtij grupi janë nga *“elita e shtypur”*, të cilët nuk lirohen nga padrejtësia dhe shpresojnë të jenë në ekzekutiv, pa pasur *“vetëdije”* rreth lëvizjes dhe ligjeve të historisë. Këto fuqi ekstremiste ndahen në dy pjesë:
a- fuqitë majtiste dhe


⁶⁸ Err Rrahman: 29.

⁶⁹ El Kasas: 68.

⁷⁰ Kaf: 15.

b- fuqitë paraardhiste (baballarëve).

Pika e përbashkët që bashkon të dy grupet është përpjekja për të ndryshuar “*elitën dominuese konservative*” me elitë dominuese ekstremiste. Mirëpo, këto të dyja dallojnë në llojin e vlerave me të cilat armatosen për realizimin e qëllimeve. Përderisa fuqitë majtiste vlerat e tyre i marrin nga kulturat e shoqërive të tjera, fuqitë paraardhiste vlerat e tyre i marrin nga e kaluara e baballarëve. Kur ndonjëra prej tyre realizon qëllimin, atëherë ajo shndërrohet në “*elitë konservative*” dhe vepron në ndalimin e lëvizjes së historisë. Grafiku në vijim i përmbledh këtoë:



3- Grupi i tretë: Fuqitë reformuese. Ky grup:

- a- “*Kupton*” lëvizjen e historisë dhe natyrën e periudhës kohore në të cilën është duke jetuar.
- b- Ky grup, tek njeriu i periudhës së re, përmes edukimit dhe reformimit të njohurive, vepron për reformimin e vlerave, institucioneve, shkathtësitë mentale e pratike si dhe orientimet administrative.

- c- Po ashtu, punon për pastrimin e tij nga mbeturinat e ngurtësisë dhe të ekstremizmit me qëllim që të bëhet i fuqishëm për të bashkëvepruar me dukuritë e krijimit të ri gjatë lëvizjes së historisë përreth tij.
- d- Fuqitë reformiste bashkëveprojnë me të kaluarën e baballarëve të tyre me qëllim që të zbulojnë rrënjët e së tashmes.
- e- Po ashtu, bashkëveprojnë me eksperiencën e të huajve për të përfituar nga arritjet e tyre.
- f- Bashkëveprojnë me “*ajetet kur'anore*” për t’ua gjetur vendin në jetën reale, si dhe formulimin e “*objektivave*” të këtij realiteti.
- g- Bashkëvepron me “*ajetet e horizontit dhe njeriut*” për të nxjerrë “*mjetet*” për realizimin e këtyre objektivave.
- h- Në fund shfrytëzimi i gjithë kësaj në formulimin e së “*tashmes*” dhe kalimin në të “*ardhmen*”, duke i plotësuar nevojat, zgjidhur problemet dhe duke u përballuar me sfidat e saj.
- i- Anëtarët e këtij grupi shtohen ose pakësohen varësisht nga ambienti edukativ-njohës me të cilën cilësohet rrethi shoqëror.
- j- Ata lindin si rezultat i lulëzimit të lëvizjes edukative, shkencore dhe kulturore, e cila përqendrohet në zemrën e së tashmes, lirohet nga të gjitha format e ndikimit dhe pastrohet nga të gjitha mbeturinat shoqërore dhe ideologjike në hulumtim dhe përpjekje.
- k- Në këtë grup ofrohen të talentuarit nga brenda dhe nxiten për t’u kthyer dhe për t’iu bashkëngjitur asaj të gjithë studiuesit e suksesshëm dhe shkencëtarët ekspertë nga jashtë.
- l- Mungesa e këtij grupi të reformistave shkakton dështim, frustrim dhe humbje të efikasitetit në ecjen e shoqërisë. Për këtë sinjalizon hadithi i Muhamedit s.a.v.s., në të cilin thuhet: “*Tërhiqet dituria dhe shfaqet injoranca, çrregullimet dhe shtohet ‘el herxhu’*. Thanë: “*Ç’është el herxhu?*” Tha: “*Kështu me dorë duke e lëvizur, mendonte në vrasjen.*”⁷¹

⁷¹ El Buhari, Sahih, “Tema e diturisë”.

Grupi i tretë: *Fuqitë reformuese*

"kupton" lëvizjen e historisë dhe natyrën e periudhës kohore

vepron për reformimin e vlerave, institucioneve, shkathtësitë mentale e pratike

punon për pastrimin e tij nga mbeturinat e ngurtësisë dhe të ekstremizmit
për të bashkëvepruar me dukuritë e krijimit të ri

bashkëveprojnë me të kaluarën e baballarëve të tyre me qëllim që të zbulojnë rrënjët e së tashmes

bashkëveprojnë me eksperiencën e të huajve për të përfituar nga arritjet e tyre

bashkëveprojnë me *"ajetet kur'anore"* për t'ua gjetur vendin në jetën reale, si dhe formulimin e *"objektivave"*

a. bashkëvepron me *"ajetet e horizontit dhe njeriut"* për të nxjerrë *"mjetet"* për realizimin e këtyre objektivave.

shfrytëzimi i gjithë kësaj në formulimin e së *"tashmes"* dhe kalimin në të *"ardhmen"*, duke i plotësuar nevojat, zgjidhur problemet

anëtarët e këtij grupi shtohen ose pakësohen varësisht nga ambienti edukativ-njohës


lindin si rezultat i lulëzimit të lëvizjes edukative, shkencore dhe kulturore, e cila përqendrohet në zemrën e së tashmes

ofrohen të talentuarit nga brenda dhe nxiten për t'u kthyer dhe për t'iu bashkëngjitur asaj të gjithë studiuesit e suksesshëm

Mungesa e këtij grupi të reformistave shkakton dështim, frustrim dhe humbje të efikasitetit në ecjen e shoqërisë


Fuqitë reformiste që të jenë të fuqishme për të përballuar ndryshimet e reja dhe për t'i orientuar në drejtimin e duhur kanë nevojë për vetëdije të thellë dhe të përgjithshme në tri çështje:

- 1- Njohje me natyrën e ndryshimeve, përfshirë konfliktet dhe divergjencat.*
- 2- Edukim reformues që përgatit njerëzit për përplotësim me të tjerët në ndryshimet që ndodhin përreth tyre.*
- 3- Ambient administrativ që materializon frytet e edukimit reformues në institucione dhe strategji që përfitojnë nga anët pozitive të ndryshimit dhe ruhen nga anët negative.*



Sa i përket çështjes së parë, theksuam më lartë se ndryshimi fillon atëherë kur fillon shoqëria lëvizjen nga “një periudhë” kohore në tjetrën, gjë që shpie në shfaqjen e vlerave të reja, të cilat punojnë për përforcimin e ekzistimit dhe ngritjen e vlerave të vjetra për të ruajtur veten e tyre. Në këtë rast, secila prej tyre mobilizon ithtarët e saj dhe fillojnë konfliktin, i cili herë është më i vogël e herë më i madh, varësisht nga suksesi apo dështimi i fuqive reformiste.

Gjatë konfliktit mes vlerave reformiste dhe vlerave të vjetra shtohen kontradiktat në institucione, format e të menduarit dhe sjelljet në secilin lloj prej vlerave të theksuara. Sa më shumë të thellohen kontradiktat, aq më shumë rriten baticat dhe zbaticat kulturore të cilat ndikojnë në praktikat e jetës dhe vendimet e marra. Dukuria më e rrezikshme e krizës është forma që marrin divergjencat dhe konfliktet. Në këtë rast, ose në duar e marrin fuqitë konservatore dhe ekstremiste, duke e transferuar në armatim, gjakderdhje dhe shkatërrim, ose në duar e marrin fuqitë reformiste, duke e organizuar dhe duke e shndërruar në ndryshim të dobishëm dhe mjet për përparim. Ky grafikon i përmbledh këto pika:



Sinjalizimi rreth konfliktit dhe divergjencave përsëritet në shumë ajete kur'anore. Si, për shembull:

"وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ إِلَّا مَن رَّحِمَ رَبُّكَ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ"

"Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete). Përveç atij që mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata."⁷²

"وَلَقَدْ صَدَقَكُمُ اللَّهُ وَعْدَهُ إِذْ تَحُسُّونَهُم بِإِذْنِهِ حَتَّى إِذَا فَشِلْتُمْ وَتَنَازَعْتُمْ فِي الْأَمْرِ وَعَصَيْتُم مِّن بَعْدِ مَا أَرَاكُمْ مَا تُحِبُّونَ"

"Allahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata (me shpata) deri kur u dobësuar dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit (që u pat caktuar Pejgamberi) dhe pasi vërejtët atë që e dëshironit (prenë e luftës), e atëherë kundërshtuat (urdhërin e Pejgamberit)."⁷³

Termi "tenazu'-konflikt" në Kur'anin Famëlartë përsëritet shtatë herë. Nga përmbajtja e tyre nxirren dy çështje: së pari, ka ndaluar besimtarët nga konflikti, ngase është shkak për dështim dhe humbje të fuqisë. Kjo shihet qartë në ajetin kur'anor:

"وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ وَاصْبِرُوا إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ"

"Respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë. Të jeni të durueshëm se Allahu është me të durueshmit."⁷⁴

Së dyti, të mos habiten nëse ndodh konflikti mes besimtarëve, përderisa besimtarët që janë në konflikt për të dalë nga kjo gjendje bazohen në norma që i nxjerrin nga Kur'ani dhe Suneti. Në lidhje me këtë çështje në Kur'an thuhet:

"يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ فَإِن تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا"

"O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashetrojeni atë te Allahu (te

⁷² Hud: 118-119.

⁷³ Ali-Imran: 152.

⁷⁴ El Enfal: 46.

libri i Tij) ***dhe te i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.***⁷⁵

Me shprehjen “*kthimi i konfliktit tek Allahu dhe i Dërguari i Tij*” është për qëllim gjyqimi me Kur’an dhe Sunet përmes “*Ulul Emr- urdhëruesve*”, të cilët kanë dituri se si të nxjerrin dispozitat nga to. Shumica e komentatorëve të sahabëve dhe atyre më pas janë të mendimit se për qëllim janë dijetarët e përkushtuar ndaj Allahut e jo udhëheqësit politikë dhe sulltanët⁷⁶. Ky lloj i dijetarëve nuk është paraqitur pas sahabëve dhe akoma është sfidë për pedagogjinë islame.⁷⁷

Nga kjo nënkuptohet se edhe Kur’ani konfliktin dhe mosmarrveshjet i klasifikon në dy lloje:

- a- *Lloj negativ dhe shkatërrues, i cili orientohet nga kultura e fanatizmit. Ky lloj është i ndaluar për besimtarët.*
- b- *Lloj pozitiv i orientuar nga mësimet e Kur’anit dhe Sunetit. Ky lloj është i pranuar.*

Divergjencat dhe konfliktet janë ligj i caktuar nga Allahu për shoqëritë njerëzore dhe janë shkak për zhvillim dhe përparim civilizues. Divergjencat mund të jenë në mendime dhe vlera, ndërsa konflikti është në praktikën e këtyre mendimeve dhe materializimi i tyre në strategji dhe programe. Divergjencat dhe konfliktet në realitetin shoqëror materializohen përmes ekzistimit të fuqive konservative dhe fuqive ekstremiste. Secili lloj prej tyre është domosdoshmëri shoqërore dhe objektiv e krijimit. Për këtë sinjalizon ajeti kur’anor i cituar më parë

وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ إِلَّا مَن رَّجِمَ رَبُّكَ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ

“Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete). Përveç atij që mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata.”⁷⁸

Ngase:

- a- *Fuqitë konservative veprojnë për sigurimin e stabilizimit dhe sigurisë, të cilat janë të nevojshme për ndërtim dhe arritje civilizuese.*

⁷⁵ En Nisa’: 59.

⁷⁶ Ky pohim nuk qëndron kështu si ka menduar autori, Allahu e mëshiroftë.

⁷⁷ Për të parë cilësitë dhe aftësitë e këtij lloji të dijetarëve, lexo librin: “Menahixhut terbijet ilamijeti vel murebbunel amilune fiha” të këtij autori.

⁷⁸ Hud: 118-119.


b- Ndërkohë që fuqitë ekstremiste veprojnë për shtyrjen e zhvillimit dhe përparimit, i cili nuk ndodh përpos përmes destabilizimit të gjendjes aktuale.

Për këtë është shumë e rrezikshme që ndonjëra nga këto dy fuqi të vijë në pushtet për të udhëhequr jetën politike dhe shoqërore,

- 1- Nëse konservatorët vijnë në pushtet, atëherë shoqëritë do të përfundojnë në prapambeturi.*
- 2- Po nëse ekstremistët vijnë në pushtet, atëherë do të përshpejtojnë lëvizjen e shoqërive që bie ndesh me ligjet e zhvillimit shoqëror dhe ligjet e ndërtimit, e cila çon në shkatërrimin e energjive dhe të fuqive.*

Për këtë ka nevojë për një baraspeshë mes të dy palëve, për bashkëjetesë të vetëdijshme që bashkon mes stabilizimit dhe zhvillimit pa iu nënshtruar përpjekjet e ndërtimit dhe civilizimit dridhjeve të forta që pengojnë arritjet.


- 3- Realizimi i këtij baraspeshimi dhe bashkëjetese është përgjegjësi e grupit të tretë. Ky është grupi i reformistave, të cilët i nxjerr edukata reformiste dhe i këshillojnë dy grupet e mëparshme rreth normave të divergjencave dhe konflikteve pozitive. Shih grafikun vijues:*



Sa i përket edukatës reformuese të nevojshme për aftësimin e njerëzve për përplotësim me kthesat aktuale themi: pasi njerëzit gjatë këtyre kthesave kanë nevojë për edukim të ri që i pastrojnë nga prangat ideologjike dhe ngarkesat shoqërore që shkaktojnë pengimin e “*elitës konservative*” për të kaluar të ardhmen nga njëra anë dhe ndalimi nga reaksionet e verbëra që shtyjnë “*fuqitë ekstremiste*” në reagim pa marrë në konsideratë ligjet e historisë dhe lëvizjeve, e gjithë kjo kërkon edukim që të gjithë të kenë mundësi për përplotësim me shpirtin e kohës në të cilin jetojnë dhe të ngrihen me realitetin e jetës së tyre.

Shoqërive që u mungon edukimi reformues, njerëzve në to do t’u humbasë humaniteti, do të jenë të paaftë për të lexuar sfidat e kohës së tyre, do të përshtaten me sfidat, do të dorëzohen para problemeve dhe do të shndërrohen në “gjësende” që do të ndikohen nga jashtë dhe do të vazhdojnë kështu të ndikuar e jo ndikues.

Edukata reformuese është dera e “*shoqërisë së re*” e hapur ndaj ndryshimeve të reja. Injoranca dhe edukata e ngurtë logjike janë tuneli i errët që shpie drejt “*shoqërisë së mbyllur*”, e cila do të përfundojë në prapambeturi dhe shkatërrim. Pikërisht për këtë, **Allahu ka filluar shpalljen me “*ikra*” – *lexo*”, e jo me “*yalu*” apo “*jep zeqat*” apo “*lufto*”, sepse çdo namaz, zeqat, luftë apo çdo vepër tjetër që nuk orientohet nga dituria dhe edukata do të shndërrohet në adhurim formal që anashkalon qëllimin dhe nuk sjell fare dobi.** Për këtë Muhamedi s.a.v.s. insistonte në kërkimin e diturisë dhe se një orë në kërkim të diturisë është më e mirë se një vit adhurim. Andaj, “*shoqëria e hapur*” për të ruajtur shëndetin dhe “*shoqëria e mbyllur*” për të dalë nga kriza, kanë nevojë për sistem edukativ të fuqishëm që sjell shpirt reformues, i cili mundëson vetëdije të thellë me zhvillimin e rrjedhave historike, dhe në të njëjtën kohë ka fleksibilitet për të bashkëvepruar me ndodhitë e reja me logjikë kritikuese dhe analizuese, me shkathtësi efikase që ndikojnë në gjendjen reale dhe njohuri reale që kuptojnë ndodhitë. Rikujto grafikun që vijon:




Edukata dhe forcat reformuese kanë nevojë që veprimin e tyre në ndihmën e njerëzve në shoqëri ta fillojnë me “*vetëdijen*” ndaj natyrës së fazave në të cilat kalon shoqëria dhe të kuptojnë kontradiktat mes vlerave të reja, të cilat po dalin në shesh, dhe atyre të vjetra që po humbin efikasitetin e tyre. Pasi ekziston një lidhshmëri mes një periudhe që është në zhdukje e sipër dhe një periudhe që është në lindje, atëherë mund të kuptohet se vlerat e vjetra do të rezistojnë shndërrimin e shoqërisë përmes fazave të shndërrimit të lartcituara më parë. Po ashtu, vlerat e reja insistojnë në përparimin e tyre dhe veprojnë për të përfituar mbështetje dhe për ta ngjyrosur realitetin shoqëror me ngjyrat e saj. Nga kjo nënkuptohet se procesi i ndryshimit kalon nëpër faza që ngërthejnë lëkundje të baticave dhe të zbaticave, përparimit dhe dështimit, varësisht nga përshtatja ose mospërshtatja me ligjet e lëvizjeve historike. **Këtu shfaqet rëndësia e edukatës reformuese dhe të grupit reformues.**

Nëse kjo edukatë nuk i ndihmon të gjithë grupet për të kuptuar brendinë e ndryshimeve aktuale, duke i pastruar nga ngurtësia e vlerave të vjetra, të cilat insistojnë, gjithsesi, të mbesin dhe nga mendimi i gabuar ekstrem, i cili shtrembëron vlerat e reja, atëherë, këto ndryshime do të jenë në kundërshtim me ligjet e kthesave historike, do të shkaktojnë luhatje në batica dhe zbatica shoqërore, gjë që do të bëjë që njerëzit të “*përshtaten*” ndaj nënshtrimeve katastrofale dhe do të kenë ndjenjën e humbjes dhe të inferioritetit.

Pikërisht prej këtu lind nevoja që mendimtarët dhe edukatorët reformues të kryejnë tri detyra:

- 1- Detyra e parë:** Vetëdijësimi i përkrahësve të vlerave të reja të mos dobësohen e as të mos pikëllohen para vlerave të vjetra dhe lëkundjeve që shkaktojnë, sepse nënshtrimi dhe dëmtimi, edhe pse e pengon lëvizjen, nuk mund ta ndalë lëvizjen dhe ndryshimin. Kjo është metoda e shpalljes kur'anore me Muhamedin s.a.v.s. dhe shokët e tij gjatë periudhës mekase.
- 2- Detyra e dytë:** Tërheqja e vërejtjes ndihmësve të vlerave të vjetra nga këmbëngultësia për të penguar lëvizjen e historisë, sepse mendimet dhe vlerat e reja që rezistohen nga ana e përkrahësve të vlerave të vjetra, do të insistojnë në marshimin e tyre derisa mendimet e vjetra, që kanë humbur efikasitetin, të humbin besueshmërinë dhe mendimet e reja të realizohen plotësisht. Kështu ishte diskursi hyjnor ndaj udhëheqjes kurejshite në Meke kur iu tërhoq vërejtja nga pasojat e rezistencës ndaj thirrjes islame.
- 3- Detyra e tretë:** Vetëdijësimi i përkrahësve të vlerave të reja të “*kuptojnë*” ligjet e këtyre vlerave dhe mesazhin e tyre mëshirues, dhe të jenë në gjendje të bëjnë përshtatshmërinë mes tyre në atë mënyrë që mos të kalojnë në “*ekstremizëm*” ose të përpiqen të “*përshepejtojnë*” lëvizjen e historisë, ngase vlerat e reja nuk mund të materializohen në jetën reale përpos përmes njohjes me ligjet e historisë. Kështu diskursi hyjnor ndaj Muhamedit s.a.v.s. dhe shokëve të tij në periudhën mekase ishte në këtë formë: **أَتَى أَمْرُ اللَّهِ فَلَا تَسْتَعْجِلُوهُ** “**Erdhi caktimi i Allahut, pra mos kërkoni ngutjen**”⁷⁹ - Nxitja për të mos dëmtuar dhe për durim, falje, anashkalim dhe kujdesi nga përballja me ligjet e Allahut dhe urdhrat e Tij ishte në nivel individual dhe kolektiv. Këto detyra mund i përmbledhim në grsafikun që vijon:

⁷⁹ En Nahl:1.



Në periudhën bashkëkohore, lëvizjet dhe filozofitë reformiste kanë luajtur rol vendimtar në Amerikë dhe Evropën Perëndimore në pengimin e përhapjes së komunizmit, ashtu siç ndodhi në Evropën Lindore. Shembull për të kemi atë që ka shkruar filozofi spanjoll Jose Ortega, në veçanti në librin e tij *"Revolucioni i popujve"*, për të cilin ka shkruar Revista e njohur **"Atlantik"**, duke thënë: "Nëse libri *"Shoqëria"* e Rosoit është libër i shekullit XVIII, dhe nëse libri *"Kapitalizmi"* i Karl Marksit është libër i shekullit XIX, atëherë, libri *"Revolucioni i popujve"* i Jose Ortega është libër i shekullit XX."⁸⁰

Thuhet se Ortega është pasardhës i muslimanëve të Andaluzisë të njohur me emrin El Morisijun. Ngjashëm me Ortegën janë edhe filozofët e përparimit-reformist, të cilët kishin ndikim të madh në Amerikë.

Rëndësia e fuqive reformiste në Evropën Perëndimore dhe Amerikë fshihet në atë se ua tërhoqën vërejtjen fuqive konservatore në të dyja kontinentet nga rreziku i këmbënguljes në darvinizmin shoqëror që orientonte në atë kohë vlerat politike, shoqërore dhe ekonomike si dhe arsyetonte procesin e shfrytëzimit dhe monopolimit. Po ashtu, fuqitë reformiste zvogëluan ndikimin e "ekstremistëve", të

⁸⁰ Jose Ortega Y. Gasset, **The revolt of the masses**, tr. (New York-London: W.W. Norton & Co. 1951.

cilët komentuan darvinizmin shoqëror në formë të ndryshme nga ajo që arsyetojnë konfliktet dhe revolucionet e përgjakshme, të cilat më pas ofruan vlera të reja që përshtaten me periudhën historike, e cila ka filluar në fillim të shekullit XX, të cilën Ortega e ka cilësuar si periudha e shfaqjes së publikut. Sa më shumë iu janë përgjigjur udhëheqësit konservativë dhe ekstremistë kërkesave të filozofisë reformiste në vendet e Evropës Perëndimore dhe Amerikën Veriore, aq më shumë janë ulur kontradiktat në këto vende dhe nuk kanë dhënë mundësinë për revolucione të përgjakshme dhe shkatërruese. Në të njëjtën kohë, kanë hapur rrugën për zhvillime paqësore, gjë që ka ruajtur resurset njerëzore dhe materiale nga shkatërrimi dhe ka bërë që ato të përplotësohen drejt përparimit në shoqëritë e lartpërmendura.

Sa i përket ambientit administrativ, i cili i shndërron frytet e edukatës reformiste në praktika reformiste, duhet të jemi objektiv dhe të themi se praktikat historike kanë vërtetuar se **demokracia e vërtetë -jo skeletet dhe motot-** është korniza e vërtetë në të cilën mund të ketë sukses edukata reformiste në sjelljen e baraspeshës mes fuqive konservatore dhe atyre ekstremiste, si dhe në shndërrimin e konfliktit dhe mosmarrveshjeve në faktor ndërtimi dhe përparimi, ngase kjo pengon ndikimin e ngurtësisë së konservatorëve dhe do të ruajë nga ndikimi i ekstremistëve përderisa i ofron të dyja grupeve këmbimin e udhëheqjes, pozitat ekzekutive dhe vendet e opozitës dhe vepron si siguresë që përgatit largimin e cilitdo grup nga pozicioni i ndikimit, atëherë kur politikatat e tyre kanë ndikim negativ dhe bëhen pengesë nga përparimi dhe zhvillimi civilizues.

Duhet të jemi objektiv dhe të themi se praktikatat perëndimore -sikur në Britani, Amerikë, bile edhe në Izrael- kanë materializuar praktikimin e kësaj baraspeshë mes fuqive konservatore dhe atyre ekstremiste. Kjo është realizuar duke i dhënë shanse secilit grup të këmbëjnë udhëheqjen dhe udhëheqësit administrativ dhe mbetjen në qeveri ose largimin nga ajo përmes zgjedhjeve. **Pra, popullata është ajo që përmes zgjedhjeve të lira të vendosë se kush do t'i përfaqësojë ata në parlament, gjyq dhe mjetet informative të lira, e jo mjete informative të shitura.** Krahës kësaj, duhen shfuqizuar institucionet e vjetra shoqërore, të cilat prishin shpirtin e këtyre praktikave, siç janë familjet dhe fiset që ngrihen mbi bazën e gjakut dhe ndalojnë rreptësisht ndikimin në proceset demokratike. Të gjitha këto duhen zëvendësuar me familje dhe fise të tjera të reja që përshtaten me kohën, nevojat dhe sfidat e saj, siç janë **familjet e dijetarëve, fiset e inxhinierëve, avokatëve dhe mjekëve.** Këto praktika, kanë përgatitur që të bashkëjetojë partia e konservatorëve me partinë e punëtorëve - për shembull, në Britani- dhe që të dyja të ndihmohen në interes të Britanisë. *Këto praktika kanë ndihmuar që me shekuj të bashkëjetojë dhe të*

bashkëveprojë partia e republikanëve konservatore me partinë e demokratëve në Amerikë. Të njëjtat ndihmojnë të bashkëjetojë dhe të bashkëveprojë partia Likod me partinë e punës në Izrael. Të gjitha këto parti kanë pajtim të plotë në “qëllime dhe objektiva”, edhe pse dallojnë mes tyre në “metoda dhe praktika”. E gjithë kjo realizohet pa u sharë mes vete ose pa hyrë në konflikt të përgjakshëm - me përjashtim të asaj që ndodhi me vrasjen e Icak Rabinit, i cili u vra nga ana e një hebreu të së djathtës.

Kur bëjmë krahasim mes praktikave perëndimore të lartcituara me udhëzimet kur'anore, të cilat i prezantuam në fillim të këtij kapitulli, do të vërejmë se ka përputhshmëri në parime e bazamente si dhe disa dallime në praktika. *Sa i përket anëve të përputhshmërisë dhe përshtatshmërisë, ajo vërehet se Kur'ani pranon divergjencat, konfliktin dhe respektimin e fuqive që e materializojnë atë; më pas veprimin për ngritjen e baraspeshës mes palëve konfrontuese, duke i dhënë liri të plotë në divergjencat dhe konflikt pa shkuar e gjithë kjo në përballime të përgjakura, gjë që përfundon në shkatërrimin e arritjeve, humbjen e energjive dhe zhdukjen e kapaciteteve. Pas kësaj **duhet mbështetur në mendimin orientues të umetit dhe praktikën në bindjen ideologjike dhe legjislativën shtetërore, që të jetë referencë dhe normë për sjelljen e baraspeshës gjatë divergjencave dhe konflikteve.** Është natyrale që të tërhiqet pëlqimi i udhëzimeve kur'anore me praktikën perëndimore, të cilat sjellin baraspeshën e synuar, si dhe institucionet që praktikojnë, siç janë zgjedhja e udhëheqësve dhe administratorëve, kontrollimi, ndërrimi, dënimi dhe largimi i tyre në rast nevojë, sepse nëse farzi apo vaxhibi nuk realizohet përpos në atë mënyrë, atëherë edhe ajo mënyrë është farz apo vaxhib. Në veçanti kur dimë se drejtësia është objektiv i të gjitha shpalljeve hyjnore, gjë që shihet qartë në ajetin kur'anor:*

”لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنْزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ”


“Ne i dërguam të dërguarit tonë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës.”⁸¹

Mirëpo, divergjencat fshihen vetëm në praktikimin e burimeve që i marrin si referencë, atëherë kur konservatorët dhe ekstremistët tejkalojnë vijat e baraspeshës dhe rrezikojnë ecurinë e ndërtimit. Nëse për popujt që besojnë në demokraci dhe kushtetutat që dalin nga to i konsiderojnë ato referencë dhe normë, atëherë referencë për të cilën këshillon Kur'ani është grupi i mendimtarëve, dijetarëve dhe mbarë

⁸¹ El Hadid: 25.

popullata që beson në islam, ndërsa normë mbetet të kuptuarit e kësaj reference për dy llojet e ajeteve: ajetet legjislative dhe praktikat pejgamberike dhe ajetet në horizonte dhe në vetë njeriun dhe vrojtimi i tyre logjik dhe material.

Duhet potencuar se orientimet mbizotëruese bashkëkohore në vendet arabe dhe islame, **nuk i përkasin as konceptit islam e as atij perëndimor, ngase referenca e tyre është koka e shtetit, ndërsa praktikë janë veprat e tij të padiskutueshme që nuk pranojnë diskutim.** Që të gjitha këto orientime në formë dhe brendi, mbështeten në tradita që janë pjellë e fanatizmave fisnore, që rrënjët i kanë në periudhën xhahilite paraislame dhe të njëjtat pjesërisht kanë vazhduar edhe në historinë islame. Për këtë, divergjencat dhe konfliktet materializohen në armiqësi reciproke, për të cilat përgatiten të gjitha llojet e armatimit gojor dhe material. Andaj, nuk ka hapësirë -në këto fanatizma fisnore- për baraspeshë mes fuqive konservatore dhe atyre ekstremiste. Dhe nuk ka hapësirë për bashkëjetesë dhe këmbim të pozitive përgjegjëse dhe udhëheqëse. Secila palë mendon se ka të drejtë, legjitimitet, vlerë dhe besnikëri absolute, që nuk lejohet të gjykohet e as të pyetet për të. Nga ana tjetër, akuzon palën tjetër me gabim, jolegjitimitet, pavlerë dhe tradhëti absolute. Dialogimi mes tyre është i ndaluar, ndërsa komunikimi arrihet ose duke lavdëruar ose duke poshtëruar, gjë që mbyll të gjitha rrugët e mirëkuptimit paqësor në çdo konflikt. Me këtë rast nuk mbetet pos një zgjidhje e vetme, e cila materializohet me ndjekje, arrestime, gjykime dhe sulme mediatike, nga njëra palë, ndërsa komplete, çrregullime, shpërthime, planifikime të kryengritjeve dhe grushtshteteve, nga pala tjetër. Në grafikun që vijon i përmbledhim disa me qështje me rëndësi:



Për gjithë këtë, përgjegjësi më e rëndësishme e edukatës reformative, që synojmë, është **angazhimi për edukimin e të dyja palëve: grupin e konservatistëve dhe grupin e ekstremistëve nga fillimi deri në mbarim** për të kuptuar divergjencat dhe konfliktet ku praktikimi i tyre në atë mënyrë që shpie drejt baraspeshës shoqërore dhe koordinimi me ligjet e zhvillimit, lëvizjet historike, ligjet e formimit të shoqërive dhe ngritjes së civilizimeve.

Po ashtu, lëvizjet reformuese kanë nevojë për kristalizimin e të kuptuarit të nevojshëm për zbatimin e divergjencave dhe konflikteve duke u bazuar në Kur'an, Sunet dhe praktikën civilizuese. Të gjitha këto çështje përgatisin bazamente të qarta dhe të pranueshme për bashkëjetesë me qeveritë dhe fuqitë e ndryshme, me të cilat kanë qëndrime të ndryshme. Në veçanti duhet kuptuar se Kur'ani dhe Suneti sqarojnë në mënyrë të prerë se divergjencat në besim nuk lejohet të zhvillojnë

deri në atë pikë sa të prekë shenjtërinë e njeriut dhe nëpërkëmbë të drejtat e tij për jetë, liri, pronësi dhe lirinë e zgjedhjes në mendim dhe shprehje.

Qeveritë, partitë dhe grupacionet që veprojnë në fushën e ndërtimit, reformimit dhe linjat e përballimit kanë nevojë të jenë të hapura dhe të guximshme, në atë mënyrë që të fillojnë me njohjen e vetes dhe të ripërtërijnë vlerësimin e mendimeve, vlerave dhe traditave dominuese, ngase ato përfshihen në rrethin e ndikimit që posedojnë dominim të drejtpërdrejtë. Praktikimi i këtyre traditave në politikë dhe shoqëri ka prishur të gjithë projektet dhe përpjekjet e ndërtimit, kështu që gjatë pesë dekadave të fundit ka shkaktuar humbjen e energjisë dhe shkatërrimin e resurseve -në veçanti resurseve njerëzore- të cilat kanë shkaktuar dhe vazhdojnë edhe më tutje në gjakderdhje njerëzore të vazhdueshme duke çuar në dobësimin e shoqërive arabe dhe islame.

Kriza e arabëve dhe muslimanëve bashkëkohorë është se ata nuk e kanë tejkaluar periudhën e familjes dhe të fisit. Që nga fillimi i ekzistimit njerëzor, njerëzit kanë bërë përpjekje për ta organizuar veten e tyre në grupe, duke filluar nga familja, fisi dhe grupet lokale. Më pas janë formuar shtete dhe popuj, derisa në kohën bashkëkohore kanë përfunduar në koalicione ndërkombëtare. Gjatë këtyre organizimeve kanë shfrytëzuar forma që përcaktojnë jetën dhe raportet e grupit me grupet e tjera. Po ashtu, kanë vepruar për zhvillimin e botës që të jenë në gjendje të jetojnë në të. Gjatë këtyre veprimeve kanë ndërhyrë dukuritë politike, ekonomike, shoqërore dhe njohëse me rrjedhat e zhvillimit njerëzor, duke u koordinuar me ndryshimet dhe duke u përshtatur me nevojat dhe sfidat e tij.

Mirëpo, arabët dhe muslimanët joarabë tek të cilët me çlirimet islame kanë depërtuar fanatizmat arabe, me ngushtimin e rrethit të edukatës islame, janë kufizuar në traditat islame në mendime dhe dialog. Kështu ka vazhduar fanatizmi familjar dhe fisnor në fushën politike, administrative, ushtarake, shoqërore dhe njohëse deri në atë nivel që rrezikon falimentimin e këtyre shteteve dhe zbrazjen e tyre nga njerëzit, kafshët dhe bimët.


Edukata është fusha në të cilën duhet të fillojë ndryshimi i këtyre orientimeve dhe praktikave, ngase në institucionet, programet dhe metodat edukative momentale, fillojnë të gjitha këto çështje negative. Në to, programi i fshehur vepron për edukimin e të rinjve rreth:

1- orientimeve fanatike fisnore,

- 2- mosmarrëveshjet dhe konfliktet e armatosura në periudhën e injorancës, të cilat gjenden në poezitë dhe prozat xhahilite, të cilat kanë vazhduar edhe në periudhën islame.
- 3- në to mësohet historia e konflikteve dhe luftërat e familjeve për shkak të pozitës dhe ndikimit në periudhën xhahilite dhe atë islame.
- 4- në to diktohen ndarjet etnike që kanë ndarë shoqërinë në zotërinj dhe rob në periudhën xhahilite, dhe në arab, rob dhe robëresha në periudhën islame.
- 5- në to diktohet e vërteta e vetme absolute dhe e drejta absolute, në njërën anë, ndërsa devijimi dhe e padrejta absolute, në anën tjetër.
- 6- në të diktohen metodat e dialogimit, të cilat ngrihen mbi parimin e kërkimfaljes dhe të faljes, ose këmbënguljes dhe shpatës.
- 7- në të zhvillohet ngurtësimi i mendjes, vullnetit dhe përhapja e “kulturës së heshtjes”, “identiteti i bagëtive” dhe shkathtësitë e “dëgjimit dhe zbatimit”.




Përderisa nuk fillon ndryshimi nga burimet edukative, nuk do të ketë ndryshime në fushën e jetës politike, ekonomike, administrative, ushtarake, shoqërore, shkencore, kulturore, estetike etj., ngase e gjithë kjo përputhet me kuptimet kur'anore, ku thuhet se Allahu nuk ndryshon gjendjen e një populli derisa ata nuk ndryshojnë gjendjen e tyre. Ti rikujtojmë këto pika me rëndësi në grafikun që vijon:



PJESA E DHJETË

Ligjet e kthesave historike dhe kontradiktat aktuale në “shoqëritë e mbyllura” në vendet arabe dhe islame

Në dritën e ligjeve historike dhe shoqërore, që potencuam më parë, mund të paraqesim se çka i ka ndodhur shoqërive arabe dhe islame, të cilat janë zhvilluar në kohën bashkëkohore, pas dobësimit të shtetit osman dhe rënies së “*shoqërisë së mbyllur*”, që është kujdesur për të për disa shekuj. Këto shoqëri filluan të hyjnë në një periudhë të mbushur përplot me sfida dhe probleme, pa u shoqëruar me lëvizje edukative reformuese që përshtatet me kohën në sasi dhe cilësi, që kupton natyrën e vlerave konfliktuale gjatë kësaj periudhe dhe kontradiktat që shoqërojnë këto kthesa, që përgatisin njeriun e këtyre shoqërive për “*përplotësim*” me kthesat e periudhës së re me efikasitet ndikues. Për këtë, këto shoqëri, në fillim të kësaj periudhe të re, filluan të importojnë zgjidhje dhe trajtime nga “*kulturat*” e shoqërive të tjera dhe filluan të “*përshtaten*” me diktimet që vinin nga kulturat perëndimore dhe që përputhen me fanatizmat e tyre të ngushta dhe të kufizuara, që çoi në dobësimin edhe të elitës dhe të popullatës, për të kuptuar dhe analizuar realitetin dhe për të paraqitur zgjidhjet e nevojshme për të plotësuar nevojat dhe për t’u përballuar me sfidat dhe zgjidhjen e problemeve. Për këtë, elita jeton në formë të distancuar dhe të imponuar mbi këtë realitet, në kohën kur popullata është fundosur në brendinë e zhvillimit aktual. Mos ta harrojmë grafikun vijues:




Gjatë viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë të shekullit XX,

- 1- u rrit shumë niveli i kontradiktave në shoqëritë arabe dhe islame,
- 2- u shfaqën nevoja ekonomike, probleme politike dhe sfida të reja ushtarake.
- 3- “*Elita konservative*” gjykuese ishte e pafuqishme të mbajë nën kontroll popullatën, të cilën e kishin dridhur kontradiktat dhe problemet e reja.
- 4- përsëri nuk lulëzoi ndonjë lëvizje edukative reformuese. Për këtë,
- 5- këto shoqëri nxorën në pah dy “*elita*” të reja dhe ekstremiste: *elita e majtë dhe elita stërgjyshore*.
- 6- Gjatë konfliktit me “*elitën konservative*” që është në pushtet, arriti elita majtiste me ndihmën e fuqive të jashtme, që kishte importuar zgjidhjet nga kultura e tyre, të minojë elitën konservative në disa shtete arabe dhe të formojë fanatizma elitare, të cilat u ngritën mbi realitetin shoqëror dhe kanë hyrë në përballime të ngrohta dhe të ftohta me “*elitat konservative*”, të cilat ishin në pushtet në shtetet e tjera arabe dhe islame.

- 7- Ata dhanë qëndrimin e tyre ndaj koncepteve: *shtet, qeveri, popull, sovran, liri, pushtet, administratë, kulturë, pronësia ekonomike, praktikat politike, raportet shoqërore, përkatësia civilizuese, trashëgimia historike* etj.

Gjatë viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë të shekullit XX,





Gjatë luftës që ndodhi mes **"dy elitave"**, popullata ishte e paaftë për të kuptuar, kritikuar dhe vlerësuar ndryshimet aktuale. Kështu filluan njerëzit të bien në konflikte fanatike mes elitës konservatore dhe asaj majtiste. *Fanatizmat në esencë janë:*

- 1- reagim i pakontrolluar, i verbër, egoizëm kundër interesit të përgjithshëm si dhe armiqësore kundër mirëkuptimit,
- 2- fanatizmat janë qëndrime prapambeturie, qofshin nga konservatorët, të majtët apo ekstremistët fetarë,
- 3- fanatiku nuk mund të veprojë diçka të dobishme, sepse është i paaftë për të kuptuar realitetin,
- 4- nuk posedon cilësinë e dashurisë,
- 5- nënçmon mendimet e të tjerëve dhe përpiqet të imponojë mendimet e tij ndaj të tjerëve,

- 6- këtu fshihet pasioni i tij ndaj parullave që e verbojnë nga realiteti dhe e bëjnë të jetë rob i iluzioneve,
- 7- fanatiku, qoftë i djathtë konservator, i majtë përparimtar ose ekstremist fetar e sheh veten si person që shënon, lëviz dhe posedon historinë.
- 8- ai punon për të imponuar bindjet e tij ndaj “shumicës” dhe shndërrimin e tyre në kope të zhveshur nga të menduarit,
- 9- dallimi i vetëm mes fanatikut konservativ dhe fanatikut majtist është se i pari dëshiron të ndalë lëvizjen e historisë, ndërsa i dyti ëndërron ta përshpejtojë dhe ta orientojë në kundërshtim me ligjet e historisë dhe të shoqërisë njerëzore,
- 10- fanatiku nuk kujdeset për popullin, por atë e konsideron mjet për realizimin e qëllimeve të tij. Ai para popullit flet me gjuhën e emocioneve dhe stilistikës gjuhësore, me qëllim të realizimit të dëshirave të tij.
- 11- sipas fanatikut, popullata nuk ka të drejtë të mendojë, por për ta mendon dikush tjetër,
- 12- sipas tij, ata duhet të jetojnë sikur fëmijët, nën kujdesin dhe sundimin e tij. Për këtë,
- 13- *fanatikët, qofshin konservatorë, majtistë apo fetarë ekstremist, nuk munden të realizojnë lëvizje çlirimtare, sepse vetë ata nuk janë të lirë. Grafiku ne vijim i përmbledhë këto pika me rëndësi të madhe:*

Gjatë luftës që ndodhi mes “**dy elitave**”, popullata ishte e paaftë për të kuptuar, kritikuar dhe vlerësuar ndryshimet aktuale. Kështu filluan njerëzit të bien në konflikte fanatike mes elitës konservatore dhe asaj majtiste. *Fanatizmat në esencë janë:*






Të gjitha këto veti negative, me të cilat cilësohen fanatizmat e “elitës”, në një formë apo tjetër, gjenden në fanatizmat e konservatorëve dhe majtistëve në shoqëritë e vendeve arabe dhe islame gjatë viteve pesëdhjetë deri në vitet tetëdhjetë të shekullit XX. Konceptet, parullat dhe sistemet e elitës së tyre u sprovuan dhe dështuan tërësisht para nevojave të brendshme dhe sfidave të jashtme. Ky dështim arriti kulmin në fillim të viteve nëntëdhjetë, në të cilat vdiqën parullat dhe projektet e secilit prej konservatorëve dhe majtistëve. E gjithë kjo solli një përfundim në të cilin shoqëritë arabe dhe islame humbën identitetin, të tashmen dhe të ardhmen.

Këtu u shfaq ajo që u quajt **“rizgjimi islam”**. Edhe pse ky rizgjim kishte filluar viteve të tridhjeta të shekullit XX, mirëpo popullariteti i saj u shfaq qartë gjatë dekadës së tetë dhe të nëntë të shekullit XX, për shkak të dështimit të secilit prej elitës konservatore dhe elitës majtiste. **Aktivitet aktuale dhe praktikat që i kryejnë grupet e rizgjimit islam tregojnë se këto grupe cilësohen me dy cilësi:**


- 1- *njëra pozitive dhe tjetra negative,*
- 2- *cilësia pozitive është se këto grupacione janë larg “kulturës së huaj” që importojnë zgjidhje nga shoqëritë dhe kultura të jashtme, që dallojnë nga realiteti dhe kultura e shoqërive arabe dhe islame,*
- 3- *këto grupe i përkasin “periudhës historike” të këtyre shoqërive, të cilat në trashëgiminë e saj fshehin bazat e së tashmes dhe sfidat e së ardhmes.*



- 4- **sa i përket cilësisë negative**, ajo fshihet në atë se grupet e rizgjimit përdorin të njëjtin program të punës, të cilin e kanë përdorur elita e konservatorëve dhe e majtistëve.
- 5- grupet e rizgjimit dëshirojnë të nxjerrin një **“elitë” islame**, e cila imponon *“konceptin e saj”* të islamit ndaj të tjerëve, duke kërkuar prej tyre pasim pa hapur mundësinë e dialogut,
- 6- ato dëshirojnë përsheptimin e lëvizjes së historisë, pa zhvilluar shkollë edukative reformiste që kupton sfidat e kohës, problemet dhe nevojat e së tashmes,
- 7- e pafuqishme për zbatimin e *“ajeteve kur’anore”* në realitetin aktual dhe hulumtim në *“horizonte dhe njerëz”* në mënyrë shkencore që kristalizojnë shkencat e ndryshme të nevojshme për reformimin e *“objektivave”* të punës islame dhe reformimin e *“mjeteve dhe institucioneve”*,
- 8- këto dy çështje, islami i quan **“mësimin e librit (Kur’anit) dhe të urtësisë”**, të cilat që të dyja i përfshijn në fushat kryesore të punës islame dhe të dëftimit.
- 9- grupet e rizgjimit islam nuk e zhvilluan shkollën edukative reformiste të synuar, por u kufizuan në përpjekjet e individëve, të cilët zhvillojnë veten me përpjekjet e tyre individuale.
- 10- kështu, ata në mënyrë spontane i drejtohen popullatës duke i prekur ndjenjat fetare me oratorinë e tyre që mund të cilësohen si *“të mira”* dhe *“jo të mira”*, në kohë që ju mungon zhvillimi i *“vetëdijes kritike”*, të cilën Kur’ani e quan *“polemizim me më të mirë”*, pra me njohuri më të mira nga bashkëkohësit.
- 11- për këtë, grupet e rizgjimit nuk arritën të zhvillojnë projekte dhe programe të dobishme në edukimin e *“shumicës”*, për t’i mundësuar rikthimin e dinjitetit njerëzor, zhvillimin e aftësive mendore dhe të vullnetit të nevojshëm për pjesëmarrje efikase dhe ndikuese në bartjen e përgjegjësisë dhe marrjen e vendimeve që ndërlidhen me ardhmërinë e tyre.
- 12- ata u kapën vetëm për çështjen emocionale duke ngritur parullat fetare që i ndihmojnë për të ardhur në pushtet përmes zgjedhjeve parlamentare, gjë që përfundoi në një përballje të ftohë dhe të ngrohtë me *“elitën” sunduese*, qoftë konservatore apo majtiste,
- 13- po ashtu, grupet e rizgjimit imponuan pasimin duke e mbyllur derën e dialogut brenda rreshtave të saj mes udhëheqësve dhe anëtarëve. Në lidhje me këtë çështje, për bazë kanë parimin e pranimit të nështrimit në të gjitha situatat, ky raport, ka bërë që grupet e rizgjimit të jenë në situatë të shpërthimit, përçarjes dhe gjakderdhjes nga brenda, gjë që u ka lehtësuar

punën gjithë atyre që përgatisin kurthe nga fuqitë e jashtme dhe për t'i vënë në situatë të konfliktit politik me autoritetet që janë në pushtet.

Aktivitet aktuale dhe praktikat që i kryejnë grupet e rizgjimit islam tregojnë se këto grupe cilësohen me dy cilësi:



ky raport, ka bërë që grupet e rizgjimit të jenë në situatë të shpërthimit, përçarjes dhe gjakderdhjes nga brenda, gjë që u ka lehtësuar punën gjithë atyre që përgatisin kurthe nga fuqitë e jashtme dhe për t'i vënë në situatë të konfliktit politik me autoritetet që janë në pushtet.

PJESA E NJËMBËDHJETË

Nevoja e shoqërive arabe dhe islame për lëvizje edukativo-reformiste që e nxjerr nga “shoqëria e mbyllur” në “shoqëri të hapur”


Në dritën e asaj që u tha më lart, bëhet e qartë se nevoja më e rëndësishme e shoqërive arabe dhe islame është:

- 1- gjetja e një lëvizje edukativo-reformiste, e cila kupton kthesat që ndodhin gjatë “*periudhave kohore*” në të cilat kalon,
- 2- mandej të “*përplotësohet*” me fuqitë ekzekutive dhe administrative me qëllim të kristalizimit të strategjive që kërkojnë sfidat dhe nevojat e kohës, taktikat e periudhës që i imponon fleksibiliteti i ndryshimeve përreth, edukimi i “*shumicës*” për të kryer përgjegjësitë dhe për t’u “*përplotësuar*” me botën përreth në atë mënyrë që i kthen dinjitetin njerëzor dhe e liron atë nga “*kultura e kopesë*”,
- 3- duke e përgatitur për mendim kritik dhe vendim të pavarur në vend të “*imitimit të paraardhësve*” dhe “*fanatizmave*” lokale, të cilat nxisin për “*përshtatje*” me sfidat e kohës dhe nënshtrimin ndaj presioneve dhe problemeve të tij.



Kjo është esenca e tevhidit, që ka sjellë Islami. E kundërta e saj është idhujtari.
Për këtë, epiqendra e thirrjes së Muhamedit s.a.v.s. ishte:

- 1- lirimi i njeriut nga “prangat”, “ngarkesat”, besimet, kulturat dhe traditat e fanatizmit,
- 2- kur i liruan nga këto fanatizma, filluan të vendosin themelet e civilizimit islam botëror,
- 3- më pas, lulëzimi ose ngurtësimi i këtij civilizimi ndërlidhej me atë se sa muslimanët iu janë përmbajtur ose kanë qenë larg këtyre themeleve.




Kjo lëvizje edukativo-reformiste e synuar, që të jetë në gjendje të kthejë dinjitetin e njeriut dhe muslimanit bashkëkohor, **duhet patjetër të ketë një grup mendimtarësh që rishikojnë trashëgiminë ideologjike, shoqërore dhe politike** duke e analizuar atë nga jashtë dhe nga brenda, duke iu përmbajtur parimeve të mëposhtme:

- 1- **Parimi i parë:** Vetëdije e thellë me rreziqet e “fanatizmave elitare”.
Reformistët janë:
 - a- dijetarë, pedagogë dhe njohës të mirë të ligjeve të historisë dhe shoqërive,

- b- *ata duhen shpërndarë në institucionet edukative dhe kulturore, brenda popullit, qofshin elita apo masa e thjeshtë, që të kryejnë dy çështje:*
- c- **së pari**, edukimin dhe shpëtimin e popullatës nga *“kultura e kopesë”* dhe *“qelbësirat”* e fanatizmave partiake, fraksionale, rajonale dhe fisnore, si dhe rikthimi i dinjitetit njerëzor, të fuqishëm për prodhimin e udhëheqësve dhe pjesëmarrje në diskutimin e aktiviteteve dhe vlerësimin e tyre dhe,
- d- **së dyti**, zhvillimin e një diskursi të veçantë për kandidatët për të marrë pushtetin dhe udhëheqësinë për autorizimin e atyre që kanë përgatitje për t’u liruar nga *“padrejtësia”* dhe sëmundja e *“krenarisë para të afërmeve dhe dobësimi para të huajve”* deri në atë shkallë sa të ndihen të irrituar nga ekzistimi i *“elitës së padrejtë”* mbi shumicën, duke ua imponuar atyre mendimet.
- e- ata duhet të *“vetëdijësohen”* për rreziqet e ndarjes së çdo shoqërie në *“elitë dominuese”* dhe *“popullatë e poshtëruar”*, ngase kjo ndarje dëmton të dyja palët.
- f- dëmton elitën në këtë botë, ngase i ofron ithtarë të dobët dhe hipokritë, të cilët nuk dinë gjë, pos nënshtrimit dhe ushtri që nuk arrijnë gjë pos disfatës para armikut dhe grupe punëtorësh që nuk dinë gjë, pos paaftësisë dhe dështimit,
- g- kjo gjë e bën elitën të humbur para sfidave të brendshme dhe rreziqeve të jashtme, i bën të poshtëruar para udhëheqësve botërorë me të njëjta pozita,
- h- u sjell atyre poshtërim dhe turp para historisë dhe dënim të madh nga Allahu në ahiret.
- i- sa i përket dëmit që sjell ndarja ndaj popullatës është ngase ajo, shndërrohet në kope njerëzore që nënshtrohen ndaj urdhrave, dëgjojnë pa diskutuar fare dhe nuk ndiejnë nënçmimin. Si rezultat i gjithë kësaj,
- j- kjo ndarje sjell dobësimin, prapambeturinë dhe popujt i varros në muzeun historik.

Kjo lëvizje edukativo-reformiste e synuar, që të jetë në gjendje të kthejë dinjitetin e njeriut dhe muslimanit bashkëkohor, **duhet patjetër të ketë një grup mendimtarësh që rishikojnë trashëgiminë ideologjike, shoqërore dhe politike** duke e analizuar atë nga jashtë dhe nga brenda, duke iu përmbajtur parimeve të mëposhtme:



2- Parimi i dytë: Se njeriu reformues është njeri që ia do të mirën njerëzisë,

- a- është modest,
- b- beson në dialog dhe bindje,
- c- ndërsa refuzon reaksionin dhe dhunën,
- d- veprat e tij vijnë pas një mendimi të thellë dhe kritike konstruktive,
- e- nuk refuzon të drejtën e të tjerëve për të menduar dhe për të zgjedhur,
- f- e as nuk i imponon zgjedhjet e tij të tjerëve,
- g- është i aftë për të analizuar në mënyrë objektive qëndrimet dhe veprimet e tyre,
- h- reformistët janë të bindur se qëndrimet e tyre janë të drejta, por respektojnë të drejtën e të tjerëve që edhe ata të mendojnë se kanë të drejtë, më pas bashkërisht presin që praktika të tregojë se kush ka të drejtë dhe se kush posedon imunitetin kundër shkaqeve të dështimit dhe prapambeturisë,
- i- kështu është sjellja hyjnore duke dialoguar me jobesimtarët dhe thotë:

“هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا تَأْوِيلَهُ يَوْمَ يَأْتِي تَأْوِيلَهُ يَقُولُ الَّذِينَ نَسُوهُ مِنْ قَبْلُ قَدْ جَاءَتْ رُسُلُنَا بِالْحَقِّ”

“Ata nuk presin tjetër, por vetëm atë që do t’u vijë. E atë ditë kur t’u vijë (dënimi i premtuar) ajo që e pritnin, ata që më parë e kishin harruar thonë: vërtet të dërguarit e Zotit tanë erdhën me fakte të vërteta.”⁸² Shprehja te’vil, siç e komenton Ibn Tejmije, nënkupton çështjen ku përfundojnë fjalët dhe veprat në mënyrë praktike, po ashtu, shpallja na mëson të mos habitemi nga mohimi dhe refuzimi i të tjerëve ndaj mendimeve tona, duke i kundërshtuar dhe përgënjeshtuar ato para se të shndërrohen në praktika që zbulon se janë të drejta apo gabim, duke thënë:

“بَلْ كَذَّبُوا بِمَا لَمْ يُحِيطُوا بِعِلْمِهِ وَلَمَّا يَأْتِهِمْ تَأْوِيلُهُ كَذَّابَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الظَّالِمِينَ”


“Por ja, ata përgënjeshtrojnë atë (Kur’anin) pa e kuptuar dhe pa iu ardhur shpjegimi i tij. Po kështu, gënjenin dhe ata që ishin përpara. Shiko si është përfundimi i zullumqarëve.”⁸³


- j- Reformistët, të drejtën e kënaqësisë nuk e kufizojnë vetëm për burrat, pa gratë, për të pasurit, pa të varfërit, për besimtarët, pa jobesimtarët, për

⁸² El A’raf: 53.

⁸³ Junus: 39.

- miqtë, pa armiqtë, për të rriturit, pa të vegjëlit, për të mëdhenjtë, pa masën e thjeshtë,
- k- *ata nuk mohojnë të drejtën e çdo njeriu, pa marrë parasysh gjininë, fenë, fraksionin, pozitën etj., që të ketë të drejtë në të menduar, shprehje dhe zgjedhje.*
 - l- *mohimi i këtyre të drejtave është dëm i madh ndaj dinjitetit njerëzor, gjë që e refuzojnë reformistët, në veçanti islamistët origjinal, dhe luftojnë kundër kësaj dukurie me të gjithë mundësitë që kanë në dispozicion,*
 - m- *imponimi është i gjykuar nga reformistët origjinal. Imponimi është i refuzuar qoftë edhe në besim dhe fe, ngase ata janë të bindur se ai që ka aftësi për të sqaruar të vërtetën dhe ka aftësi për ta mposhtur të pavërtetën ka besim në fenë e tij dhe është i bindur se do të triumfojë,*
 - n- *ata besojnë në natyrshmërinë e njeriut dhe nëse njeriu kthehet në natyrshmërinë e tij, duke u zgjuar nga neglizhenca, ai do ta dashurojë të vërtetën, do ta hulumtojë atë dhe do të vdesë në rrugën e tij,*
 - o- *reformistët nuk përpiqen të zhdukin oponentët e tyre, por përpiqen t'i bindin ata për të mbështetur mendimet e tyre dhe të punojnë bashkë me ta,*
 - p- *është e vërtetë se reformistët kanë të drejtë të jenë kundër atyre që përpiqen që në emër të lirisë t'i heshtin ata dhe të vrasin lirinë e tyre, por, megjithatë, nuk duhet të provokojnë oponentët e as t'i kërcënojnë, duke vazhduar që mes tyre të ndërtojnë ura të mirëkuptimit.*
 - q- *nëse triumfojnë ndaj tyre, ua falin gabimet dhe u thonë: Shkoni se jeni të lirë, më pas atyre u hapen dyert për të dhënë kontributin e tyre, qoftë edhe në poste udhëheqëse nëse e meritojnë atë, duke u bërë ushtarë të tyre dhe i nënshtrohen atyre nëse ata i nënshtrohen Allahut dhe i mohojnë ata nëse e mohojnë veprimin me ligjin e Allahut,*
 - r- *kështu ishte qëndrimi i Muhamedit s.a.v.s. dhe dy halifëve, Ebu Bekrit dhe Omerit [radijallahu anhum], me Halid ibn Velidin, Amr ibn el Asin, Jezid ibn Ebu Sufjanin, Mugire ibn Shu'beh, Muavije ibn Ebu Sufjanin etj,*
 - s- *Reformistët nuk janë persona që dëshirojnë të shkatërrojnë “shtresën e tiranëve”, e në vend të tyre të vijë “shtresa e punëtorëve”,*
 - t- *as nuk janë “elitarë” që punojnë për rrëzimin e “elitës gjykuese”, e në vend të tyre të vijë “elita shpresuese”,*
 - u- *reformistët janë përmirësues të gjendjes. Ata punojnë për të liruar të padrejtët nga tiranët dhe për të liruar tiranët nga padrejtësitë e tyre. Më pas, edukimi i të dy grupeve me “**mesataren e drejtë**”, të cilën e ka dhunuar “kultura e tiranisë dhe e nënçmimit”.*





3- Parimi i tretë: Reformistët udhëzohen me ajetin kur'anor: *“Ata kurrësi nuk mund t’ju sjellin ndonjë dëm juve, përveç ndonjë shqetësimi.”*

⁸⁴,

- a- ata bëjnë dallimin mes “**darar** – **dëm**” ose sëmundjen bazë dhe “**el edha-shqetësim**” ose komplikimet anësore të sëmundjes, më pas merren me trajtimin e sëmundjes bazë e jo me komplikimet.
- b- “**Darar**” është sëmundje bazike e brendshme, e cila ka për qëllim të shkatërrojë dinjitetin e njeriut, duke e privuar nga liria e të menduarit dhe liria

⁸⁴ Ali Imran: 111.

e zgjedhjes dhe duke e shndërruar në viktimë të idhujtarisë.⁸⁵ Kjo është gjendje e shkaktuar nga “*kulturat e tiranisë dhe të nënçmimit*”, të cilat popullin e ndajnë në “*elita gjykuese*” hyjnore dhe “*shumica e dobësuar*” ateiste.

- c- ndërsa “**el edha**” është përsheptimi i të pangopurve nga jashtë për të shfrytëzuar pasojat e “**darar-it**” të brendshëm dhe gjendjen e “*tiranisë*” dhe “*nënçmimit*” që sjellin në popull, gjë që i bën të pamundur për të bartur përgjegjësitë, për të zgjidhur problemet dhe për të plotësuar nevojat.

4- Parimi i katërt dhe më i rëndësishëm: Reformistët:

- a- *nuk e shohin veten si pronarë të historisë,*
- b- *ata janë të bindur se është e pamundur që dikush të veprojë për ta ndaluar, përsheptuar ose ndryshuar kahjen e saj, pa u dënuar,*
- c- për këtë, reformistët “*kuptojnë*” mënyrën e pjesëmarrjes në “*periudhat historike*” dhe “*kuptojnë*” dukuritë e “*urtësisë*” së planifikimit të nevojshëm për trajtimin e kontradiktave që ndodhin gjatë ecurisë së periudhave historike,
- d- *duke bashkëvepruar me to sipas ligjeve të saj.* Ata dinë mirë të këshillojnë njëlloj, si popullatën shumicë ashtu edhe individët e “*elitës së fortë*”.
- e- ata “*polemizojnë*” me elitën e kulturuar në formën më të mirë rreth kontradiktave të sipërpërmendura me qëllim që të kthejnë të gjithë dinjitetin njerëzor dhe të marrin pjesë bashkërisht në bartjen e përgjegjësiave.

⁸⁵ Për të lexuar më gjerësisht rreth idhujtarisë, përmbajtjet dhe praktikët, lexo librin: “*Es sanemijetu vel esnamu fi thekafetil asabijatil muasireti*” të autorit.

PJESA E DYMBËDHJETË

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Gjatë një shekulli të plotë, muslimani i është nënshtruar ndikimeve shoqërore dhe proceseve edukative dhe kulturore, të cilat bashkëveprojnë për ta penguar atë nga arritja e fazës së pjekurisë mendore dhe emocionale. Për këtë, veprimet e tij janë vetëm reaksione mekanike ndaj ndodhive që e hedhin andej-këndej dhe krizave të cilat e çudisin herë pas here. Kjo pengesë është reflektuar te popullata, gjë që e ka bërë të paaftë nga uniteti dhe puna kolektive. Kështu të tjerët kanë në duar fatin e tyre, pa pasur ata vetë asnjë ndikim në përcaktimin dhe formimin e këtij fati.

Që muslimani bashkëkohor të jetë në gjendje të rikthejë efikasitetin dhe fuqinë e tij për t'u ballafaquar ai vetë me problemet dhe të zgjedhë qëndrimet e synuara, **është bërë e domosdoshme që lëvizjet reformiste të fillojnë një strategji periodike**, ku në fazën e parë do të koncentrohen në fushat edukative, ideologjike dhe kulturore me qëllim të realizimit të **dy objektivave**:

Objektiva e parë: *Zhvillimi i efikasitetit të muslimanit. Kjo realizohet duke zbatuar parimin e gradualitetit të zhvillimit fizik, mendor dhe emocional deri në arritjen e shkallës së pjekurisë njerëzore*, duke filluar nga shkalla e varësisë nga të tjerët deri te arritja e shkallës së bashkëveprimit me të tjerët, duke u cilësuar me format pozitive të secilës shkallë, sipas radhitjes së mëposhtme:


E para: Shkalla e varësisë (periudha e fëmijërisë fizike dhe mendore),

E dyta: Shkalla e pavarësisë me format pozitive të mëposhtme:

1. Aftësia për të marrë në dorë iniciativën,
2. Aftësia për përcaktim logjik të objektivës dhe praktikën e tij,
3. Përpikëria në radhitjen e prioriteteve në programet e veprimit.

E treta: Shkalla e bashkëveprimit me të tjerët me format e saj pozitive:

1. Fitoj unë dhe fitojnë të tjerët,
2. Kuptoj të tjerët dhe më pas lëri të të kuptojnë,
3. Bashkëveprimi kolektiv,
4. Rishikimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së gjashtë formave.




Objektiva e dytë: Zhvillimin e efikasitetit tek popullata, e cila realizohet përmes formimit të rrjetit të raporteve shoqërore, duke pasur në konsideratë çështjet vijuese:

1. *Formimin e sistemit edukativ reformues*, i fuqishëm për të përhapur “vetëdijen vetjake” dhe luftimin e edukatës së ngurtë logjike, duke përfshirë edhe pasojat e saj, siç janë përhapja e vetëdjes së ulët dhe “mentaliteti i elitës sunduese”.
2. *Themelimi i institucioneve ekzekutive dhe administrative* të fuqishme për plotësimin e nevojave njerëzore, duke filluar nga nevojat fiziologjike deri te vetaktualizimi.
3. *Plotësimi i atmosferës së shëndoshë demokratike* dhe formimin e fuqive reformiste të fuqishme për të çuar përpara rrjedhat e reformave dhe realizimin e baraspeshës gjatë konfrontimit të fuqive konservatore dhe atyre ekstremiste.

Për të realizuar objektivat e lartcituara, ky hulumtim përfundon në rekomandimet e mëposhtme:



Rekomandimi i parë: *Koncentrimi i lëvizjeve reformuese - në periudhën momentale - për pastrimin e sistemeve edukative në vendet arabe dhe islame. Kjo realizohet duke rishikuar këto sisteme me objektivitat, përfshirë filozofinë, qëllimet, institucionet, fushat, format dhe metodat e tyre. Më pas riformulim i të gjithë këtyre çështjeve me qëllim që të jenë të fuqishme për të përballuar sfidat dhe për të plotësuar nevojat e kohës, pa u humbur në të “kaluarën e stërgjyshërve” e as në të “tashmen e huaj”.*



Në realitet, pastrimi i sistemeve edukative aktuale dhe kulturës shoqërore dominuese dhe koncentrimi i përpjekjeve kolektive për këtë çështje, është tepër e rrezikshme për dy shkaqe:

Shkaku i parë: Sistemet e edukimit familjar, shkollor, traditat shoqërore, praktikat administrative, kulturore dhe të sigurisë përbëjnë faktor pengimi ndaj pjekurisë mendore dhe emocionale tek njeriu, i cili zhvillohet në hijen e këtyre sistemeve, me përjashtime të vogla. Këto sisteme, shumicën e njerëzve e vënë në shkallën e “varësisë”. Me këtë kontribuon fuqishëm në përhapjen e “kulturës së heshtjes dhe mentalitetit të kopesë”, i cili, kur urdhërohet, nënshtrohet pa diskutuar fare. Pakica që e tejkalon shkallën e “varësisë” ndalet te shkalla e “pavarësisë”, shkallë e cila e përgatiti njeriun për suksese individuale, por është pengesë për suksese kolektive. Si rezultat i kësaj, ajo pengon formimin e umetit dhe mbetet e paaftë për të kryer përgjegjësitë, ngase udhëheqësit i lë në pozicion të garimit dhe konfliktit për poste, duke penguar bashkimin e tyre, gjë që i veçon udhëheqësit politik, administrativ dhe shoqëror në të kaluarën dhe të tashmen.

Për shkak të kësaj cilësie negative, vjen sqarimi kur’anor për gjendjen psikike të arabëve në kohën e shpalljes, duke thënë:

“لَوْ أَنْفَقْتَ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا مَّا أَلْفَتْ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ وَلَكِنَّ اللَّهَ أَلْفَ بَيْنَهُمْ إِنَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ”

“Sikur të shpenzosh gjithë ata që janë në tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i Gjithëfuqishëm, i Urtë.”⁸⁶

Vërehet se pengesat natyrore dhe trashëgimia historike, shoqërore dhe kulturore e ka përforcuar edhe më shumë këtë përçarje. Përderisa edukata reformiste nuk formohet në atë mënyrë që të përballlet me këta faktorë përçarës dhe t’i përgatisë terrenin njeriut për zhvillim mendor dhe emocional derisa të arrijë shkallën e pjekurisë, pra shkallën e mbështetjes reciproke me të tjerët, asnjë gjenerate nuk do t’i jepet mundësia për të bashkëvepruar individët, e asnjë populli për t’u bashkuar udhëheqësit e tij.

Shkaku i dytë: Ne jemi duke jetuar në një botë ku, për shkak të mjeteve të komunikimit dhe transportit, janë shkruar kufijtë kulturorë, ideologjik dhe shoqëror. Këto mjete po zhvillohen çdo ditë. Fëmijët dhe të rinjtë në shoqëritë islame shohin përparimin e madh dhe organizimin fantastik në fushat e shkencës, teknologjisë, politikës, administratës, ushtrisë etj, dhe më pas këtë përparim e përgjithësojnë duke

⁸⁶ El Enfal: 63.

përfshirë vlerat, besimin dhe kulturën e këtyre vendeve. Më pas bëjnë krahasim mes këtij përparimi, prapambajtjes dhe anarkisë së përhapur në shoqëritë e tyre, duke e përgjithësuar këtë prapambeturi në vlerat, besimin, kulturën dhe sistemet e jetës, të cilat i imponojnë prindërit si dhe diktim të të cilit i mungon qartësia, bindja dhe besueshmëria. Si rezultat i gjithë këtij krahasimi, vjen gjykimi i gjendjes aktuale, vlerave kulturore, sistemeve të jetës dhe lindja e dyshimit ndaj historisë së tyre.

Jam i bindur se shoqëritë arabe dhe islame bashkëkohore, nëse nuk bëjnë një rishikim rrënjësor të guximshëm, lëvizje reformiste të vetëdijshme ndaj kulturës, koncepteve, vlerave, traditave, sistemeve dhe rrjetin e raporteve, si dhe plan për zhvillimin e saj që ruan origjinalitetin dhe realizon bashkëkohësinë, atëherë do të përballen me një të ardhme ashtu siç u përball komunizmi në Bashkimin Sovjetik në kohën e Gorbaçovit, Shefernadzes dhe Jelcinit. Kështu që Bota Islame do të jetë e dyta që do të bjerë në aspektin kulturor, shoqëror dhe politik.


Rekomandimi i dytë: Nevoja për nxjerrjen e një gjenerate të re të reformistëve, të cilët kuptojnë ecurinë e devijimit në mënyrë të detajuar në vendet që cilësohen si të prapambetura -në veçanti ato arabe dhe islame- dhe vendet që cilësohen si të përparuara -në veçanti Amerika dhe Evropa. Me siguri se një hulumtim shkencor *objektiv do të zbulojë se ecuria e devijimit në vendet arabe dhe islame fillon nga çështja politike dhe përfundon në atë shoqërore. Ndërsa në Perëndim, ecuria fillon nga ajo shoqërore dhe përfundon në atë politike.*

Kriza politike nga e cila janë duke vuajtur vendet islame është e barabartë me krizën shoqërore, shumë e vështirë për trajtim, që është në Amerikë dhe Evropë. Rëndësia e kësaj vetëdije është se gjeneratat e ardhshme, nga të cilat kemi frikë se do të ndodhë Perestrojka shkatërruese, nuk kuptojnë dallimin në këto dy ecuri, e as nuk kuptojnë se fundi i të dy ecurive është i njëjtë, përderisa që të dyja ndeshen me ligjet e Allahut në histori dhe shoqëri.


Është gabim të krahasohet ecuria e çështjeve në vendet arabe dhe islame me ecurinë në Perëndim dhe të gjykohet se e para është e dështuar, ndërsa e dyta e suksesshme.

Mos ta harrojmë këtë rekomandim në grafikun që vijon:

Rekomandimi i dytë




Rekomandimi i tretë: Kristalizimi i një pikëpamje të përgjithshme në shoqëritë islame për realizim të kompletuar të tri komponenteve: *njohuri, fuqi dhe pasuri*, duke mos lënë hapësirë që këto tri komponente të vijnë në kundërshtim njëra me tjetrën. Kjo realizohet përmes themelimit të qendrave për hulumtim, qendrave për studim të cilat duhet të përgatisin takime të rregullta, këmbimin e njohurive dhe përvojave mes të gjithëve me qëllim të koordinimit të aktiviteteve që kryen çdo grup, duke bërë përpjekje për vlerësim, intervenim dhe zhvillim sipas përvojave dhe njohurive të grumbulluara. Mos ta harrojmë këtë rekomandim në grafikun që vijon:



Rekomandimi i katërt: Kristalizimi i një pikëpamje të përgjithshme rreth “të drejtave të njeriut” në vendet arabe dhe islame në atë mënyrë që siguron plotësimin e nevojave njerëzore, duke filluar nga ato fizike, të sigurisë, përkatësisë, vlerësimit dhe krejt në fund motivi më i fortë në jetën e tij të jetë nevoja për vetaktualizim, e cila realizohet përmes arritjeve të bazuar në aftësitë, fuqitë dhe përgatitjet e tij. Mos ta harrojmë këtë rekomandim në grafikun që vijon:

Rekomandimi i katërt::
Kristalizimi i një pikëpamje të përgjithshme rreth “të drejtave të njeriut” në vendet arabe dhe islame që siguron plotësimin e nevojave njerëzore:



Rekomandimi i pestë: Angazhim serioz për zhdukjen e “analfabetizmit” nga i cili vuajnë institucionet dhe grupet e ndryshme, **duke përfshirë edhe lëvizjet reformiste, të cilat farzet dhe sunetet e islamit i përkufizojnë në pamje të jashtme formale, pa përfshirë mendimet dhe veprat, si dhe jetën individuale, e jo atë kolektive.** Rëndësia e zhdukjes së analfabetizmit fshihet në atë se kjo zhdukje ka kuptim të përgjithshëm që nuk kufizohet vetëm në zhdukjen e analfabetizmit në

lexim dhe shkrim, por ajo është shkallë dhe degë, fillon me zhdukjen e analfabetizmit në lexim dhe shkrim, e më pas në mënyrë graduale përfshin nivelet e njohurive dhe shpërndahet në fushat e saj. **Andaj, ekziston analfabetizëm në të kuptuar dhe mendim, analfabetizëm në organizim, në politikë, në ushtri, në ekonomi e kështu me radhë.** Kur’ani, kur ka përdorur shprehjen “analfabetizëm” nuk e ka përkufizua vetëm me ata që nuk dinë lexim dhe shkrim, por ka përfshirë edhe ata që lexojnë, por nuk kuptojnë. Kjo shihet qartë në ajetin kur’anor:

“وَمِنْهُمْ أُمِّيُونَ لَا يَعْلَمُونَ الْكِتَابَ إِلَّا أَمَانِي وَإِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ”

“E ka disa prej tyre që janë analfabetë, nuk e kuptojnë Librin, por jetojnë vetëm në shpresa, duke mos qenë të sigurtë.”⁸⁷

Ibn Tejmije, këtë ajet e ka komentuar duke potencuar se “analfabetët” këtu janë ata që lexojnë Kur’anin pa e kuptuar dhe se kuptimi i fjalëve të Allahut: **“...Por jetojnë vetëm në shpresa”, është lexim pa kuptim.** Për këtë, Allahu thotë: لَا يَعْلَمُونَ **“...Nuk e kuptojnë Librin”** dhe nuk ka thënë: *Nuk e lexojnë.* Ibn Tejmije shton duke thënë se kuptimi i gabuar ka bërë që Havarixhët të dalin në shesh me risinë e kufrit ndaj muslimanëve. Në anën tjetër, kuptimi i drejtë ka dalluar metodologjinë e selefëve në shekujt e parë.⁸⁸

Rekomandimi i pestë:

Angazhim serioz për zhdukjen e “analfabetizmit” nga i cili vuajnë institucionet dhe grupet e ndryshme..:

..duke përfshirë edhe lëvizjet reformiste, të cilat farzet dhe sunetet e islamit i përkufizojnë në pamje të jashtme formale, pa përfshirë mendimet dhe veprat, si dhe jetën individuale, e jo atë kolektive

⁸⁷ El Bakare: 78.

⁸⁸ Maxhid Arsan el Kejlani, “El fikrut terbeviju inde ibn Tejmije”, Medine, Darut turathil arabiji, 1407 h./1986, f. 190.

Në realitet, analfabetizmi nuk është vetëm paaftësi për të lexuar dhe shkruar, por, gjithashtu, është program arsimor dhe traditë e të menduarit, që fillon nga stimulimi i nënës në periudhën e fëmijërisë së hershme - për në periudhën e varësisë - dhe nëse vazhdon kjo varësi, vazhdon me të, gjithashtu, edhe analfabetizmi. Ky lloj i analfabetizmit nuk përfshin vetëm individët, por godet edhe kulturat e ndryshme që pengojnë lirinë e mendimit, shprehjes dhe zgjedhjes, gjë që shpie në pengimin e aftësive mendore, të menduarit, ndjenjës për zhvillim dhe arritjen e shkallës së pjekurisë. Për këtë, individi vazhdon në analfabetizmin kulturor gjatë periudhave të pjekurisë fizike në fusha të ndryshme të jetës, edhe nëse kryen fakultete dhe merr diploma. Analfabetizmi kulturor shfaqet në dy çështje: **së pari**, paaftësia për të kuptuar realitetin dhe ambientin përreth; **së dyti**, lëkundja e sistemit të vlerave që orientojnë rrjetin e raporteve shoqërore në atë mënyrë që vlerat ideologjike bien në shkallën më të ulët të shkallës së vlerave, në kohën kur **vlera e fuqisë, pasurisë, pozitës dhe përkatësisë** janë në shkallët e larta të hierarkisë së vlerave. Si rezultat i gjithë kësaj, në këtë lloj të analfabetizmit kulturor, nuk sjell dobi themelimi i institucioneve edukativo-arsimore, shtypshkronjave, shtëpive botuese, kulturore dhe informative, sepse frytet e saj, përfshirë diplomat, botimet dhe studimet, shërbejnë “qëllimet” e analfabetizmit kulturor. Nga kjo nënkuptohet se këto veprimtari janë vetëm stolisje shoqërore dhe civilizuese me të cilat lavdërohen dhe garojnë individët si dhe shoqëria imiton shoqëritë e tjera. Sa i përket “përmbajtjes”, ajo ose është imitim i stërgjyshërve të mëhershëm ose i të huajve bashkëkohorë. Sa i përket “rezultateve”, ajo është një sterilitet shoqëror dhe joefikasitet, ngase ato nuk shndërrohen në praktika dhe institucione, por mbesin vetëm parulla. Në lidhje me këtë lloj arsimit dhe kulture sinjalizon Muhamedi s.a.v.s. në lutjen e tij: “O Zot, kërkoj mbrojtje prej Teje nga dituria që nuk sjell dobi.”⁸⁹

Organizata UNESCO për *edukim, kulturë dhe shkencë*, ka kuptuar këtë çështje dhe ka zhvilluar kuptimin e “analfabetizmit” duke e përkufizuar *se analfabetizmi bashkëkohor është paaftësia për mendim shkencor dhe mësimi i gjërave të reja*.⁹⁰ Nga kjo nënkuptohet se analfabeti i ri është ai që braktis hulumtimin, studimin dhe mbështetet në hamendjet e tij, duke mos pasuar metodologjinë shkencore. **Bazuar në këtë, kemi individ analfabet, grupe analfabete, parti analfabete, qeveri**

⁸⁹ Sahihu Muslim, Kitabudh Dhikr, Sunenut Tirmidhij, Kitabud deavat.

⁹⁰ Idgar For, Mëso që të jesh, Përktheu: Hanefi ibn Isa, (Algjeri – UNESCO, 1986) f. 54-277.

analfabete, shtet analfabet, popull analfabet, umet analfabet etj. Arabët, të cilët i ka cilësuar Kur'ani si “analfabet”, në administratë, institucione dhe politikat e tyre, vazhdojnë të mbështeten në metodologjinë e analfabetizmit, ngase ata vazhdojnë që ngjarjeve t’iu japin ecuri dhe projekteve rezultate që ata “mendojnë” dhe “dëshirojnë”. *Librat, artikujt, ligjëratat vazhdojnë të kërcejnë nga hapi i ndjenjës së problemit në nxjerrjen e dispozitës dhe paramendimi i rezultateve pa kaluar nëpër hapat shkencore, siç janë: përcaktimi i problemit, grumbullimi, klasifikimi, analizimi dhe vlerësimi i informacioneve, si dhe pa u referuar në mendimet e dijetarëve specialistë e të besueshëm dhe në burimet origjinale.*

Ndoshta ky është dallimi kryesor mes vendeve që cilësohen si përparimtare dhe atyre të prapambetura. Në një vend si SHBA ekzistojnë dhjetra-mijëra specialistë dhe hulumtues që qëndrojnë në qendra hulumtimi dhe depo të mendimit të quajtur **Think Tanks**, të cilët për çdo muaj ua paraqesin në vendet e punës rezultatet e hulumtimeve të tyre profesionistëve në administratë, kompani, udhëheqës ushtarak, politik, duke përfshirë edhe anëtarët e Kongresit dhe administratën e Kryetarit para se ata të marrin ndonjë vendim!

Dhe, në fund, sfida më e madhe më të cilën ballafaqohen shoqëritë njerëzore në nivel rajonal dhe botëror, nuk është rreziku i luftërave, armët për shkatërrim masiv dhe përhapja e terrorizmit, por është rreziku i dridhjeve në fushat e vlerave. Shekulli i ardhshëm do të përjetojë zhdukjen e kulturave dhe shkrirjen e shoqërive përmes proceseve aktuale të shkrirjes, analizimit dhe formimit në fushat e vlerave. Shoqëritë që bartin përgjegjësinë e formimit të institucioneve edukative përballë dridhjeve aktuale në fushat e vlerave, do të ecin pranë civilizimeve të ardhshme dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e qënies njerëzore dhe transferimin e tij nga prapambetja në përparim. Ndërsa, shoqëritë që lihen preh e çrregullimeve aktuale në fushën e vlerave “që të jenë në shërbim të të tjerëve, e jo për t’i vënë në shërbim” dhe duke u dhënë atyre kahjen, pa e caktuar ata vetë kahjen e tyre, ose mjaftojnë me negativitete dhe lavdërim me të kaluarën e tyre, gjithë ky çrregullim do të përfundojë në njërën prej dy çështjeve: ose *kthim në kohën e shpellave dhe jetën e maleve*, ose *shkrirje në kallëpin aktual të vlerave të ndryshme botërore*.

Ajo që është duke ndodhur sot janë procese para lindjes dhe lindjes, dhe procese të vdekjes dhe varrimit. Lindja e atyre që përgatiten për civilizim të ri botëror, duke bërë përgatitjet e duhura dhe vdekja e atyre që me këmbëngulje qëndrojnë të lidhur me fanatizmat e vjetra, duke refuzuar të dëgjojnë thirrjen e zhvillimit të ri botëror, të verbëruar nga shikimi i shenjave të tij. Për ata që ndiejnë dhembje në vendet

islame nga pasojat e operacioneve kirurgjike në shoqëritë e tyre dhe gjykojnë drejtësinë ndërkombëtare, duhet të kuptojnë realitetin dhe kërkesat e periudhës së re historike. Ata nuk mund të ikin nga veprimi i ligjeve historike dhe ligjet e periudhës së ardhshme botërore. Ata, ose realizojnë unitetin me fjalë dhe vepra, lirinë me praktikë dhe administrim, diturinë me mendim dhe teknologji, përkatësinë islame në jetë dhe program, gjë që u mundëson të mbesin në rrjedhat historike dhe të hyjnë në periudhën e re historike, ose do të vazhdojnë të mashtrojnë vetveten e tyre dhe të argëtohen me ëndrra, gjë që do t'i nxjerrë nga historia në mënyrë individuale dhe kolektive. Kështu do të vazhdojë ecuria e tyre në jetën e barzahut, aty ku ngritet fajësimi mes “shumicës së dobët” dhe “pakicës së fortë”, ashtu siç e përshkruan Kur’ani:

“وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الظَّالِمُونَ مَوْقُوفُونَ عِندَ رَبِّهِمْ يَرْجِعُ بَعْضُهُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ الْقَوْلَ يَقُولُ الَّذِينَ الَّذِينَ اسْتَضَعِفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لَوْلَا أَنْتُمْ لَكُنَّا مُؤْمِنِينَ قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا لِلَّذِينَ اسْتَضَعِفُوا أَنَحْنُ صَدَدْنَاكُمْ عَنِ الْهُدَىٰ بَعْدَ إِذْ جَاءَكُمْ بَلْ كُنْتُمْ مُجْرِمِينَ وَقَالَ الَّذِينَ اسْتَضَعِفُوا لِلَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا بَلْ مَكْرُ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ إِذْ تَأْمُرُونَنَا أَنْ نَكْفُرَ بِاللَّهِ وَنَجْعَلَ لَهُ أَنْدَادًا وَأَسْرُوا النَّدَامَةَ لَمَّا رَأَوُا الْعَذَابَ وَجَعَلْنَا الْأَغْلَالَ فِي أَعْنَاقِ الَّذِينَ كَفَرُوا هَلْ يُجْزَوْنَ إِلَّا مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ”

“E sikur t’i shihje zullumqarët kur para Zotit të tyre të ndalen, kthejnë fjalën (fyese) njëri-tjetrit, atyre që ishin pari, u thonë: “Sikur të mos ishit ju, ne do të kishim qenë besimtarë!” E ata që ishin pari, këtyre që kishin qenë të dobët u thonë: “A ne ju penguan prej udhëzimit të drejtë pasi që u pat ardhur juve. Jo, por ju vet ishit kriminelë.” E ata që kishin qenë të shtypur, atyre që ishin krerë u thoshin: “Jo, por dredhia juaj natë e ditë (na largoi prej besimit), kur ju na thërrisnit të mos e besojmë Allahun dhe t’i bëjmë Atij shokë.” E kur e shohin dënimin, e fshehin dëshpërimin e vet dhe Ne u vëmë prangat që qafat e atyre që nuk besuan. Ata nuk dënohen për tjetër pos për atë që punuan.”⁹¹

Të gjitha falënderimet i takojnë vetëm Allahut të Madhërishëm!

⁹¹ Sebe’: 32-33.

BURIMET DHE LITERATURA

1. Kur'ani Famëlartë
2. Hadithi pejgamberik
3. Tefsir et Taberij
4. Tefsir er Razij
5. Tefsir esh Shevkani
6. For, Idgar dhe të tjerë, **Mëso që të jesh**, Përkthyes: Hanefi ibn Isa, Algjei, UNESCO, 1976
7. El Kilani, Maxhid Arsan, **El Fikrit Terbeviju inde Ibn Tejmije**, Medine, Darut Turath, 1407h./ 1986
8. Ibn Tejmije, **El Fetava, Ilmus suluk**, vëll. 10, 1381 h./ 1961.
9. Albanese, Robert, **Managing, toward accountability for performance**, 3 rd. ed. (Home wood, Illionois, 1981.
10. Amey, Liody, **The efficiency of business enterprises**, (New York: Augustus M. Kally publishers 1970.
11. Bulmer, Simon. **Efficiency, democracy and quest german federalism**, (Department of Government, Victoria University of Manchester, UK, 1989.
12. Chomsky, Noam, **Detering democracy**, New York: Hill and wang, 1982.
13. Coghlin, Richard M., **Morality, rationality and efficiency**, New York: M. E. Sharpe, Inc 1991.
14. Covey, Stephen, R., **The 7 habits, of highly effective people**, New York: Feriside Book, 1990.
15. Cummings, William K. And others (ed). **The revival of values education in Asia and the West**, Oxford & New York: Pergamon Press, 1988.
16. Freire, Paul, **Education for critical consciousness**, New York: The continuum co. 1989.
17. Hersey, Paul and Ken Blanchard, **Manegement of organizational behavior**, Englewood cliffs: N. J. Prenice-Hall inc. 1982.
18. Ortega, Jose Y. Gasset, **The revolt of the masses**, tr. New York: London: W. W. Norton & co. 1956.
19. Peak, Lois, **Learning to go to school in Japan**, Berkeley & Los Angeles: Univesity of California Press, 1991.
20. Shields, James J. **Japanese schooling: Patterns of socilization, equality and political control**, 3rd. ed. The Pennsylvaniastate university press, 1993.
21. Turnes, Cjarlie G. **Japanese dynamic efficiency in the global market**, New York: Quorum books, 1991.